SKENDER ASANI
ALBERT RAMAJ
NATASHA DIDENKO

FAMILJET KATOLIKE SHQIPTARE NË SHKUP

(dokumente, fotografi dhe dëshmi - I)

CATHOLIC ALBANIAN FAMILIES IN SKOPJE

(documents, pictures and testimonies - I)



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE I SHQIPTARËVE & ACTA NON VERBA, 2018

Skender Asani - Albert Ramaj - Natasha Didenko

Familjet katolike shqiptare në Shkup
(dokumente, fotografi dhe dëshmi)

Catholic albanian families in Skopje
(documents, pictures and testimonies)

I

Shkup - Skopje 2018

Botues:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE I SHQIPTARËVE
& ACTA NON VERBA, 2018

Biblioteka: Histori

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

"Familjet katolike shqiptare në Shkup"
(dokumente, fotografi dhe dëshmi - I)

"Catholic Albanian families in Skopje"
(documents, pictures and testimonies - I)

Autorë / Authors:
Skender Asani
Albert Ramaj
Natasha Didenko

Recensentë / Commentators:
Dr. Nuri Bexheti
Dr. Dorian Koçi
Dr. Gjon Berisha

ISBN: 978-608-4653-73-8

www.itsh.edu.mk

Skender Asani, Albert Ramaj, Natasha Didenko

"Familjet katolike shqiptare në Shkup"
(dokumente, fotografi dhe dëshmi - I)

"Catholic Albanian families in Skopje"
(documents, pictures and testimonies - I)

"Dashtnija fillon n'familje"
Nënë Tereza

"Love begins at home"
Mother Tereza

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA 5
PARATHËNIE 7
Forward 21

I. IPESHKVIA SHKUP-PRIZREN NËPERMJET HARTAVE
DHE SHKRIMEVE 35
I.1 SHKUPI - DËSHMI HISTORIKE PËR VAZHDIMËSINË
ILIRE–ARBËRORE–SHQIPTARE 35
Skopje - historical evidence of Illyrian-Arborean-Albanian continuity 36

II. IPESHKVËT E IPESHKVISË SË SHKUPIT 42
II.1 KRONOLOGJIA E IPESHKËVE TË SHKUPIT 42
Librat që shtjellojnë historikun e Ipeshkvisë Shkup-Prizren: 45
II.2 PJETËR BOGDANI 49
Pjetër Bogdani 58
II.3 TOMA RASPASANI (1651-1718) 60
Toma Raspasani (1651-1718) 74
II.4 DOM ZEF RAMAJ (1882-1914), FAMULLITAR DHE MËSUES NË SHKUP ..80
Dom Zef Ramaj (1882-1914), Vicar and Teacher in Skopje 89
II.5 LAZËR MJEDA 93
Lazër Mjeda 115
II.6 MEMORANDUM PËR POZITËN E POPULLIT SHQIPTAR
NË MBRETERIN E JUGOSLAVISË 123

III. ZHVILLIMI I SHKOLLAVE KATOLIKE SHQIPTARE NË SHKUP 185
III.1 SHKOLLAT SHQIPE NË SHKUP PREJ VITIT 1893 185
Albanian schools in Skopje since 1893 204
III.2 KONTRIBUTI I KOLË BOJAXHIUT NË HAPJEN E SHKOLLAVE
SHQIPE NË SHKUP 207
Kole Bojaxhiu's contribution to the open the schools in Skopje 210
III.3. BANDA MUZIKORE "ZANI MALEVE" NË SHKUP 214
Music Band "Zani i Maleve" in Skopje 216

IV.1 DOM NDUE BYTYQI 217
Dom Ndue Bytyqi 228
IV.2 LORENC ANTONI (1909-1991) 232
Lorenc Antoni (1909-1991) 236

IV.3 DOM GASPËR GJINI (1930-198), KLERIK, INTELEKTUAL, POLIGLOT, KRIJUES DHE SHKENCËTAR 238
Don Gaspër Gjini (1930-198), cleric, intellectual, poliglot, creator and scientific 241
IV.4 VINÇENC GJINI 244
Vinçenc Gjini 246
IV.5 FOTOGRAFI ME KOSTUME TRADICIONALE TË SHQIPTARËVE KATOLIK NË SHKUP 248
Photografs of traditional clothes of the Catholic Albanian families in Skopje 251

V. DY MISIONARET SHQIPTARE NGA SHKUPI 284
V.1 GONXHE BOJAXHIU 297
V.2 NASTA MIHILLIT 315

VI. DËSHMITË FAMILJARE 334
VI.1 FAMILJA BOJAXHIU 334
The Bojaxhiu Family 358
VI.2 FAMILJA ANTONI NË SHKUP 365
Anton Family in Skopje 370
VI.3 FAMILJA SERREQI 372
Family Serreqi 385
VI.4 FAMILJA UKAJDARI 391
Family Ukajdari 409
VI.5 FAMILJA GJINI 411
Gjini Family 415
VI.6 FAMILJA NRECA 417
VI.7 FAMILJA MARKU 426
Family Marku 433

VII. VARREZAT KATOLIKE SHQIPTARE NË SHKUP 435
Catholic Albanian Cemetery in Skopje 438

VIII. KISHAT KATOLIKE NË QYTETIN E SHKUPIT / CATHOLIC CHURCHES IN SKOPJE 475

PARATHËNIE

Për të dëshmuar autoktoninë e pandërprerë të shqiptarëve në qytetin e Shkupit dhe për ta argumentuar këtë tezë, ka qenë e domosdoshme që të hulumtohet tradita, folklori, gjuha, feja, dhe në përgjithësi trashëgimia kulturore e familjeve të vjetra katolike shqiptare.

Monografia me dokumente, fotografi dhe dëshmi për familjet katolike shqiptare të Shkupit, është një libër që mëton të vë një gjurmë në kohën në të cilën jetojmë, një libër që për më tepër, synon të rifreskojë të kaluarën tonë historike, nëpër të cilën kaluan fatet tona njerëzore.

Angazhimi i historianëve duhet orientuar për të zbardhur të kaluarën historike të qytetit të Shkupit dhe të nënqiellit historik të Maqedonisë, por njëkohësisht është e një rëndësie së posaçme të vilet trashëgimia e fjetur kulturore që gjendet tek familjet katolike shqiptare. Nga kjo varet zbardhja edhe e shumë momenteve shkencore të trojeve të Dardanisë (antikitetit), Ipeshkvisë Shkup – Prizren (mesjetës), Vilajetit të Kosovës (periudha osmane), që janë argumente të qarta për të dëshmuar vazhdimësinë e pandërprerë ilire – arbërore - shqiptare. Ndaj, edhe puna e historiografisë shqiptare duhet të jetë shtysë për sensibilizimin e çështjes shqiptare në Shkup, përmes gjurmimit të vrajave të kohës e vendit, figurave dhe ngjarjeve të shqiptarëve të Maqedonisë, sidomos të Shkupit historik e aktual.

Shkupi, megjithëse gjatë këtyre mijëvjeçarëve ndërroi shumë pushtues, secilin më të zi se paraardhësin, asnjëherë nuk e humbi identitetin e vet të lashtë kulturor, i cili ndërlidhet me njërin ndër popujt më të vjetër të Ballkanit: ilirë-arbërorë-shqiptarë. Shkupi është agora e veprës, një shesh rreth të cilit ndërlidhen shumë ngjarje, personalitete, rrëfime, shpresa dhe zhgënjime për një të ardhme të tij më të mirë se sa e djeshmja.

Sipas burimeve të kohës që na e kanë ofruar autorët e vjetër antikë (Straboni, Ptolomeu, Tit Livi, Marcillius, etj.) për çështjen se cilët ishin banorët e parë të qytetit të Skupit, duke u mbështetur në këto të dhëna vërtetohet se ata ishin ilirët.[1] Edhe studiuesi serb ndërmjet dy luftërave botërore, Mita Kostiq, vërteton tezën se banorët e parë të Shkupit ishin

[1] Tomo Smilaniq - Брадина, Скопље и околина, Скопље , 1928, f.8; Skopje, Enciklopedija Jugoslavije, R – Serbija, Zagreb, MCMEXVIII, f.210.

ilirët.[2] Duke gjykuar nga prizma gjeografike dhe indikacionet për vendndodhjen e banorëve të parë, nga këto burime dhe nga ekspeditat arkeologjike që janë bërë në këtë qytet, mund të konstatojmë se ato ishin në vendet malore të këtij qyteti.[3]

Shkupi gjendet në regjionin qendror të ilirëve dhe është e kthyer nga jugu, që është regjion tipik kontinental. Sipas të dhënave të autorëve të vjetër, kemi të bëjmë me një kulturë autoktone që ka treguar rezistencë ndaj helenizimit.[4] Kurse sipas shumë burimeve, këtë qytet e themeluan dardanët në shekullin IV p.e.re. Shumë burime të proveniencave të ndryshme na japin të dhëna se Skupi (Scupi) ishte edhe kryeqendër e Mbretërisë së Dardanisë.[5]

Evansi ishte arkeologu që zbuloi edhe vendndodhjen e qytetit të kolonisë romake të Skupit, në pjesën e majtë të lumit Vardar, te vendi i quajtur Zllokuqani dhe Bardovci (Bardhi, - S.A), ku derdhet lumi Lepenc në lumin Vardar. Kur romakët e nënshtruan Maqedoninë dhe Pajoninë në vitin 168, edhe Skupi ishte nënshtruar dhe shndërruar në metropolis Dardaniae, kryeqendër e provincës Dardania. Ky rol i Skupit si kryeqendër e provincës romake të Dardanisë do të zgjasë për pesë shekuj.[6]

Në periudhën e pas pushtimit romak, Skupi u shndërrua në nyje tregtare dhe rrugore ku i lidhte akset strategjike më të njohura të Ballkanit, siç ishin: Via Dezeta (Shkup – Prizren – Shkodër); rruga Via Egnatia (Shkup – Ohër – Durrës, dhe nga ana tjetër Selanik – Kostandinopojë); Via Naisus (Nish) – Singidinium (Beograd), dhe Via Sertika (Sofje) – Adrianopolis (Edrene).[7] Për peshën që luante në këtë kohë ky qytet mori epitetin "tribun quirinae".[8]

---

[2] Мита Костић, Град Скопље и његов историски значај током векова , Скопље и Јужна Србија, Скопље, 1925, f.26.; Skopje, Enciklopedija Jugoslavije, R – Serbija, Zagreb, MCMEXVIII, f.210.

[3] Томо Смиланић - Брадина, Скопље и околина, Скопље, 1928, f.9.

[4] Fanula Papazoglu, Politiçka organizacija ilira u vreme njihove samostalnosti, Simpozijum o ilirima u antiçko doba, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1967, f.14

[5] Serge Metais, Historia e Shqiptarëve nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, Tiranë, 2004; J.G.v. Hahn, Reise von Belgrad nach Salonik, Wien, 1868, f.105; Јован ПоповскиJovan, Скопје, Скопје, 1965, f.19-21; Prof. ST. Stanoejeviq, Narodna Enciklopedia, kniga IV, Beograd, 1921, f.156; Skopje, Enciklopedija Jugoslavije, R – Serbija, Zagreb, MCMEXVIII, f.210.

[6] A. Evans, Antiquarian researches in Illyricum.Part.IV, f. 134; Fanula Papazoglu, Politiçka organizacija ilira u vreme njihove samostalnosti, Simpozijum o ilirima u antiçko doba, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1967, f.14; Мита Костић, Град Скопљеи његов значајтоком векова, Скопље и Јужна Србија, Скопље, 1925, f.26.

[7] Гавро Чкаранић, Пут са Албанског приморја у унутрашности, Путеви у Средновековној Србије, Београд, 1974, f. 77 – 102; Vladimir Blavatsky, Apollonia et les Illyriens (Avant 229 Av. Notre Ere), Actes du VIII Congres International des Scientces Prehistoriques et Parahistoriques,

Periudha më e ndritur e Shkupit, si kryeqendër e Prefekturës së Ilirisë Veriore gjatë mesjetës së hershme, ka qenë koha e qeverisjes me Perandorinë Bizantine të perandorit Justiniani I. Ky e ndërtoi edhe qytetin Justiniana Prima, ku sipas shumë studiuesve, ai gjendet në Shkupin e sotëm, përfundim që bazohet edhe në rrënojat dhe gjetjet arkeologjike. I pari objekt si pjesë e Justiniana Prima u konstatua nga Evansi, dhe ka të bëjë pikërisht me akropolin në Kala. Besohet se mbetje e këtij akropoli, i cili paraqet pjesën e epërme të qytetit, është muri monumental ballor në anën veriore dhe verilindore me kullën harkore i ndërtuar në shekullin VI me blloqe gurësh dhe monumente të Scupit antik[9]. Edhe ekspeditat e mëvonshme arkeologjike, të zhvilluara në Kalanë e Shkupit, dëshmuan konstatimet e Evansit për vend-ndodhjen e Justiniana Primës në këtë lokalitet. Nga studimet e deritashme, mund të konstatojmë se selia e parë e ipeshkëvive në Dardani, ka qenë në qytetin Scupi afër Shkupit të sotëm, (5 km në veri, buzë rrugës Naissus – Scupi - Thessalonik), në lokalin e quajtur Zajçev Rid, ku në këtë lokalitet arkeologjik është zbuluar një bazilikë e mrekullueshme e krishterimit të hershëm.

Shumë burime flasin edhe për letrat e ruajtura mbi kishën Dardane të kësaj periudhe, për kishën Dardane gjatë periudhës së ardhjes së sllavëve dhe për krishterët e Dardanisë, për banorët e atëhershëm të këtyre vendeve, për Dioqezën e Prizrenit dhe titullarët e saj, ipeshkvitë e kësaj periudhe, etj. Letrat janë ruajtur kryesisht në koleksionet e vjetra papnore dhe kanë rëndësi të madhe historike, sepse në to bëhet fjalë për shumë çështje kontestuese dhe janë një pasqyrë reale e qëndrimit të Selisë së Shenjtë për problemet e ndryshme të disa kishave. Të gjithë këto letra të radhitura me

---

Beograd, 1971, f. 237; Fanula Papazoglu, Srednjobalkanska Plemena u Predrimsko Doba (Tribali, Autarjati, Dardanci, Skordici i Mezi), knjiga. XXX, Akademija Nauka Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1969, f.190; Antonie Nikolovski – Dimitar Cornakov – Kosta Balabanov, The Cultural Monuments of the People's Republic of Macedonia, Skopje, 1961, f.11.

[8] Radosllav .K, Suvremena Israzivanja o Jeziku Starosjedilaca Ilirskih Provincija, Simpozijum o Teritorijalnom i Hronoloskom Razgranicenju Ilira u Prahistorisko Doba, knjiga. IV, Naucno Drustvo SR Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1964, f. 15 – 28; Мита Костић, Град Скопље и негов историски значај током векова, Скопље и Јужна Србија, Скопље, 1925, f.26

[9] Nga të dhënat e historianëve bizantinë, por edhe nga studiuesit tjerë që janë marrë me çështjen me krishterimin e hershëm, mësojmë se Justiniani I kishte lindur në Dardaninë evropiane. Vendlindja e tij quhej Tauresium, dhe se ndodhet te kasteli Baderina. Në shenjë falënderimi për vendlindjen e tij, perandori atje ngriti një qytet të ri që i dha emrin e tij – Justiniana Prima. Ky qytet më vonë bëhet edhe selia arkipeshkvike dhe kryeqendër e Prefekturës së Ilirisë Veriore; Exhlale Dobruna – Salihu, Të dhënat mbi ndërtimet dhe rindërtimet urbane të Justinianit I në trevën dardane, "Kërkime historike", nr.4, Shkup, 2011, 21-36; Mixhait Pollozhani, Materialet e reja arkeologjike dëshmi për Justiniana Prima në Kalanë e Shkupit, " Kërkime historike", nr. 4, Shkup, 2011, 37-49.

kujdes dhe sipas tyre që i dërgojnë janë: a) letrat e papëve, të dërguara ipeshkëvive të Ilirikut, eprorëve të krahinave kishtare, b) letrat e perandorëve, mbi problemet e paraqitura në perandori dhe kishë dhe c) letrat e ipeshkvive dardanë. Sipas studiuesit Gasper Gjini, janë ruajtur vetëm dy letra të cilat ipeshkvitë dardanë ua kishin dërguar personaliteteve të njohura kishtare e laike.[10]

Letra e parë ishte përgjigje e perandorit Leonit e Avgustit, ndërsa letra e dytë po ashtu është një përgjigje e vitit 494 të cilëve ipeshkvët dardanë ia dërgojnë papës Gezalli. Sigurisht (sipas këtij studiuesi), kanë ekzistuar edhe shumë letra tjera, fatkeqësisht ato janë zhdukur gjatë shekujve të stuhishëm dhe depërtimeve të shpeshta të popujve barbarë.[11]

Qyteti Shkupi, si kryeqendër e Dardanisë, luajti rol të rëndësishëm gjatë periudhës së antikitetit, në aspektin politik, kulturor, ekonomik, rrugor dhe kishtar. Kultura Ilire e këtij qyteti në vazhdimësi argumentohet nga burimet historike të proveniencave të ndryshme, por edhe nëpërmjet ekspeditave arkeologjike të zhvilluara në shekullin XIX, ndërmjet dy luftërave botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Pas këtyre selia e ipeshkëvive mbeti e zbrazët afro dy shekuj. Burimet e botuara nga studiuesit shqiptarë flasin edhe për emrat e ipeshkëvive të kësaj periudhe. Ipeshkëvit e parë, sipas këtyre të dhënave paraqiten prej kohës së mbretit bullgar Kllojan (1204), ndërsa kishën e udhëhiqte Papa Inoçenti (1198-1216). Në një letër papës gjendet edhe nënshkrimi i ipeshkvit të Shkupit dhe Prizrenit.

Në vitin 1229 ipeshkvi i Shkupit paraqitet Gjoni, i lindur në Konstancë. Ipeshkvi tjetër i Shkupit në vitin 1327 është Gjon Lemegu, pas tij u bë Fridericus R. në vitin 1354, dhe kështu radhazi deri në vitin 1659 kur mbreti i Hungarisë e emëroi Hiacintin ipeshkëv në Canad dhe në këtë mënyrë mbeti i lirë fronti i Dioqezës së Shkupit.

Pjetër Bogdani gjatë karrierës së tij meshtarake pati rastin të luante edhe rolin e avokatit në procese të ndryshme mosmarrëveshje me klerin për të drejta kishtare. Rasti i parë ishte mbrojtja e xhaxhait (ungjit) të tij, Andrea Bogdanit, pas vdekjes (1649) së argjipeshkvit katolik të Ohrit dhe administratorit të kishës katolike të Prizrenit, Rafael Levakoviq. Dy vjet pas vdekjes së Levakoviqit, më 1651, Kongregata e largoi nën pretekstin e gradimit Andrea Bogdanin, ungjin e Pjetrit, nga Prishtina, ku shërbente si

[10] Gasper Gjini, Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj, Prizren, 2011.
[11] Po aty.

famullitar i shqiptarëve katolikë dhe e dërgoi argjipeshkëv në Ohër, kurse në krye të Dioqezës katolike të Prizrenit emëroi prelatin bullgar Frano Stoimirovin. Sikurse del nga një akt i kancelarisë së Vatikanit, largimi i Andrea Bogdanit nga Prishtina u diktua nga motive politike. Aty thuhet se famullitari shqiptar shihej me sy të keq nga priftërinjtë serbë, të cilët nuk i përfillnin shqiptarët. Ai iu përgjigj Romës se e pranonte vendimin, por ndërkohë kreu një akt të guximshëm. Duke thyer haptas disiplinën kishtare, ai u vetëemërua edhe ipeshkëv i Prizrenit, drejtimin e së cilës nuk dëshironte t'ia linte një udhëheqësi që nuk ishte shqiptar.[12]

Veprimi i Andrea Bogdanit nuk u prit mirë në Romë, dhe çështja i kaloi gjyqit të Kongregatës, e cili i dha urdhër Andreas që të shkonte sa më parë në Ohër dhe të priste atje deri sa të dilte vendimi përfundimtar i gjyqit. Por prelati shqiptar nuk u tërhoq. Ai dërgoi në Romë nipin e vet 26 vjeçar, Pjetër Bogdanin që ta mbronte çështjen para Kongregates. Kjo qe dalja e parë e Pjetër Bogdanit para kardinalëve të njohur të Romës. Aty, ai pati si kundërshtar argjipeshkvin katolik të Sofjes, një prift bullgar afërsisht me të njëjtin emër, Peter Bogdan Bakshiq, i cili kishte ardhur enkas nga Bullgaria për ta mbrojtur çështjen në favor të Frano Stoimirovit. Barrën që mori përsipër famullitari i ri shqiptar e kreu me sukses. Ai i hodhi poshtë argumentet e Peter Bakshiqit dhe i bindi kardinalët e Kongregatës që të marrin më 16 nëntor 1654 vendim në favor të ungjit të vet. Kështu, në tetor të vitit 1655, Andrea Bogdani u emërua argjipeshkëv i Shkupit duke mbajtur njëkohësisht nën drejtimin e tij edhe Ipeshkvinë e Prizrenit, kurse F. Stoimirovi u transferua në Ohër, si argjipeshkëv.[13]

Pas shërbimit njëzetvjeçar të tij në kishën e Shkodrës, në vjeshtën e vitit 1677, Pjetër Bogdani kthehet në Kosovë. Në këtë kohë, xhaxhai i tij - argjipeshkvi i Shkupi, Andrea Bogdani ishte në gjendje të rëndë shëndetësore dhe nuk ishte më në gjendje të kryente shërbimet meshtarake. Prandaj, ai i kishte kërkuar papës Inoçentit XI që të heqë dorë nga posti i argjipeshkvit të Shkupi në dobi të nipit të tij Pjetër Bogdanit. Për këtë papa kërkoi nga argjipeshkvi i Tivarit, Andrea Zmajeviq që të jepte një mendim mbi cilësitë e punës së deriatëhershme të Pjetër Bogdanit. Për të vlerësuar jetën, moralin e cilësitë e Pjetrit, Kongregata caktoi kardinalin Giovanni Pastrizio, kanonik italian, dhe meshtarin shqiptar të dioqezës së Lezhës, Gjergj Skampa-

[12] Filmi dokumentar: "*Pjetër Bogdani",* MRTV, Shkup, qershor 2017. / Documentar movie: "*Pjetër Bogdani".* MRTV, Skopje, June 2017.
[13] Po aty

neun.[14] Kështu, pas marrjes së mendimeve pozitive nga të gjitha anët, papa Inoçenti XI më 8 nëntor 1677, Pjetër Bogdanit ia besoi udhëheqjen e Argjipeshkvisë së Shkupit.

Me të arritur në Kosovë, Pjetër Bogdanit iu desh të përballej me patrikun e Pejës dhe atë të Graçanicës, të cilët dolën haptas kundërshtar si të Bogdanit, ashtu edhe të katolikëve në përgjithësi. Si njëri ashtu edhe tjetri i rëndonin popullatën me taksa të rënda dhe tentonin t'i zëvendësonin klerin katolik me atë ortodoks. Në anën tjetër, Bogdani u përballë gjatë viteve 1679-1680 me shpifje e akuza edhe nga disa klerikë katolikë, ofensivë të cilën e përballoi me vështirësi të mëdha.[15]

Pas tri vjet shërbimi në krye të Argjipeshkvisë së Shkupit, më 1681, Bogdani dërgoi në Romë relacionin me titull: "*Relatione generale dell'arcivescovato di Scopia data alla Sacra Congregatione di Propaganda Fide dal Monsignor Pietro Bogdani Arcivescovo di Scopia – Relacion i përgjithshëm i Argjipeshkvisë së Shkupit dhënë Kongregatës së Shenjtë të Propagandës Fide prej imzot Pjetër Bogdanit, argjipeshkëv i Shkupit*". Këtij relacioni, Bogdani ia bashkëngjit disa dokumente që i konkretizonin: kufijtë e famullive të Shkupit, dekrete, një listë me emrat e argjipeshkvijve e të famullitarëve të argjipeshkvisë.[16]

Në vjeshtën e vitit 1682, ai përsëri i bën një vizitë famullive të dioqezës së vet, duke filluar prej Kratovës për të dalë në Shkup, Letnicë, Gjakovë, Has, Prizren, Trepçë e Novobërdë, të cilat, sipas Bogdanit, gjendeshin në gjendje të mjerueshme.[17]

Më 15 mars 1682, Toma Raspasani i shkruan Propagandës Fide që të përkrahë veprimtarinë e tij si meshtar në territorin e Ipeshkvisë së Shkupit, ku flet edhe për shkollimin e tij në Loreto, të cilin e kishte përfunduar me sukses. Është interesant fakti se Toma Raspasani kishte tentuar që të vepronte edhe si mësues në Ipeshkvinë e Shkupit. Më 28 korrik 1683 ipeshkvi i Shkupit, Pjetër Bogdani, e rekomandon Toma Raspasanin të emërohet ipeshkëv i Pultit, ndërsa më vonë e emëroi vikar gjeneral i asaj ipeshkvie, për shkak se Toma ishte shumë i mirë dhe e njihte shumë mirë gjuhën shqipe të asaj zone.

Më 1687 Pjetër Bogdani e njofton Romën se kishte vështirësi me turqit, pasi që kishin ngritur prapë tatimet, dhe kjo për besimtarët ishte vështirë,

[14] Po aty.
[15] Po aty.
[16] Po aty.
[17] Po aty.

por edhe për Toma Raspasanin, pasi që turqit e kishin maltretuar famullitarin e Prizrenit, të cilin e kishin përzënë nga aty, e ai ishte fshehur në Prishtinë. Turqit kishin vështirësi me veprimtarinë e Tomës në Ipeshkvin e Shkupit dhe të Pultit, për shkak të aktivitetit të tij, sidomos në përkrahjen e betejave austriake të udhëhequra nga Pikolomini (Johann Norbert Graf Piccolomini), i cili vdiq në Prizren më 1689. Të njëjtin vit vdiq edhe ipeshkvi i Shkupit, Pjetër Bogdani, i cili ishte përkrahës i madh i ushtrisë austriake që luftonte kundër turqve në Ballkan. Pas vdekjes së Pikolominit dhe Bogdanit, Toma Raspasani kishte përgjegjësi jo të vogël për Ipeshkvinë e Shkupit, sepse ishte vikar gjeneral i ipeshkvisë dhe në fakt e udhëhiqte atë.

Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, tentonte që në forma të ndryshme ta zvogëlojë numrin e popullatës shqiptare (që i përkiste konfesionit mysliman dhe krishterë), dhe ta thyejë bashkimin etnik dhe fetar në territoret e veta. Për ato arsye, janë ndërmarrë masa drastike të natyrës ekonomike, sociale dhe politike, si kolonizimi, asimilimi dhe dëbimi i dhunshëm. Për këtë, elitat politike serbe vendosën që aspiratat e tyre t'i realizojnë me dëbimin e mijëra shqiptarëve mysliman për në Turqi.[18] Në të njëtën kohë, elitat politike serbe, filluan ta zbatojnë "reformën agrare" që të bëjnë kolonizimin me serbë dhe malazezë në trevat verilindore shqiptare.

Me fillimin e Luftës Ballkanike për popujt që nuk ishin pjesë e Aleancës Ballkanike u krijua një gjendje e re politike tepër e rëndë dhe e rrezikshme. Në këto rrethana përpara prijësve të popullit shqiptar dilnin dy probleme të ngutshme: qëndrimi që duhej mbajtur ndaj konfliktit ballkanik dhe ç'duhej bërë për të shpëtuar trojet e banuara me shqiptarë nga rreziqet që i kanoseshin asaj. Prijësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare vendosën të mbajnë një qëndrim neutral përballë dy palëve ndërluftuese. Por, zhvillimi i shpejtë i Luftës Ballkanike dhe fitoret e saja në fushëbeteja, mundësuan që aleanca ballkanike të realizon qëllimin e kamotshëm për të projektet "Serbia e Madhe" dhe "Megala Idea" greke. Më e theksuar ishte Beteja e Kumanovës (1912), ku ushtria osmane kapitulloi përballë ushtrisë serbe dhe i mundësoi asaj që të depërton në brendi të territoreve të banuara me shqiptarë.[19] Ushtria e aleatëve ballkanik gjatë okupimit të territoreve të

[18] Đ.Krstić, Kolonizacija u Južnoj Srbiji, Sarajevo, 1928, 5, 82; Ali Hadri, Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugos;llavisë (1918 – 1941), " Gjurmime Albanologjike ", бр.2, Prishtinë, 1968, 167; Mark Krasnići, Savremene društveno - geografske promene na Kosovu i Metohiji, Priština, 1963, 25 – 26.

[19] Sekula Drljević, Balkanski sukobi 1905 - 1941, Zagreb, 1944, 109; Кумановска битка, " Политика ", број.3500, 10.10.1913, Београд, 1913, 1.

banuara me shqiptarë, duke përdorur propagandën se "po ndjek armikun", ajo vëri në jetë planin për spastrimin etnik të këtyre territoreve.[20] Marshimi i ushtrisë serbe gjatë operacioneve luftarake, në Luftën e Parë Ballkanike, edhe në viset lindore të banuara me shqiptarë, përcilleshin me represion, çarmatosje të shqiptarëve dhe armatosje të serbëve të cilët kryenin shfarosje fizike, dhunime, djegie të shtëpive dhe të katundeve shqiptare në trevat e Velesit, Kumanovës, Shkupit, Kërçovës, Strugës, Ohrit, etj.[21]

Me vendosjen e Komandës së III serbe me seli në Shkup, filluan vrasjet, dhunimet, torturimet dhe djegiet e fshatrave dhe lagjeve shqiptare të Shkupit dhe rrethinës. Të gjitha këto veprime të ushtrisë serbe, i përshkruante deri edhe në detale dom Zef Ramaj, i cili flet për veprime devijante të shteteve ballkanike ndaj popullatës së pafajshme shqiptare gjatë viteve 1912-1913 në qytetin e Shkupit. Në ditët e fundit të muajit mars të vitit 1913, në gazetat gjermanofone "Allgemeiner Tiroler Anzeiger" dhe "Reispost", me titull: "Die serbische Unmenschlichkeit in Albanien", dom Zef Ramaj nga Shkupi deklaronte se: ***"Për momentin nuk kam mundësi që t'ju dërgoj një raport të detajuar. Ju duhet të keni parasysh se gjendemi në gjendje lufte.. nuk mund të paramendoni atë se çka është mëkatuar ndaj bashkatdhetarëve tanë në këtë luftë... zemra ime është përplot, për atë se çfarë mundë t'ju shkruaj më tutje Më mirë do të vdisja se Shqipërinë ta shihja në këtë gjendje, në të cilën gjendet".***[22]

Tani t'i kthehemi pak strukturës së këtij libri. Në kreun e parë janë studiuar rrethanat kulturore, historike dhe fetare të Ipeshkvisë Shkup – Prizren nëpërmjet hartave dhe shkrimeve. Në këtë kapitull nëpërmjet burimeve argumentohet se si asnjë qytet tjetër nuk është më argumentues se Shkupi, sidomos për dëshmitë historike për vazhdimësinë ilire–arbërore–shqiptare. Argument më relevant është letra e ipeshkvijve dardanë dërguar papës Galezit në vitin 494, ku jepen të dhëna shumë të rëndësishme për Ipeshkvinë e Shkupit, rolin që luante ajo në kompaktësinë e kishës dhe të besimtarëve. Pastaj angazhimi i z. Daniele Farlati, për të ndërmarrë një ekspeditë të gjerë nëpër dheun e të parëve të tij, nëpër Iliri.

[20] Th. Murzaku, Faktorët kryesorë që çuan në shpërthimin e Kryengritjes së Shtatorit 1913, "Jehona", Shkup, 1993, 23.
[21] Архив на Институтот за Национална Историја – Скопје,фонд.Врховна команда – Полициско оделение 1913 год., бр.поверливо.16.09.1913; Halim Purellku, Kryengritja e shtatorit e vitit 1913, " Jehona ", Shkup, 1993, 39.
[22] Albert Ramaj, Dëshmitar kohe - Dom Zef Ramaj (1882 – 1914) famullitar dhe mësues në Shkup, St.Gallen, 2014, 168.

Kështu nisi puna për korpusin "Illyricum Sacrum", të cilit Daniele Farlati do t'i kushtonte gjithë jetën e tij. Me dokumente dhe fakte ai argumenton prejardhjen tonë shumë e shumë kohë para së të vinin sllavët në Ballkan.

Në kreun e dytë janë përpunuar aktivitetet dhe roli i ipeshkëve të Ipeshkvisë së Shkupit. Këtu është paraqitur kronologjia i ipeshkëve që kanë qeverisur me Ipeshkvinë e Shkupit. Ndër ata që kanë lënë gjurmë në forcimit të Ipeshkvisë së Shkupit, pa dyshim është Andrea Bogdani. Po ashtu Pjetër Bogdani kontribuoi shumë, jo vetëm se në çështjet fetare, por angazhimi i tij ishte i madh edhe në letërsinë shqiptare. Toma Raspasani është një vazhdues i punës së Andrea dhe Pjetër Bogdanit, për të faktorizuar rolin e Ipeshkvisë së Shkupit. Kontributi At Zef Ramaj në çështjet fetare e arsimore, po ashtu është mjaft i madh. Ramaj ishte dëshmitari i cili e njoftoi botën për masakrat që i bënin ushtria serbe ndaj popullatës shqiptare në krahinën e Shkupit gjatë periudhës së tetor – dhjetor të vitit 1912. Kontributi i Lazër Mjedës ishte i gjithanshëm, duke u angazhuar në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe në Ipeshkvin e Shkupit, në mobilizimin e besimtarëve në ruajtjen e identitet kombëtar.

Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, më vonë Mbretëria Jugosllave nëpërmjet reformës agrare dhe kolonizimit dëshironte shfarosjen e popullit shqiptar nga këto treva. Për të pasqyruar dhunën sistematike që ushtronte Mbretëria Jugosllave, nga tre priftërinjtë don Gjon Bisaku, don Shtjefën Kurti dhe don Luigj Gashi, hartuan "Memorandum për pozitën e popullit Shqiptar në Mbretërinë e Jugosllavisë", i cili u dërgua në Shoqatën e Kombeve në Gjenevë dhe në të gjitha kancelaritë evropiane.

Në kreun e tretë të librit pasqyrohet zhvillimi arsimor i shkollave katolike shqiptare në Shkup. Në këtë çështje shquhej kontributi e Kolë Bojaxhiut në çeljen e shkollave shqiptare në Shkup. Kolë Bojaxhiu ishte edhe protagonisti për themelimin e bandës muzikore "Zani Maleve" në Shkup, e cila i printe me 12 gusht 1912 marshimit të mijëra kryengritësve gjatë çlirimit të Shkupit. Po ashtu me të hollat e tij u ndërtua Teatri i qytetit. Por fatkeqësisht angazhimi i tij për çështjen kombëtare, arsimore dhe kulturore të popullit shqiptar, i pengonte pushtuesit, andaj atë e helmuan dhe përfundoi me vdekje.

Në kreun e katërt pasqyrohen arritjet kulturore të shqiptarëve katolik në qytetin e Shkupit. Ndue Bytyqi (poet), është shuguruar meshtar në Argjipeshkvinë e Shkupit. Në seminar është prej 11 shtatorit 1859. Qysh në

fillim të veprimtarisë së vet shërbeu në Famullinë e Shkupit (1884). Pastaj bëhet famullitar në Prizren. Dom Ndue Butyqi kishte vepruar si mësues në shkollat katolike në trevat verilindore. Ai njihet në qarqet letrare më së miri përmes poezive të veta, ndërsa një vlerësim pozitiv për këtë poet kishte bërë poetit arbëresh Leonardo de Martini. Ky i fundit kishte publikuar veprën «*L'Arpa di un italo-albanese*» (Harpa e një arbëreshi) më 1881 në Venedik, e në fakt, dom Ndue Bytyqi nxiti poetin dom Martino që ta botonte këtë vepër. Bytyqi ia kushtoi një sonet prekës mikut të tij Leonardo de Martin. Bytyqi u kishte shkruar një poezi me emrin "Mymleqeni" (Atdheu), që u botua më 1887, ky botim mbeti i njohur për publikun shqiptare. Lorenc Antoni (kompozitor) është marrë intensivisht me kompozime, dirigjime të veprave, veprimtari pedagogjike, etj. Në fushën e studimit të folklorit, Lorenc Antoni vlerësohet se i pari mblodhi dhe botoi shtatë vëllime të muzikës popullore shqiptare të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Moravës Jugore të shoqëruar me analiza etnomuzikologjike mbi gjithë këtë lëndë që është transkiptuar po prej tij. Don Gaspër Gjini (klerik, intelektual, poliglot, krijues dhe shkencëtar), është i pari që dha një paraqitje panoramike të historisë së krishterimit në popullin shqiptar, prej kohës apostolike e deri në ditë tona. Pa dyshim se, vepra kruciale e tij është studimi shumë i rëndësishëm *''Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj''.* Vinçenc Gjini konsiderohet si nismëtar dhe profesor i parë universitar i muzikës, pionier i shkollimit të lartë në trevat verilindore.

Veshja popullore ka qenë një element specifik që ka përcaktuar edhe përkatësinë kombëtare shqiptare, madje si e tillë ajo ka qenë edhe një faktor tejet integrues, apo përbashkues pa marr parasysh divergjancat e natyrës fetare. Pra, ajo ishte një kod i mirëfilltë i unitetit të përkatësisë kombëtare shqiptare. Në këtë drejtim, edhe shqiptarët e konfesionit katolik të Shkupit në periudhën midis dy luftërave botërore kishin ruajtur me xhelozinë më të madhe të gjitha pjesët e veshjes sonë popullore. Karnavalet ishin pjesë përbërëse e rrjedhave të përgjithshme të kulturës popullore që praktikohej në Evropën e qytetëruar, përkatësisht nëpër qendrat e saja më të fuqishme urbane. Pra, rezulton se edhe shqiptarët katolikë të Shkupit, në kohën midis dy luftërave botërore, shijonin frytet e këtyre kremteve popullore, përkatësisht karnavaleve kur shpërthente gëzimi dhe hareja në zemrat e tyre.

Në kreun e pestë të librit, nëpërmjet fotografive dhe letërkëmbimit, pasqyrohet veprimtaria e dy humanisteve shqiptare nga Shkupi: Gonxhe Bojaxhiu (Shën Tereza) dhe Nasta Mihili (misionare e përkryer e cila e

shoqëronte Nënë Terezën deri në Bengal). Për këtë qëllim, rajoni i Shkupit i ka shfaqur Zotit shumë zemra fisnikërie. Gjatë jetës së tyre në Shkup, punonin në shoqata dhe dalloheshin për të mirat që i bënin. Gjithnjë mendimi i tyre ka qenë i drejtuar nga misionarët. Nga momenti që shkuan në misione, po edhe tani, shembulli i tyre nxitë idealizmin te të rinjtë.

Në kreun e gjashtë pasqyrohen dëshmitë familjare të katolikëve të Shkupit. Faktikisht, ky është edhe boshti i trajtimit të kësaj monografie. Nga dëshmitë e dhëna ka rezultuar që për së pari herë të shtjellojmë një temë e cila më së miri argumenton prezencën tonë mijëra vjeçare në këtë qytet.

Një ndër familjet që identifikon familjet katolike në Shkup, është ajo e Bojaxhive. Në këtë familje me xhelozi është ruajtur aspekti identitar, kulturor dhe fetar shqiptar. Ndërsa, familja Antoni, ishte në lidhje familjare me familjen Bojaxhiu. Kjo familje nxori nga gjiri i vet figurën markante të Lorenc Antonit, një kompozitor i shkëlqyer dhe i vlerësuar nga institucionet akademike. Nga kujtimet e tij e kuptojmë rininë e Gonxhe Bojaxhiut (Shën Terezës). Familja Serreqi në Shkup ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare, arsimore dhe kulturore. Familja Ukajdari është familje e cila ka një histori të bujshme në të gjitha sferat e jetës, por më e rëndësishme tek kjo familje qëndron kultivimi i atdhedashurisë dhe mbajtja me xhelozi të traditave kombëtare dhe fetare. Kjo familje ishte e lidhur me krushqi me familjen atdhetare Kurti, në të cilën familje shquhej dom Shtjefën Kurti. Familja Gjini ishte një nga familjet më të respektuara në Shkup. Anëtarët e kësaj familjeje arritën nivelet më të larta të arsimit. Për kohën dhe për jetën ata tregoheshin si patriotë, fetarë dhe aktivistë. Ata e ndërtuan aktivitetin e degës në të gjitha sferat e jetës - sociale dhe fetare, kulturore dhe arsimore. Familja Ndreca në Shkup, është ndër familjet që me xhelozi ruan traditat e vjetra qytetare në Shkup. Familja Marku shtëpinë e kishte në sheshin e Shkupit, aty ku ishte edhe lagjja e katolikëve shqiptar në këtë qytet.

Në kreun e shtatë janë pasqyruar varrezat katolike shqiptare në Shkup. Një mbështetje e fuqishme dokumentuese për praninë e vazhdueshme të shqiptarëve të konfesionit katolik këtu në Shkup është edhe onomastika. Si një lëmi shkencore e cila studion dy grupe të mëdha emrash, pra emrat vetjakë (antroponimet dhe patronimet) dhe emrat e vendeve (toponimet), onomastika del e një rëndësie tejet të madhe. Kjo, meqë këta emra-onoma, janë në të vërtetë një lëndë shumë e vjetër, sa edhe vetë gjuha, lëndë e ngulitur thellë në mbamendjen popullore, e bartur brez pas brezi deri më

sot. Në rastin tonë, duke u mbështetur në korpusin e fotografive të shkrepura në varrezat e shqiptarëve katolikë në Shkup, ne do të thoshim që emri rron i skalitur në këto rrasa guri, për të na dëshmuar praninë e shqiptarëve katolikë këtu në Shkup. Dhe kjo prani e tyre këtu, përcillet me dy të vërteta që shpalosen pasi të analizohet ky material onomastik.

Në kreun e tetë trajtohen kishat katolike në qytetin e Shkupit**.** Kisha në Shkup në periudha të caktuara historike nuk ka luajtur vetëm si objekt i kultit, por ajo ka qenë bartëse e proceseve arsimore dhe kulturore. Mesha zhvillohej në gjuhën e besimtarëve në gjuhën shqipe, por me shpërnguljen e popullatës katolike nga ky qytet, mesha për disa dekada nuk zhvillohet në gjuhën shqipe, dhe sidomos pas vdekjes së dom Gaspër Gjinit.

Gjatë përpilimit të këtij libri me dokumente, me rëndësi të posaçme ishte shfrytëzimi i dokumentacionit arkivor nga: Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë, Arkivi i Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar, Arkivi Shtetëror i Vjenës, Arkivi i Lucernit, arkivat hungareze dhe arkivat familjare të katolikëve shqiptarë të Shkupit. Këto hulumtime rezultuan me gjetjen e dokumenteve, fotografive, hartave, raporteve të konsujve që ishin në përfaqësitë konsullore në Shkup; shumica e fondeve janë fonde që i kanë ruajtur familjet katolike shqiptare. Nëpërmjet intervistave që i kemi zhvilluar me kryefamiljarët të shqiptarëve katolik në qytetin e Shkupit, kemi arritur që të zbardhim e të rikthejmë memorien kolektive dhe të argumentojmë për prezencën tonë që nga themelimi e deri në ditët e sotme.

Nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, dokumente dhe raporte që janë sjellë në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë. Të një rëndësie të veçantë janë edhe hulumtimet e materialit arkivor që gjenden në Bibliotekën dhe Arkivin e Lidhje së Kombeve në Gjenevë, Nga këto dy arkiva është siguruar "Memorandum për pozitën e popullit shqiptar në Mbretërinë e Jugosllavisë", i përpiluar nga tre priftërinjtë e lartpërmendur shqiptar.

Fonde të shumta të dokumenteve dhe fotografive janë marrë nga më shumë arkiva evropiane Arkivi Shtetëror në Vjenë, Arkivi Shtetëror në Luzer, Arkivi i Qytetit në Budapest, Arkivi Piedestar në Budapest, Arkivi i Famullisë së Prizrenit, Arkivi Propaganda Fide në Romë dhe Arkivi i Familjes Kukaj në Australi.

Nga arkivi i familjes Serreqi kemi siguruar fondin e duhur të dokumentacionit të fotografive, dokumenteve dhe certifikatave që flasin për kontri-

butin e pjesëtarëve të kësaj familje për çështjen kombëtare, arsimore e kulturore. Këtë fond e kemi siguruar nga pinjolli i kësaj familje z.Anton Serçi, të cilin e kemi edhe intervistuar.

Nga arkivi i familjes Ukajdari kemi siguruar një gamë të gjerë të dokumentacionit, duke përfshirë dokumente që flasin për arsimin në gjuhën amtare, për trashëgiminë kulturore, por edhe fotografi që flasin për veshjet tradicionale të shqiptarëve katolik në Shkup. Po ashtu kemi intervistuar edhe pinjollin e kësaj familje z.Palosh Ukajdari, i cili ishte në dispozicion tërë kohën për të siguruar burimet relevante për të botuar këtë libër.

Nga arkivi i familjes Antoni kemi siguruar historikun e saj, po ashtu në shërbim të jetësimit të këtij projekti për familjet katolike shqiptare në Shkup, i kemi në dispozicion edhe shumë fotografi, dokumente. Po ashtu për këtë çështje e kemi konsultuar mbesën e familjes Antoni z.Alma Bejtullahu, nga e cila kemi siguruar informacionet e duhura për kontributin e kësaj familje në ngritjen e vetëdijes qytetare tek shqiptarët e Shkupit.

Nga arkivi i familjes Nrecaj kemi siguruar shumë fotografi të cilat flasin për traditat, zakonet e familjeve katolike në qytetin e Shkupit. Kemi zhvilluar edhe një intervistë me pjesëtaren e kësaj familje z.Drita Nrecaj, e cila flet gjerë e gjatë për bashkëjetesën dhe harmoninë ndërfetare e kombëtare që ka mbretëruar në qytetin e Shkupit.

Po ashtu kemi hulumtuar në Katedralen "Zemra e Krishtit", ku me ndihmën e priftit i cili shërbente në këtë kishë, dom Davor Topiç, kemi arritur të sigurojmë një shenjë të zanatit të vjetër të filigranëve. Në të vërtetë, paraardhësit e mjeshtërve të vjetër, në nder të kanonizimit të Nënë Terezës, punuan dhe e dhanë si donacion një vepër të ndërlikuar të filigranit në Kishën Katolike, ku do të jenë të ruajtura të gjitha reliktet në lidhje me Nënë Terezën. Reliken e punuan zejtarët e rinj shqiptar Josip - Zef Mirdita dhe Leonardo - Mark Ljoni. Po ashtu morëm informacionet e duhura për pllakën që paraqet kujtim nga manifestimi i vitit 1902, kur Katedralja e Shkupit është vendosur nën kujdesin e 'Zemrës së Shenjtë të Krishtit'. Ky tempull është themeluar në vitin e pestë të Argjipeshkvisë të argjipeshkopit Pashkal Troski, dhe i bekuar nga po ai më 2 dhjetor 1902.

Nga arkivi i familjes Marku kemi siguruar fotografi dhe dokumente, që flasin për jetën, traditat dhe ceremonitë fetare që janë zhvilluar në qytetin e Shkupit. Po ashtu kemi intervistuar edhe pinjollen e kësaj familje z.Angjelina Marku, nga e cili kemi nxjerrë të dhëna shumë të vlefshme për jetën shoqërore të kësaj familje dhe shqiptarëve në tërësi në krahinën e Shkupit.

Përveç hulumtimit të dokumentacionit të publikuar dhe të papublikuar arkivor, gjatë punimit është shfrytëzuar edhe literatura ekzistuese historiografike dhe periodiku, i botuar kryesisht në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Shpresojmë që përmes këtij botimi, sadopak kemi bërë të mundur që të pasqyrojmë historinë e familjeve katolike shqiptare të Shkupit, duke ndriçuar edhe fakte dhe të vërteta të reja historike, të cilat gjithnjë e më tepër po mbulohen nga pluhuri i harresës.

Qershor 2018, Shkup

FORWARD

To demonstrate the uninterrupted autochthony of Albanians in the City of Skopje and to argue about this thesis, it was imperative to examine tradition, folklore, language, religion, and the cultural heritage of the old Catholic Albanian families.

The monograph with documents, photographs and testimonies about the Albanian Catholic families of Skopje is a book that seeks to put a mark on the time we live, a book that, aims to refresh our historical past, through which our fortunes were crossed during history.

Historians should be oriented towards revealing the historical past of the city of Skopje and the historic skylines of these lands. It is of grave importance to discover and show the dormant cultural heritage found in Albanian Catholic families. From this depends the scientific discovery of information about the Ancient City of Dardania, The Diocese of Skopje - Prizren (medieval), Vilayet of Kosova (Ottoman period), which are clear arguments in proving the uninterrupted Illyrian - Arberor- Albanian continuity. Thus, the work of Albanian historiography should also be an incentive to bring forth the Albanian cause in Skopje, by tracing the country's history through time and space, the people and events of the Albanians of Macedonia, of the historical and modern day Skopje.

Skopje, though invaded multiple times during these millennia, with each invader worse than its predecessor, never lost its ancient cultural identity, linked to one of the oldest Nations in the Balkan: Illyrian-Arberor-Albanians. Skopje is the agora of these land, a square that interconnects many events, personalities, stories, hopes and disappointments.

According to the historical data provided by the ancient authors (Strabo, Ptolemy, Titus Livius Patavinus, Marcellus, etc.) the first inhabitants of the city of Scupi were the Illyrians.[23] Even the Serbian scholar, Mita Kostić, proves the thesis that the first inhabitants of Skopje were the Illyrians.[24] Judging by the geographical prism and indications of the location of the first inhabitants and the archaeological expeditions that took place in this

[23] Tomo Smilaniq - Брадина, Скопље и околина, Скопље , 1928, f.8; Skopje, Enciklopedija Jugoslavije, R – Serbija, Zagreb, MCMEXVIII, f.210.

[24] Мита Костић, Град Скопље и његов историски значај током векова , Скопље и Јужна Србија, Скопље, 1925, f.26.; Skopje, Enciklopedija Jugoslavije, R – Serbija, Zagreb, MCMEXVIII, f.210.

city, we can conclude that they lived in the mountainous parts of this city.[25] Skopje is located in the central Illyrian region and is oriented towards south as a typical continental region. According to historical data from ancient authors', we are dealing with an autochthonous culture that has shown resistance to Hellenization.[26] According to many sources, the Dardanians founded this city in the IV century BC and Scupi was the capital of the Kingdom of Dardania.[27]

Evans was an archaeologist who discovered the location of the city of the Roman colony of Scupi, on the left side of the River Vardar, at Zllokuqani and Bardovci (Bardhi - S.A), where the river Lepenc flows into the river Vardar. When the Romans occupied Macedonia and Paeonia in 168B.C. Scupi was invaded and transformed into the Dardanian Metropolis, the capital of the province of Dardania. This role of Scupi as the capital of the Roman province of Dardania will last for five centuries.[28]

In the post-Roman period, Scupi was transformed into a trade city and its road connected the most popular strategic axes of the Balkans, such as: Via Dezeta (Skopje-Prizren-Shkoder road Via Egnatia (Skopje - Ohrid - Durrës, and Thessaloniki - Constantinople); Via Naisus (Nis) - Singidinium (Belgrade), and Via Sertika (Sofia) - Adrianopolis (Edrene).[29] For the role that the City played it received the epithet "quirinae tribe".[30]

---

[25] Томо Смиланић - Брадина, Скопље и околина, Скопље, 1928, f.9.

[26] Fanula Papazoglu, Politiçka organizacija ilira u vreme njihove samostalnosti, Simpozijum o ilirima u antiçko doba, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1967, f.14

[27] Serge Metais, Historia e Shqiptarëve nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, Tiranë, 2004; J.G.v. Hahn, Reise von Belgrad nach Salonik, Wien, 1868, f.105; Јован ПоповскиJovan, Скопје, Скопје, 1965, f.19-21; Prof. ST. Stanoejeviq, Narodna Enciklopedia, kniga IV, Beograd, 1921, f.156; Skopje, Enciklopedija Jugoslavije, R – Serbija, Zagreb, MCMEXVIII, f.210.

[28] A. Evans, Antiquarian researches in Illyricum.Part.IV, f. 134; Fanula Papazoglu, Politiçka organizacija ilira u vreme njihove samostalnosti, Simpozijum o ilirima u antiçko doba, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1967, f.14; Мита Костић, Град Скопљеи његов значајтоком векова, Скопље и Јужна Србија, Скопље, 1925, f.26.

[29] Гавро Чкаранић, Пут са Албанског приморја у унутрашности, Путеви у Средновековној Србије, Београд, 1974, f. 77 – 102; Vladimir Blavatsky, Apollonia et les Illyriens (Avant 229 Av. Notre Ere), Actes du VIII Congres International des Scientces Prehistoriques et Parahistoriques, Beograd, 1971, f. 237; Fanula Papazoglu, Srednjobalkanska Plemena u Predrimsko Doba (Tribali, Autarjati, Dardanci, Skordici i Mezi), knjiga. XXX, Akademija Nauka Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1969, f.190; Antonie Nikolovski – Dimitar Cornakov – Kosta Balabanov, The Cultural Monuments of the People's Republic of Macedonia, Skopje, 1961, f.11.

[30] Radosllav .K, Suvremena Israzivanja o Jeziku Starosjedilaca Ilirskih Provincija, Simpozijum o Teritorijalnom i Hronoloskom Razgranicenju Ilira u Prahistorisko Doba, knjiga. IV, Naucno Drustvo SR Bosne Hercegovine, Sarajevo, 1964, f. 15 – 28; Мита Костић, Град Скопље и негов историски значај током векова, Скопље и Јужна Србија, Скопље, 1925, f.26

The most glorious period of Skopje as the capital of the Northern Illyria Prefecture during the early Middle Ages was during the time of Byzantine Emperor Justinian I. He built the town Justiniana Prima, located in today's Skopje, based on the ruins and archaeological finds by many scholars. Evans found the first object as part of Justiniana Prima, the acropolis at Skopje Fortress. They believe this acropolis, which is the upper part of the city, to be the remains of the monumental frontal wall on the north and north-eastern side of the stone arch built in the VI century with stone blocks and monument of the ancient Scupi.[31] Recent archaeological expeditions at the Fortress of Skopje, prove Evans' on site findings of Justiniana Prima in this locality. From recent studies, we can conclude that the first Diocese in Dardania was in the town of Scupi near today Skopje, (5 km north, by the Naissus - Scupi - Thessaloniki road), at the premises called Zajçev Rid, an archaeological site where a wonderful basilica of early Christianity was discovered.

Many sources also refer to the letters about the Dardanian church of this period, about the Dardanian church during the time the Slaves migrated to Dardania and for Dardania's Christians, about the inhabitants of these lands, about the Diocese of Prizren and its leaders, about the bishops of this period, etc. The letters are preserved mainly in the old papal collections and are of great historical importance because they are about many controversial issues and they represent the Holy See's (Sancta Sedes) attitude towards various problems of some churches. These letters are listed and according to those who sent them, they are: a) Papal letters sent to the bishops of Illyricum, ecclesiastical superiors, b) Emperor's letters, about the problems presented to the emperor and church, and c) the letters of the Dardanian bishop. According to the scholar Gasper Gjini, only only two letters that the Dardanian bishops have sent to the famous ecclesiastical and secular personalities are preserved. [32]

The first letter was the answer of Emperor Leon of August, while the second letter dated back to 494 A.D. and it is a response from the Dardanian bishops send to Pope Gelasius I. Certainly (according to this scholar)

[31] Exhlale Dobruna – Salihu, Të dhënat mbi ndërtimet dhe rindërtimet urbane të Justinianit I në trevën dardane, "Kërkime historike", nr.4, Shkup, 2011, 21-36; Mixhait Pollozhani, Materialet e reja arkeologjike dëshmi për Justiniana Prima në Kalanë e Shkupit, " Kërkime historike", nr. 4, Shkup, 2011, 37-49.

[32] Gasper Gjini, Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj, Prizren, 2011.

there have been many other letter, but they were destroyed during the thunderous centuries and frequent occupations from different barbarian nations.[33] The city of Skopje, as the capital of Dardania, played an important role during the period of antiquity, in the political, cultural, economic, transport and ecclesiastical aspect. The historical dates of different origins, archaeological expeditions developed in the XIX century, between the two world wars and after World War II, prove the Illyrian culture of this city.

The bishop's seat remained empty for nearly two centuries. The sources published by Albanian scholars also refer to the names of the bishops of this period. The first bishop, according to these records, dates back to the time of the Bulgarian King Kaloyan (1204), during the reign of Pope Innocent III (1198-1216). In a letter sent to the Pope, we can find the signature of the Bishop of Skopje and Prizren. In 1229, the Bishop of Skopje was John, born in Constance. The next bishop of Skopje in 1327 was John Lemegu, succeeded by Fridericus R. in 1354, and so on, until 1659 when the king of Hungary appointed Hiacintin bishop to Canad and thus the front of the Skopje Diocese's was without a ruler.

After these, the Bishop's seat remained vacant for nearly two centuries. The data published by Albanian scholars also refer to the names of the Bishops of this time. The first Bishop, according to these documents, dates back to the time of the Bulgarian King Kaloyan (1204), during the reign of Pope Innocent III (1198-1216). In a letter addressed to the Pope, we can uncover the signature of the Bishop of Skopje and Prizren. In 1229, the Bishop of Skopje was John, born in Constance. The next Bishopof Skopje in 1327 was John Lemegu, succeeded by Fridericus R. in 1354, and so on, until 1659 when the king of Hungary appointed Hiacintin Bishopto Canad and thus the front of the Skopje Diocese's was without a ruler.

Në dokumentin e Kolegjit të Leretos në Itali, për Toma Raspasanin shkruhet se ishte nga Letnica. *Në kolegj arriti më 1665 në vendin e paraparë për argjipeshkvinë e Shkupit, me rekomandimin e Andrea Bogdanit dhe me ndihmën e kardinalit Protetore. Para ardhjes në Loreto, Toma kishte mësuar gramatikën siç duket në vendlindjen e vetë "ha studuato li principi della gramatica". Toma ishte 14 vjeç kur erdhi në kolegj. Mirë e fliste gjuhën turke dhe ilire, "parla bene la lungua Turxhesca et Illirica" (në këtë rast kur thuhet gjuhën turke, mund të jetë edhe gjuha shqipe, por edhe turke, kurse Illirica është përdorë për gjuhën kroate/serbe, Toma njifte mirë gjuhë shqipe, bile edhe dialektin e Pultit, këtë e dëshmon letra e Pjetër Bogdanit, kur i rekomandon Romës që Toma të emërohet ipeshkëv i Pultit) por nuk e njihte në fillim gjuhën italiane. Me ardhjen e tij në Loreto, menjëherë në depo i dha 10 skuda, të cilat ia dorëzoi administratorit të qytetit të Loretos, Ottonit. Para se të vinte në Loreto, Toma ishte në Romë. Nga Roma erdhi më 6.I.1665 ku e kishte dhënë betimin. Më 8.IV.1665, Ipeshkvi Augustin Franciatti të shtunën e madhe ia ndau katër rende të ulëta. Studimet e filozofisë i kreu më 3.II.1667 duke treguar sukses të mirë. Rendin e subxhakonit (subxhakon apo subdiakon është rend kishatar që është para së të shugoruohet prift) ia ndau monsinjor Burani në kapelën e kolegjit ilirik të Loretos. Teologjinë morale dhe skolastikën e kreu më 3.II.1670, ndërsa më 26.IV.1672 shkoi nga kolegji. Ka qenë i sjellshëm, i shëndoshë, i arsimuar dhe predikatar i mirë. Ishte i afirmuar dhe i aftë për çdo funksion kishtar (është* fjala se ishte i aftë të shugurohet për prift dhe të merr funksionet e ndryshme). Pas përfundimit të studimeve Toma u kthye në ipeshkvinë e vetë të Shkupit, ku u shugurua për prift.

Në fillim shërbeu si kapelan në Trepçë. Për këtë emërim e kishin kundërshtuar turqit, prandaj ishte i obliguar të largohet nga Trepça për shkak të presionit të turqve, dhe shkoi në Prizren, ku edhe emërohet famullitar. Më vonë shkoi në Prishtinë e Vushtrri, ku edhe nga aty më 10 korrik dhe më 16 dhjetor 1657, kërkon ndihmë nga kongregata, sepse besimtarët e ishin shumë të varfër, meqë ishin detyruar që të gjithë pasurinë e tyre t'ua jepnin turqve. Më 1680 turqit akuzonin Toma Raspasanin se nuk u kishte paguar tatim. Më 15 mars 1682, Toma Raspasani i shkruan Propagandës Fide që të përkrahë veprimtarinë e tij si meshtar në territorin

e Ipeshkvisë së Shkupit, ku flet edhe për shkollimin e tij në Loreto, të cilin e kishte përfunduar me sukses. Është interesant fakti se Toma Raspasani kishte tentuar që të vepronte edhe si mësues në Ipeshkvinë e Shkupit. Më 28 korrik 1683 ipeshkvi i Shkupit, Pjetër Bogdani, e rekomandon Toma Raspasanin të emërohet ipeshkëv i Pultit, ndërsa më vonë e emëroi vikar gjenaral i asaj ipeshkvie, për shkak se Toma ishte shumë i mirë dhe e njihte shumë mirë gjuhën shqipe të asaj zone.

Më 1687 Pjetër Bogdani e njofton Romën se kishte vështirësi me turqit, pasi që kishin ngritur prapë tatimet, dhe kjo për besimtarët ishte vështirë, por edhe për Toma Raspasanin, pasi që turqit e kishin maltretuar famullitarin e Prizrenit, të cilin e kishin përzënë nga aty, e ai ishte fshehur në Prishtinë. Turqit kishin vështirësi me veprimtarinë e Tomës në Ipeshkvin e Shkupit dhe të Pultit, për shkak të aktivitetit të tij, sidomos në përkrahjen e betejave austriake të udhëhequra nga Pikolomini (Johann Norbert Graf Piccolomini), i cili vdiq në Prizren më 1689. Të njëjtin vit vdiq edhe Ipeshkvi i Shkupit, Pjetër Bogdani, i cili ishte përkrahës i madh i ushtrisë austriake që luftonte kundër turqve në Ballkan. Pas vdekjes së Pikolominit dhe Bogdanit, Toma Raspasani kishte përgjegjësi jo të vogël për Ipeshkvinë e Shkupit, sepse ishte vikar gjeneral i ipeshkvisë dhe në fakt e udhëhiqte atë.

Gjatë luftërave austro-turke (1683-1699), kishte edhe shumë ndryshime demografike, pasi në ato vende ku turqit fitonin, sikurse në Shkup, Kaçanik apo Prishtinë, jeta e të krishterëve nuk ishte e lehtë, dhe shpeshherë ishte në pikëpyetje edhe mbijetesa. Është interesant që të cekim faktin se gjatë betejës në Shkup, ky vend ishte djegur dhe shkatërruar. Poashtu edhe katedralja e Shkupit "Tanto veneranda" ishte shkatërruar tërësisht. Siç shkruan edhe Stefan Gapsari në atë kohë, pasi që Shkupi dhe katedralja e Shkupit e cila i ishte kushtuar Zonjë Mari, poashtu ishte shkatërruar, orën e Zojes së Shkupit, e punuar në dru ku paraqitet Marija me Jezusin në dorë dhe ka një mollë në dorën tjetër, e që është punë artistike e punuar në Shkup qysh në shekullin e XVI, e që ndodhej në katedralen e Shkupit deri më 1689, e morën besimtarët për ta mbrojtur dhe e strehuan në vende malore në afërsi të Shkupit. Siç duket një herë e strehuan në Kratovë të Maqedonisë, sepse Kratova ishte famulli katolike në atë kohë, e më vonë në Letnicë, ku kjo orë artistike e punuar në dru edhe sot ruhet në Kishën e Letnicës, që është edhe vend i shenjtë për shtegtarët e të gjitha religjioneve në Ballkan. Është me rëndësi të ceket se e gjithë Ipeshkvia e Shkupit dhe e Prizrenit shtegtojnë gjatë muajit gusht çdo ditë në Letnicë tek Zoja

Cërnagore në Letnicë, e siç duket nuk është kjo rastësi. Poeti i njohur don Ndue Bytyqi nga Shkupi publikoi poezinë/këngën „N`Cernagore kem nji Nanë“, që është e vetmja këngë burimore kishtare shqiptare. Për këtë këngë shih tek dom Ndue Bytyqi. Poashtu duhet cekur se në këtë vend, pra para orës së Zojës Cërnagore (Madona e Zezë) në Letnicë, Gonxhe Bojaxhiu (Nënë Tereza) vendosi të shkonte në mision. Kjo orë e Zojës Cërnagore, në mesin e popullatës vendase ka një legjendë të shekullit XVII, se ajo tri herë fluturoi çuditërisht prej Shkupit në Letnicë, (pra, edhe pse është sjellë në Shkup, ajo prapë fluturonte në Letnicë). Cekëm këto gjëra për Zonjën Cernagore të Letnicës dhe pruporen e Zonjës se Shkupit që ishte sjellë për t'u ruajtur në këtë vend, meqë rolin kyç duhet të kishte pasur Toma Raspasani, pasi që ai kishte njohur rrethanat në vendlindjen e vet, pra në Letnicë dhe Shkup, dhe se udhëtimi në këmbë nëpër male për atë kohë prej Shkupi në Letnicë nuk ishte edhe i lehtë për një gjë të tillë. Kisha e sotme e Letnicës filloi së ndërtuari në vitin 1865, dhe mermeri i dyshemesë së Kishës së Letnicës është sjellë pikërisht nga Shkupi.



Truporja e Zojës Cërnagore në Letnicë, e cila deri më 1689 ndodhej në Katedralën e Shkupit /

The Statue of Our Lady of Crnagora in Letnica, which until 1689 was located at the Cathedral of Skopje

Më parë cekëm disa gjëra më aktuale për Kishën në Letnicë dhe vendlindjen e Toma Raspasanit që quhet edhe Famullia "Montenegro di Scopia", por do të kthehemi prapë tek Toma Raspasani.

Pasardhës i Pikolominit ishte gjeneral Friedrich von Veterani, i cili përmes Toma Raspasanit mundësoi që shqiptarët të jenë prapë në anën e ushtrisë austriake për të luftuar kundër turqve. Më 1690 gjeneral Veterani i urdhëron Toma Raspasanit që të vijë nga Beogradi (ku gjendej në atë kohë) në Nish që të jenë në ballë të kryengritësve shqiptarë kundër turqve. Veterani kishte marrë shumë informata nga Toma për gjendjen e shqiptarëve, sidomos në Veri të Shqipërisë. Në këtë kohe Raspasani ishte udhëheqës i shqiptarëve. Veterani jo vetëm që e kishte bërë përkthyes të gjuhës shqipe dhe kroate/serbe Toma Raspasanin, por e kishte emëruar edhe zyrtarisht sekretar personal të tij, ku shërbeu deri në fund të jetës së tij, kur ra në Betejën e Lugos (sot qytet në Rumani) më 1695.

Toma detyrohet të largohet nga Ipeshkvia e Shkupit, njëherë shkoi në Beograd, pastaj u kthye me urdhër të Veteranit në Nish, dhe prej aty i shkruan më 1 prill 1690 kongregatës në Romë dhe një kopje ipeshkvit Vicko Zmajević, një letër për gjendjen dhe vështirësitë e mëdha në ipeshkvinë e Shkupit, pas disfatave të ushtrisë austriake kundër asaj turke në betejat e Shkupit dhe Kaçanikut, ku shqiptarët luftuan në anën austriake. Aty Toma shkruan se nga Prizreni dhe Peja nuk ka mundur të del asnjë shqiptar, e se çka ka ndodhur me ta, ende nuk është hulumtuar. Toma shkruan se në Pejë kishte lënë edhe nënën e vetë, dhe se shumica që e kishin braktisur Ipeshkvinë e Shkupit, ndodheshin në Beograd, bashkë me disa priftërinj. Toma ishte i obliguar të largohet nga Ipeshkvia e Shkupit më 1690 dhe u shpërngul fillimisht në Rumani, e pastaj në Hungari. Dy vite më vonë, Ipeshkvia e Shkupit kishte caktuar ipeshkvin e ri, Peter Karagic më 1692, e ky i shkruan Romës se Toma u largua me 500 katolikë nga Ipeshkvia e Shkupit në drejtim të veriut dhe se aty i shërbejnë Veteranit. Tomën më vonë e gjejmë në Rumani, më konkretisht në Karansebesch në taborin ush-tarak nga ku e falënderon Kongregatën e Romës për përkrahje financiare më 17 shtator 1693, kurse më 7 korrik 1694 shkruan nga Hermannstadt (Sibiu) i Rumanisë, se françeskanët e Bullgarisë ishin të detyruar të largoheshin nga vendi i vetë sëbashku më besimtarët katolik në Vllahi dhe Transilavani.

Pasi Toma i kishte shërbyer në shumë mënyra gjeneralit Veterani, më 1696 i shkruan Vjenës që të ketë një mbështetje të përhershme financiare me

nga 50 forinti në muaj. Në fakt, Toma jo vetëm që i kishte shërbyer Veteranit si përkthyes, por edhe i kishte përgatitur shkrimet zyrtare të tij, siç shihet nga një dëshmi mes gjeneral Veteranit dhe Feldmarshall Caraffe më 1695 në Hermannstadt (Sibiu) të Rumanisë. Jo vetëm kjo, por pas vdekjes së Veteranit, e veja e tij Maria Viktoria Veterani, dëshironte që Toma të jetë dëshmitar i gjërave/pasurive që kishte lënë Veterani, sepse familja Veterani kishte besim të plotë në Tomën, kurse auditori kryesor ishte Norbert Groner. Më 1701 e gjejmë Tomën të shërbente si famullitar në Hungari, konkretisht në qytetin Buda (Ofen) sot kryeqyteti i Hungarisë, dhe që ishte qendër e ipeshkvisë së atjeshme e quajtur Gran Esztergom.

Duhet cekur se Toma që përherë ceket si *Vicarus*, që prej fillimi të shekullit XVII ishte larguar nga ipeshkvia e Shkupit dhe qëndronte një kohë në Rumani, pastaj në Hungari. Emrin Vikar e kishte nga ipeshkvia e Shkupit që e kishte emëruar ipeshkvi Pjetërë Bogdani, jo vetëm për ipeshkvinë e Shkupit, por edhe të Pultit, e me këtë titull Toma ishte i njohur gjatë tërë jetës së vet. Kishte shërbyer si prift në Budapest të Hungarisë që prej vitit 1701 deri në vdekje më 30 maj 1718.

Duhet thënë se Toma nuk ishte *rregulltar,* siç ceket në disa shkrime, por ai mbeti deri në fund *prift diocezan*. Sipas Arnold Schoen, thuhet se Raspasani ishte prift petrin, por jo rregulltar. Priftërinjtë petrinë, sidomos në shekullin e XVI-XVII, ishin priftërinj oborrtarë apo priftërinj shumë të respektuar nga aristokracia, dhe kishin një kulturë të gjerë, jo vetëm teologjike. Toma kishte ardhur në Hungari me motrën e vet Katarinën dhe me djalin e saj Antonin. Toma kishte sens të stërholluar për artin, ndërsa shtëpia e tij ishte e mbushur me piktura të ndryshme jo vetëm me motive religjioze, por edhe me motive të natyrës. Edhe në *Budapest Fovaros Leveltara* (Arkivi i kryeqytetit të Budapestit), ka dokumente ku shënohet se Toma posedonte piktura me motive të ndryshme, si: Kryqëzimin me një postament të zi, Shën Barbara, Shën Ignatius Loyola, Shën Françesk Xaveri, motiv nga kalvari, mandej motive si Shën Ana, Shën Gjon Nipomuzzeni, Shën Gjergjin, Shën Antoni i Padovës, engjëlli, dhe po ashtu piktura me motive të natyrës.

Ipeshkvi i Ipeshkvisë Gran (Esztergom) Leopold Karl von Kollonitsch, emëroi famulltar Toma Raspasanin në Qytetin e Ujit (Vizivaros), konkretisht në pjesën Surburbium që ishte pjesë e qytetit e Buda/Ofen, pas mosmarrëveshjes mes françeskanëve (kapuçiëve) dhe jezuitëve. Në atë pjesë të qytetit jetonin edhe disa të huaj, edhe nga Ballkani, por edhe ata që

flisnin gjuhën gjermane, për të cilët Toma ishte përgjegjës. Toma nuk ishte i panjohur në Qytetin e Ujit (Vizivaros) Buda/Ofen, sepse qysh në këtë kohë, ai kishte një shtëpi në Buda dhe dy vreshta të rrushit.

Toma Raspasani ndërroi jetë më 30 maj 1718, duke lënë një testament më 19 maj 1718, në të cilin shënon, që në qytetin Ofen/Buda me pasurinë e tij, të ndërtohet një kishë për nderë të Shën Anës. Në këtë testament shihet se një shtëpi dhe dy vreshta rrushi i kishte dhuruar motrës së vet Katarinës që ishte e martuar më Petrus Vlassich (i cili kishte vdekur më 1710) dhe tre kuaj e një karrocë ia kishte lënë nipit të vet Anton Vlassich. Raspasani kishte edhe një mulli në Hanselbeck (Hamzsabég), por atë ia kishte dhuruar motrës së vet qysh para testamentit të shkruar. Toma kishte pasuri jo të vogël të asaj kohe, pasi që pas vdekjes u kishte lënë edhe të holla institucioneve apo personave të ndryshëm, përveç ato motrës dhe nipit të tij Antonit. Por është interesant të nënvizohet fakti se Toma kishe edhe mjete të kuzhinës për përgatitje të ushqimit, pjata shumë të mëdha dhe shumë lugë e pirunë dhe gjëra të ndryshme të kuzhinës. Në bazë të kësaj supozohet se Raspasani kishte mysafirë të ndryshëm dhe të shumtë në shtëpinë e vet. Më shumë kishte në shtëpinë e Raspasanit gjëra të kuzhinës sesa në bujtinat e shumta në rrethin ku ai vepronte e jetonte. Kurse, një shtëpi tjetër që kishte në Buda/Ofen e kishte lënë për ndërtimin e kishës së Shën Anës (Sent Anna templom), kisha që edhe sot gjendet në Budapest, në Batthyány, dhe që është një ndër kishat më të bukura të stilit barok në Budapest. Një shtëpi të tij e kishte blerë pas vdekjes së Tomës një i pasur aristokrat nga Ballkani, Johann Georg Metokovics-Cetto. Këtu po sjellim një pjesë të testamentit të tij të pikës 11, ku thotë: „*Sicut in vivis nil prius habui, aut desideravi, qvam ut honor S. Annae promoveatur, atqve hujus piae Intentionis intuitu pridem Ecclesiam qvandam optavi, ita huic etiam nunc inhaerens meam Donum pro Ecclesia ordino, qvo citius in Sanctum hunc usum convertandum, ne vero media desint, hisce omnia mea totam nimirum substantiam, qvatenus specialiter hic non disposui, prout in vivis feci, ita et modo plenissime offero, et S. Annae, qvam eatenus et modo praescripto Haeredem facio, consecro*."

Kisha e Shën Anës ku kishte shërbyer Toma Raspasani si famullitar dhe e cila pas vdekjes së tij është ndërtuar më vonë me pasurinë e Toma Raspasanit Ofen/Buda. Këtu mund të shihen kisha e Shën Anës, që gjatë kohës është ndërtuar në disa etapa e në fotografinë e fundit shihet kisha e Shën Anën në kohën e sotme.



Kisha e Kapucinëve në Ofen/Buda e vitit 1716, ku kishte shërbyer Toma Raspasani / The Capuchin Church in Ofen / Buda in 1716, where Toma Raspasani served



Kurorëzimi i Franz I si mbret i Hungarisë në Buda/Ofen më 1792, dhe anësh majtas shihet Kisha e Kapuçinëve ku kishte shërbyer Toma, kurse kjo tjetra është Kisha e Shën Anës e ndërtuar me para të Toma Raspasanit që kishte lënë me testament /

The coronation of Franz I as King of Hungary in Buda / Ofen in 1792, and on the left is the Capuchin Church, where Toma served, while the other is St. Anne's Church built with the money Toma Raspasan who had left in his will.



Kuvendi i Kapuçinëve në vitin 1864 (pikturë e Viktor Myskovszky) /

The Capuchin Assembly in 1864 (painting by Viktor Myskovszky).



Kisha e Shën Anës (Szent Anna templom) në Budapest në Sheshin Batthyány është rindërtuar prapë më vonë dhe kështu duket sot në foto më poshtë, dhe dëshira e tij ishte që kisha në këtë vend të mban emrin e Shën Anës që është e ëma e Marisë /

St. Anna's Church in Budapest on Batthyány Square has been reconstructed. It was Toma Raspasani's wish that the church in this country bears the name of St. Anne, the mother of Mary .

Testamenti i Toma dhe Katarina Raspasanit / Toma and Katarina Raspasan's Testament

Testamenti i Toma Raspasanit (shkruan Thomas Raspassani) i shkruar më 19 maj 1718 që ka 5 faqe, i shkruar në gjuhën latine dhe ruhet në arkivin e qytetit të Budapestit "Budapest Főváros Levéltára", Signatura: HU BFL - IV.1002.y - 1718 - I.2122, titulli "IV.1002.y - A megyei törvényhatóságok és törvényhatósági jogú városok. Buda Város Tanácsának iratai. Végrendeletek /Testamenta/."

Toma Raspasan's Testament (signed as Thomas Raspassani) is written on 19 May 1718. It has 5 pages, written in Latin and preserved at the ArchiveA of the City of Budapest "Budapest Főváros Levéltára", Signature: HU BFL - IV.1002.y - 1718 - I.2122, Tittle "IV.1002.y - A megyei törvényhatóságok és törvényhatósági jogú városok. Buda Város Tanácsának iratai. Végrendeletek /Testamenta/."


In Nomine Sanctissimæ Trinitatis Amen.

Quandoquidem Ego Thomas Raspasani
ex moderna mea infirmitate me magis ma-
giusq; deficere sentiem, Nec dispositionem
abhinc cœire nolim, de bonis meis aliquo
modo, et industriali hoc sequentia ordino

Primò vero et ante omnia animam Creatori
Suo redditurus, Sanctam ac beatificam Matrem
Annam deinceps ac felicitet rogo, quatenus illa
sicut per totum vitæ meæ tempus matrem me
adjuvit, ità et nunc maximè vero in ultimo mor-
tis articulo Salvatorem, animamq; Salvatori pro
felici æternitate reconciliare velit. Corpus verò
ex qua sumptum est, reliquo, voloq; ut iuxta
in Egypto apud S.ti A. R. R. P.P. Capucinos
deportatur, atque et eatenus prædicto

2do S.ti A. R. R. P.P. Capucinis florenos duentos
lego, quod R. vero mea Ecclesia exstructa fuerit,
volo, ut in eam corpus meum portetur, ibiq; Se-
peliatur.

3tio Sorori meæ Catherinæ Raspasani lego vineam
x 2. quadrantes in monte Sancti Gerardi, penes Xto

BUDAI LEVÉLTÁR
ÁRVASZÉK | I
TESTAMENTA | 2122
1



Gastinger aenarium. Item Supellectilem suam meam, Sex. item Sigillum Fuscum. Sunt collecti. Nepoti vero suo Antonio relinquo florenos 3. Equos cum pelicio violaz.

4to volo, ut post mortem meam iuxta Triduum in diversis Ecclesijs pro anima mea celebretur Sacra dicenta.

5to lego A. A. R. R. L. L. Franciscanis Bosnen. pro Sacris florenos centum et quinquaginta.

6to itidem pro Sacris lego A. A. R. L. L. Soc. Jesu florenos centum, ut 100. Sacra legant.

7mo A. A. R. R. L. Augustinis pro Sacris lego florenos decem.

8vo A. A. R. R. L. L. Carmelitis pro Sacris etiam florenos decem.

9no ancilla mea Anna Maria Pellegrina pro fideli Servitio lego florenos quinquaginta.

10mo futuro Corpori Equestri lego duos quarteri et 4. octi frumenti in monte Sancti Gerardi cum regando, ne vinea noceat, quia exercitus Ampl. Magistratum Budue officiose requiro, ut inspectionem habeat. Reverendum dominum Parochum vero, cui vinea Cimeteria cedit, oro, ut annue pro mea anima duodecim Sacra legat. Idem etiam Successor, cum pariter ei cum fructibus

vinea obvenient, promitto. Interim tamen non prohibeo, quo minus vinea vendi possit. Si ita Amplissimo Magistratui videbitur. Modo pecunia ad Interessi ponatur, idque Rev. Parochy recipiat, injuncto Sacra legat.

11mo Sunt in vicio vel primo habui ante decidere, quam ut honor S. Anna promoveatur, atq. hujus pia intentionis intuitu primum Ecclesiae quidam optavi, ita huic etiamnum in hoc meum domum pro Ecclesia ordino, quo citius in Structura hac rerum Concorditam, ne vero dubia desint, hinc omnia mea totam vicinis Laboratum, quatenus specialiter hui redditus vacui, prout in vicio sui, ita et modo plenissime offero, et si Anna, quam cautum et modo praescripto Haeredem facio, consuro. Ejus conscientiam aggravans, quicquid huic meae intentioni vel in minimo contravenire praesumpserit. Cumq. Amplissimo Magistratui incumbat Curam Sacrorum etiam in Spiritualibus habere, illiusq. plurimum proderit, si Sacrilegia Intentio Effectum Suum, qui citius consequatur, ea propter Ampl[ma] Magistratum hinc officiose requiro, quatenus hac mea alacriter aggrediatur, et absolvat: Tuorum enim ne Cornuden conscientia. Moreover

2 3





Testamenti i Katarina Raspasani (shkruan Catharina Raspassani) motra e Tomë Raspasanit i shkruar më1734 që ka 3 faqe, i shkruar në gjuhën latine dhe ruhet në arkivin e qytetit të Budapestit "Budapest Főváros Levéltára", Signatura: HU BFL - IV.1002.y - 1734 - I.2143, titulli "IV.1002.y - A megyei törvényhatóságok és törvényhatósági jogú városok. Buda Város Tanácsának iratai. Végrendeletek /Testamenta/."

Testament of Katarina Raspasani (signed as Catharina Raspassani) sister of Tom Raspasan written in 1734 with 3 pages, written in Latin and preserved at the Archive of the City of Budapest "Budapest Főváros Levéltára", Signature:: HU BFL - IV.1002.y - 1734 - I.2143, Tittle "IV.1002.y - A megyei törvényhatóságok és törvényhatósági jogú városok. Buda Város Tanácsának iratai. Végrendeletek /Testamenta/."







Toma Raspasani (1651-1718)

Toma Raspasani was born in 1651 in Letnica in Karadak, Skopje. A document found at the College of Leroe in Italy, provides datat that Toma Raspasan was from Letnica. He arrived at the college in 1665 at a scholarship spot secured for the Archbishop of Skopje, with Andrea Bogdani's recommendation and with the help of Cardinal Protetore. Prior to his arrival in Loreto, Toma had learned the basics of grammar in his motherland, "ha studuato li principi della gramatica". Tom was 14 when he started college. He spoke well in Turkish and Illyrian, "parla bene la lungua Turxhesca et Illirica" (in this case when they say Turkish thay mean both Albanian and Turkish language, while Illirica is used for Croatian / Serbian language, Toma was fluent in Albanian , even in the dialect of Pultus, this is evidenced by Pjetër Bogdani's letter when he recommends to Rome that Toma be appointed bishop of Pult). He, however, did not speak the Italian language at first. With his arrival at Loreto, he immediately handed over 10 scudos to the warehouse, which he handed over to the city's administrator of Loreto, Otto. Before going to Loreto, Toma was in Rome. From Rome arrived on January 6, 1665 when he was sworn in. On August 8, 1665, Bishop Augustin Franciatti on the Great Saturday, decorated him with four big orders. He finished his Philosophy on February 3, 1667 graduating with exceptional success. Monsignor Burani gave him, at the chapel of the Illyrian college of Loreto, the order of Subdeacon (a church order that was given before a priest was ordained). He studied moral theology and scholasticism on February 3, 1670, while on July 26, 1672 he left the college. He was polite, healthy, educated, and a good preacher. He was affirmed and capable of every ecclesiastical function (he was eligible to be ordained as priest and to receive various functions).

After finishing his studies, Toma returned at the Skopje Diocese, where he was ordained priest. At first he served as a chaplain in Trepça. The Turks opposed this post so he was obligated to leave Trepca because of the pressure from the Turks, and moved to Prizren, where he was appointed parish priest. Later, he moved to Pristina and Vushtri, on 10th of July and 16th of December 1657, he asked for help from the congregation, because the believers were very poor, since they were obliged to relinquish all their belongings to the Turks. In 1680 Turks accused Toma Raspasan for not paying taxes. On March 15, 1682, Toma Raspasani wrote to Propaganda

Fide asking for support of his activities as a priest in the territory of the Diocese of Skopje, where he also writes about his education in Loreto, which he had successfully completed.

It is interesting that Toma Raspasani had tried to work even as a teacher in the Diocese of Skopje. On July 28, 1683, the Archbishop of Skopje, Pjeter Bogdani, recommended that Toma Raspasan be appointed Bishop of Pult, and later appointed him a general vicar of that Diocese, because Toma was very good and spoke very well the Albanian language of that area.

In 1687, Pjetër Bogdani informed Rome that he had difficulties with the Turks, since they had raised the taxes again, and that was difficult for the believers, but also for Toma Raspasan, as the Turks had mistreated the parish priest of Prizren managing to drive him out of there, leaving him no choice but to go into hiding in Prishtina. The Turks had difficulties with Toma's activity in the Diocese of Skopje and Pult because of his activity, especially in supporting the Austrian army led by Piccolomini (Johann Norbert Graf Piccolomini), who died in Prizren in 1689, the same year the Bishop of Skopje, Pjeter Bogdani died who also was a great supporter of the Austrian army fighting against the Turks in the Balkans. After the death of General Enea Silvio Piccolomini and Pjeter Bogdani, Toma Raspasani had great responsibilities towards the Diocese of Skopje because he was a general vicar of the Diocese and became its leader.

Many demographic changes took place during the Austro-Turkish wars (1683-1699), in the cities where the Turks prevailed, such as in Skopje, Kaçanik or Pristina, the way of life of Christians was not easy, and survival was often questioned. It is interesting to note that during the battle in Skopje, this city was burned and destroyed by General Piccolomini. In addition, the Cathedral of Skopje "Tanto veneranda" was completely destroyed. Stefan Gapsari writes at the time, about the destruction of the city of Skopje and the cathedral of Skopje, dedicated to Virgin Mary. He writes about the clock of the Lady of the Skopje, made of wood where Mary appears with Jesus in one arm and an apple in the other hand, depicted in a wooden artistic work done in Skopje in the XVI century, located at the cathedral of Skopje until 1689 when it was taken under protection by the worshipers and hidden in mountains near Skopje. It seems that they first took refuge in Kratovo, because it was a Catholic parish at that time, and later at the Church in Letnica, where this artistic wooden clock is preserved

to this day, making Letnica a sacred place for pilgrims of all religions in the Balkan.

It is essential to note that thousands of pilgrims from the Diocese of Skopje and Prizren and beyond, gather every year in the south-east village of Letnica to mark the feast of the Black Madonna, a statue of blackened wood, which is believed to be carved more than 400 years ago in the style of Michelangelo. The renowned poet Ndue Bytyqi from Skopje published the poem/ song "N'Cernagore kemi një Nana", which is the only ecclesiastical song in Albanian. It should be noted that in this place, in front of the clock of of Our Lady of Crnagora (Black Madonna) in Letnica, Gonxhe Bojaxhiu /Mother Teresa, in 1928, when she was 17, while she was on this pilgrimage with her parents, decided to become a missionary and dedicate her life to charity. .According to the local legend of the XVII century the clock of Our Lady of Crnagora (Black Madonna), flew three times strangely from Skopje to Letnica (that is, although it was brought to Skopje, it still flew back to Letnica).

All these informations about Letnica's Lady of Cernagor's and the clock of the lady of Skopje that had been brought into custody of this Curch, since Toma Raspasani must have had to play the key role in its protection, giving the fact that he had known the circumstances in his hometown Letnica and Skopje, having to walk the mountains from Skopje to Letnica, a difficult task at those times. Today's Church of Letnica was built in 1865, and the marble floor the Church was brought from Skopje.

Piccolomin's successor was General Friedrich Von Veteran, who through Toma Raspasani allowed the Albanians to join the Austrian Army to fight against the Turks. In 1690, General Veterani ordered Tom Raspasani to come from Belgrade (where he was at that time) in Nis to be at the forefront of Albanian insurgents against the Turks. General Veterani had received plenty of information from Toma about the situation of Albanians, especially in the North of Albania. At this time, Raspasani was the leader of the Albanians. General Veterani had appointed Toma Raspasani not only as a translator of the Albanian and Serbo-Croatian language, but also appointed him as his personal secretary, where he served until the end of his life when he fell on the Battle of Lugo (today a city in Romania) in 1695.ns.

Toma was forced to leave the Diocese of Skopje and move to Belgrade, but then by the orders of the Veterani, he returned to Nis. From Nis, on

April 1, 1690 he wrote two letters, one to the congregation in Rome and another to the bishop Vicko Zmajević, explaining the current situation and the great difficulties of the Diocese of Skopje, after the defeat of the Austrian army by the Turkish army in the battles of Skopje and Kaçanik, where Albanians fought on the Austrian side. There Toma writes that no Albanian could get out of Prizren and Peja and no one knew what has happened to them, nor did anyone start an investigation. Toma writes he had left his own mother behind, in Peja, and that the majority of the people who had abandoned the Diocese of Skopje moved to Belgrade, along with several priests. Toma was obliged to leave the Diocese of Skopje in 1690 and originally moved to Romania, and then to Hungary. Two years later in 1692, the Diocese of Skopje appointed a new Bishop, Peter Karagic who wrote to Rome that Toma had left the city and Diocese of Skopje, together with 500 Catholics heading north to serve General Veterani.

Toma later moved to Romania, more specifically in Karansebesch at the military camp from where he thanked the Congregation of Rome for financial support on September 17, 1693, and on 7 July 1694 he wrote from Romania's Hermannstadt (Sibiu) that the Franciscans of Bulgaria were forced to leave their country together with the Catholic believers in Vlach and Transilvania.

Toma, having served in many ways to General Veteran, in 1696 wrote to Vienna to have a permanent financial support of 50 forints per month. In fact, Toma not only had served as a translator for The General but also wrote his official statements, as evidenced by a testimony between General Veterani and Field Marshal Caraffe in 1695 in Hermannstadt (Sibiu), Romania. Not only that, but after General Veteran's death his widow, Maria Victoria Veteran, wanted Toma to be a witness to the things that General Veteran had left behind because the Veteran family fully trusted in Toma, while the main auditor was Norbert Groner. In 1701 we Tom would go on to serve as a parish priest in Hungary, in the city of Buda (Ofen) today the capital of Hungary, which was the center of the Diocese Gran Esztergom.

It is worth noting that Toma, appointed as Vicar, left the Diocese of Skopje from the beginning of the 17th century and stayed in Romania for a while, then in Hungary. Throughout his life, Toma was known by the title Vicar, given to him by the Diocese of Skopje and Bishop Peter Bogdani, not to serve him only for the Diocese of Skopje but also the Diocese of Pult.

He had served as a priest in Budapest, Hungary, from 1701 until his death on May 30, 1718. It should be said that Thomas was not a regular priest, but he remained until the end of his life a Diocesan priest. According to Arnold Schoen, Raspasani was a Diocesan priest, but not a regular. The Diocesan priests, especially in the XVI-XVII century, were priests, highly respected by the aristocracy, and had had not only an excellent theological knowledge but also a broad cultural education. Toma moved to Hungary with his sister Katherine and her son Antonin. Toma had an excellent taste in art, as proven by the elaborate decor of his house with different paintings not only with religious motives, but but nature motives as well. Even in Budapest, in Fovaros Leveltara - Archives of the capital of Budapest- there are documents stating that Toma possessed various paintings, such as: Crucifixion on a black pedestal, St. Barbara, St. Ignatius Loyola, Saint Francis Xaveri, The Motif of Calvary, then motifs like St. Ana, St John Nipomuzzeni, St. George, St. Anthony of Padua, Angels, and also pictures with nature motives.

The Bishop of the Gran Diocese (Esztergom) Leopold Karl von Kollonitsch appointed Toma Raspasani a parish periest in the City of Víziváros, specifically in the suburban part of the city of Buda / Ofen, following the disagreement between the Franciscans (capuchins) and the Jesuits. Foreigners from the Balkans, but also those who spoke German, lived inn that part of the city, and Tom was responsible for them. Tom was not a stranger in the City of Víziváros, Buda / Ofen, because at this time, he had a home and two vineyards in the City of Buda.

Toma Raspasani passed away on May 30, 1718, leaving a testament on May 19, 1718, stating that he leaves his possessing behind for the construction of a church in the city of Ofen / Buda to honor St. Anna. In this will, he also leaves a house and two vineyards to his sister Katarina who was married to Petrus Vlassich (who died in 1710) and three horses and a carriage to his nephew Anton Vlassich. Raspasani had a mill in Hanselbeck (Hamzaabe) but had given it to her sister before testament was written. Toma had a small fortune at that time since after death he had left money to several institutions and various people other than his sister and nephew Antony.

But it is interesting to note that Toma also had kitchen utensils for food preparation, large plates, and lots of spoons and forks. Based on this it is assumed that Raspasani had different and numerous guests at his home.

The house of Toma Raspasan had more culinary utensils than in many guesthouses and motels in the district where he lived and worked. He left the house in Buda / Ofen for the construction of St. Anna church (Sent Anna templom), a church still standing in Batthyány, Budapest, and is one of the most beautiful Baroque style churches in Budapest. Johann Georg Metokovics-Cetto, a wealthy aristocrat from the Balkans, bought one of Toma's houses after his death.

Here we bring a part of his 11th testament, which says: „*Sicut in vivis nil prius habui, aut desideravi, qvam ut honor S. Annae promoveatur, atqve hujus piae Intentionis intuitu pridem Ecclesiam qvandam optavi, ita huic etiam nunc inhaerens meam Donum pro Ecclesia ordino, qvo citius in Sanctum hunc usum convertandum, ne vero media desint, hisce omnia mea totam nimirum substantiam, qvatenus specialiter hic non disposui, prout in vivis feci, ita et modo plenissime offero, et S. Annae, qvam eatenus et modo praescripto Haeredem facio, consecro*."

II.4 DOM ZEF RAMAJ (1882-1914), FAMULLITAR DHE MËSUES NË SHKUP

E gjithë veprimtaria e dom Zef Ramaj është e lidhur me Famullinë e Shkupit.

Dom Zefi u lind më 08.01.1882 në Stubëll të Epërme (Komuna e Vitisë), dhe vdiq më 25.12.1914 në Shku. Prindërit e tij ishin i ati Pali dhe e ëma Çila, të cilët kishin gjashtë djem dhe dy vajza. Stublla i përkiste në këtë kohë Famullisë së Letnicës apo siç quhej Montenegro di Scopia. Zefi duhet të kishte vizituar vitet e para të shkollës në Prizren. Kurse, nëntë vitet tjera mësimet i ndoqi në Shkodër, pesë vjet të shkollës normale dhe katër vjet për filozofi dhe teologji në Kolegjin Ksaverian, deri në vitin 1905. Në vitin 1905 shkoi të studiojë në Innsbruck të Austrisë. Konkretisht, më 26.09.1905, bashkë me katër shqiptarë të tjerë, nën përcjelljen e dom Nikollë Ashtës, arriti në Innsbruck. Shpenzimet e udhëtimit dhe qendrimit i kishte paguar Austria. Studentët, përveç rrobave në trup, nuk kishin gjë tjetër me vete kur arritën në tokën austriake. Vendi prej nga vjen dom Zef Ramaj shënohet „Albaniae".

Dom Zef Ramaj e kishte njohur shumë mirë familjen Bojaxhiu, kurse Gonxhe Bojaxhiun e kishte pagëzuar në Kishën Katolike në Shkup më 27 gusht 1910, një ditë pas lindjes së saj.

Më poshtë janë dokumentet ku ipeshkvi i Shkupit Pashk Trokshi kërkonte që kandidatët e Ipeshkvisë së Shkupit të shkolloheshin në Innsbruck të Austrisë, ndërsa Austrohungaria iu përgjigj pozitivisht asaj kërkese /

Below are the documents where the Bishop of Skopje Pashk Trokshi requested that the applicants from the Skopje Diocese be trained in Innsbruck, Austria, and the government of Austria responded positively to that inquiry.



Nº 210. Uskub, am 7. November 1897.

Albanien Secretariat 22 24 34

53600 pr. 14 XI. 1897

Hochgeborner Graf!

Euer Vice Consul Rapport Zahl 210 vom 7ten November l. J. Ehrerbietigst zu unterfertigen.

Ihre Excellenz Den Hochgeborn Herrn Grafen Agenor von Goluchowski etc. etc. etc. Wien.



Monsignore Vescovi galangen sein voriges an Seine Excellenz Jungfrauen, zwei Jünglinge vom albanesischen Nationalität unterfertigt zu unterfertigen. Ihrer Excellenz Ihr Ehrfurchtsvoller unterfertigen.

Kërkesa e Zef Ramajt dhe Martin Berishaj e vitit 1906, për të studiuar në Innsbruck të Austrisë. Forma e nënshrkuar e Zef Ramaj është Giuseppe Ramovic / Zef Ramaj's and Martin Berishaj's application, to study in Innsbruck, Austria (1906). Zef Ramaj's signature is Giuseppe Ramovic:



ad. N° 26.

Kopie

Eccellenza Illustrissima Reverendissima Monsignore

Siamo certi che l'Eccell. vorrà d'aver ogni tanto nostre notizie, ed anche noi godiamo assai di ricevere e dirle ciò che ci riguarda. Di salute adunque stiamo assai bene, grazie a Dio. Il 2 di Febbrajo il R.P. Rettore fece i voti solenni e quindi ci fu una gran festa. A pranzo: canto, orchestra, discorsi, brindisi e via dicendo. Alla sera: un poco di intrattenimento, si rappresentarono cioè in quadri viventi, varii tratti della vita di S. Ignazio. Romanò fece la parte del P. Faber, quindi si vestì da Gesuita, onde poi, per fare mio ritorno, come ai compagni di Trattori, d'aver preso l'abito della compagnia di Gesù.

Prima di Pasqua dobbiamo dare esame, i quali, con fondamento, possiamo dire che andranno piuttosto male, e così ci troviamo molto imbrogliati, e perciò se vorremo mettere volontari per domandare una novena secondo la quale dobbiamo agire. Abbia adunque la bontà di scrivere. Il Ministro austriaco ha



ha colpa alcuna avendo ricevuti ordini espressi da Vienna di agire così. Noi naturalmente faremo tutto quello che l'Eccell. vorrà e come vorrà. Se Suoi ordini saranno per studiar questa lingua noi volentieri ciò faremo. Se poi saranno contrari, se vuole, non diremo al R.P. Rettore d'aver Suoi ordini... ma francamente, d'esser venuti a studiar la Teologia ed a questa dobbiamo attendere.

La scrivo adunque, la preghiamo di nuovo e ma vorremo che non faremo tutto quello che ci consiglierà di fare. Ora Le chiediamo scusa, Monsignore, per la noja preadeke con questa lettera piuttosto un po lunga. Intanto Le chiediamo la pastorale benedizione e baciando le il Pastorello ci dichiariamo

Di V. Eccell. Ill.e Rev.ma

Umilliss.i ed Ubbid.mi figli in Cristo

Innsbruck (Convitto Teologico) li 15 febbraio 1906.

Ch. Giuseppe Romanò – Martino Berisha

Ndër studentët shqiptarë që kishin studiuar atje janë edhe Martin Berisha nga Peja, Françesk Karma nga Tivari, Shtjefën Kurti nga Prizreni, Marjan Glasnović nga Janjeva, Lazër Shantoja nga Shkodra, etj.

Rektori i seminarit në Innsbruck, P. Michael Hofmann S. J, më datë 25 korrik 1907, njofton se tashmë Berisha, Karma, Ramaj e Gjergji, i kishin përfunduar studimet dhe se ishin kthyer në Prizren ku dhe do shuguroheshin për meshtarë. Një dokument që kemi marrë nga arkivi i konviktit teologjik „Canisianum" të Innsbruck-ut, shënohet se nga aty dom Zef Ramaj kishte shkuar në Prizren më 8 korrik 1907. Më tej, shkruhet për të se ishte „shumë i gjallë, fisnik". Sipas të njëjtit burim, mësojmë se dom Zefi ishte shuguruar për meshtar ne Prizren në muajin korrik 1907.

Konsullata austriake në Prizren, përmes zëvendëskonsullit Prochaska, më 29 korrik 1907, njofton se imzot Trokshi i kishte shuguruar dom Zef Ramaj nga Stublla e dom Martin Berishën nga Peja, dhe informon edhe për caktimin e dom Zef Ramajt „Cooperator" në Famullinë e Shkupit, pra ndihmës i famullitarit të atëhershëm dom Ndue Bytyqi.

Sipas burimeve austriake, dom Zefi fillimisht ishte emëruar "cooperator" (ndihmës famullitar) e më vonë famullitar i Shkupit. Ai ishte edhe mësues në shkollën shqipe pranë Famullisë së Shkupit, sikundër edhe në Shkollën e Hekurudhës (një shkollë elitare për kohën, ku mësonin edhe fëmijët e diplomatëve të huaj). Dom Zef Ramaj jo vetëm që ishte famullitar në Shkup, por edhe mësues në dy shkolla shqipe që funksionin në kuadër të Kishës Katolike. Mësues tjerë ishin Gjin Kajtazi, Nikollë Rrota, Mate Logoreci, Gapsër Beltoja, Gaspër Mikeli, dy motra e njëra prej të cilave ishte Protegjena Bekes (Bekaj) nga Stublla.

Më 1 dhjetor 1913, raportohet për problemet që kishin besimtarët katolikë në Shkup, e sidomos ata që ishin në kryesinë e Këshillit të Kishës. Kështu, Rrok Prenq Berishën, një arpunues, pasi e kishin dënuar me shumë të mëdha në të holla, organet lokale serbe e kishin kërcënuar që ta lëshonte vendin, përndryshe do ta burgosnin. Këtë e bënin nën pretekstin kinse të aktivitetit e të intrigave politike të Rrok Berishës. Do thënë se Rrok Berisha (i një familjeje 14 anëtarëshe), besimtar i Dom Zefit, atëbotë ishte një figurë në zë në Shkup. Po ashtu, ai kishte miqësi dhe bashkëpunim edhe me Aleksandro Kastriotin, pretenduesin e fronit shqiptar të asaj kohe, që jetonte në Paris. Me deportimin e Rrok Berishës dhe të njerëzve në zë, siç njofton konsullata e Austrohungarisë, organet serbe dëshironin dobësimin e elementit katolik shqiptar në Shkup.













Famullitari dom Zef Ramaj e informon konsullatën se Rrok Berisha, me familjen vet 14 anëtarëshe, do të largohet së shpejti nga Shkupi në drejtim të Durrësit.

Më 3 prill 1914, konsullata austrohungareze raporton për vizitën që iu kishte bërë dom Zef Ramaj, në fakt ai po këshillohej me ta për gjendjen e re politike. Konsulli njofton edhe për interesimin e dom Zefit se si duhej të vepronin shqiptarët katolikë për çështjen e shtetësisë e të shërbimit

ushtarak, meqë besimtarët e tij do të ballafaqoheshin me kërkesën e organeve zyrtare për t'u deklaruar nëse përcaktohen për shtetësi turke apo serbe.

Konsulli i shpjegon dom Zefit se me Marrëveshjen e paqes mes Serbisë e Turqisë, të datës 9 mars, nuk ishin të rregulluara çështjet në fjalë për shqiptarët katolikë, por vetëm për myslimanët (të cilët nuk obligohen për të shkuar në shërbimin ushtarak serb). Dom Zef Ramaj njofton se shumica e shqiptarëve katolikë të Shkupit, të gjendur në këto rrethana, po e mendojnë largimin nga vendi i tyre.

Dom Zef Ramaj kishte shërbyer në Shkup prej vitit 1907 deri më 25 dhjetor të vitit 1914, kur vdiq. Kishte jetuar dhe vepruar në Shkup, në një kohë shumë të vështirë, në kohën e Perandorisë Osmane, me të cilën kishte probleme jo vetëm administrative, sidomos më 1910, kur organet lokale dëshironin që në pronën e Kishës Katolike të ndërtonin rrugën.

Pas rënies së Perandorisë Osmane, problemet vazhdojnë me serbët, gjatë luftërave ballkanike, kur gjendja e shqiptarëve, sidomos e atyre katolikë në Shkup, ku kishte shërbyer si meshtar e mësues, ishte tej mëse e rëndë.

Argjipeshkvia e Shkupit kishte fat të madh me emërimin e imzot Mjedës në krye të saj më 1909. Ai ishte një prijës i vërtetë shpirtëror në kohëra mjaft të vështira për popullin e argjipeshkvinë, siç ishin Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike, si dhe Lufta e Parë Botërore. Gëzimin e madh për emërimin e Mjedës në krye të Argjipeshkvisë Shkup-Prizren e tregon edhe një shkrim i dom Zef Ramaj, botuar në "Elçija e Zemres s`Krishtit" më 1910.

Këtu po sjellim faksimilin e shkrimit të dom Zef Ramaj për emërimn e Lazër Mjedës dhe shifet gëzimi i madh i Famullisë së Shkupit për këtë emërim dhe pritjen e tij madhështore që iu kishte bërë.

Luftërat ballkanike më 1912 e 1913, për popullatën shqiptare në Maqedoni dhe Kosovë ishin shumë të rënda. Kjo gjendje e rëndë pasohet me Luftën e Parë Botërore, më 1914. Popullata shqiptare në Kosovë e Maqedoni kishte mbetur më shumë nën mëshirën e shteteve evropiane dhe të personave të caktuar sesa në diçka tjetër.

Heimrot, konsull austriak në Shkup, i përmend ministrit austrohungarez, Leopold Berchtold, më 9 shkurt 1913, një letër të Mjedës dhe shton se informacionet (që përmbante ajo) ishin dhënë nga dom Zef Ramaj. Se Ramaj kishte raportuar vendet evropiane për gjendjen e shqiptarëve, tregon edhe botimi i letrave private të teologëve shqiptarë (të universitetit të Innsbruck-ut) në gazetën austriake "Allgemeiner Tiroler Anzeiger" të datës

28 mars 1913, mandej se vendi prej nga vinin shkrimet ishte Shkupi, ku tashmë dom Zefi ishte me shërbim, ku shkruan ndër të tjera kështu:

"Për momentin nuk kam mundësi që t`ju dërgoj një raport të detajuar. Ju duhet të keni parasysh se gjendemi në gjendje lufte.... nuk mund të paramendoni atë se çka është mëkatuar ndaj bashkatdhetarëve tanë në këtë luftë.... zemra ime është përplot, për atë se çfarë mund t`ju shkruaj më tutje. Më mirë do të vdisja se Shqipërinë ta shihja në këtë gjendje, në të cilën gjendet".

Gazeta "Tiroler Anzeiger" e datës 28 mars 1913 / The newspaper "Tiroler Anzeiger" dated 28 March 1913:



Allgemeiner

Tiroler Anzeiger.

Erscheint täglich.

Nr. 70. Innsbruck, Freitag, den 28. März 1913. VI. Jahrg.

Statthalter Graf Toggenburg.

Feuilleton.

Briefe aus Albanien.

Në artikullin e gazetës “Reichspost”, jepen në detaje masakrat e bëra ndaj popullatës shqiptare (pa dallim feje) në territorin e Kosovës e Maqedonisë, duke filluar prej Shkupit, Kalkandeles (Tetovës), Ferizajt, Prishtinës, Prizrenit, Gjeneral Jankovicit (Hanit të Elezit), Tërstenikut, Pejës, etj. “Reichspost” i jep rëndësi kësaj dosjeje dhe shkuan tre faqe, në numrin e 17 janarit 1913. Në këtë tekst ceket se dosja është autentike dhe nga një personalitet shqiptar dhe se ka dëshmitar për gjithë atë çfarë ka ndodhur në Shkup. E ky, pa dyshim, ishte dom Zefi, famullitar në Shkup / In the article "Reichspost", details are given of the massacres committed against the Albanian population (regardless of religion) in the territory of Kosovo and Macedonia, starting from Skopje, Kalkandela (Tetovo), Ferizaj, Pristina, Prizren, General Jankovic (Hanit Elezit), Trstenik, Peja, etc. The "Reichspost" emphasizes this dossier and writes three pages in the January 17, 1913 issue. This text states that the file is authentic and by an Albanian personality and has a witness for all that happened in Skopje. In addition, this, no doubt, was Dom Zefi, parish priest in Skopje.



Z. 72.
P.
Gegenstand: Frohnleichnamsfeier.

Uesküb, am 11.Juni 1914.

An Seine Exzellenz den Herrn Minister des k.und k. Hauses und des Aeussern

L E O P O L D Grafen B E R C H T O L D !

Die heutige Frohnleichnamsceremonie, welcher ich mit dem Personale dieses Amtes in Uniform assistierte, hat sich in usueller Weise ohne jeden Zwischenfall vollzogen.

Die Feier, welche, da der Stadtpfarrer Don Ramaj, über erzbischöfliche Anordnung nach Ferisovitz berufen worden war, von seinem Cooperator, P. Zadrima S.J. celebriert wurde, war eine sehr würdige und eindrucksvolle. die gesamte katholische Gemeinde war vollzählig erschienen.

Abschriftlich nach Belgrad.

Der k. und k. Generalkonsul und prov. Leiter:



Z.85/P. INDIZIERT 12 AUG 1914 Ueskub, den 16. Juli 1914

Gegenstand: Petrovdan in Ueskub.

Im Ref. I gelangt 18 AUG 1914

An Seine Exzellenz den Herrn Minister des k.und k. Hauses und des Aeussern Leopold Grafen Berchtold!

Die Feier des Geburtstages des Königs Peter in Ueskub war ebensosehr durch masslose serbische Stimmungsmacherei, wie durch völlige Teilnahmslosigkeit der Bulgaren und Mohammedaner charakterisiert. Hieran konnte auch der Umstand nichts aendern, dass einzelne bulgarische Häuser, im fast rührend zu nennender Hilfslosigkeit, gleich drei serbische Fahnen auf einmal ausgesteckt hatten.

Die Gesinnung der Mohammedaner ist während der in der hiesigen Murad Moschee abge-

./.

Durch Kurier



ein offizieller Empfang beim Kreispräfekten, bei welchem mein russischer Kollege einen Trinkspruch auf den König und die Lokalbehörde ausbrachte, und ein Fest in Offizierskasino zu erwähnen. Die Einladung zu letzterem habe ich unter Hinweis auf unsere Trauer abgelehnt.

In der katholischen Pfarrkirche hat der Pfarrer Don Josef Ramaj auf Aufforderung der Lokalbehörde an diesem Tage ein Hochamt zelebriert.

Mitten in der Feststimmung wurde hier der Tod des Gesandten von Hartwig bekannt. Dass die Nachricht, er sei auf der k.und k. Gesandtschaft „vergiftet" worden, in serbischen Kreisen anfangs Verbreitung und Glauben finden konnte, ist für die hiesige, überhitzte Atmosphäre bezeichnend.

Auf dem Gebäude der Kreispräfektur, welches noch wenige Tage zuvor, als das Requiem für Seine k. und k. Hoheit den Herrn Erzherzog Franz Ferdinand abgehalten wurde, sein alltägliches Aussehen bewahrt hatte, wurde nun die schwarze Trauerflagge gehisst.

Gleichlautend nach Belgrad.

Der k.und k. Konsul und provisorische Gerent:

Adam Riewicz

Ngjarjet e paraqitura në libër, autori i kishte marrë prej gazetës së sipërpërmendur, të datës 17.01.1913. Në raportet e 24 janarit 1913, Mjeda tregon se informacionet e dhëna aty për gjendjen e shqiptarëve, i kishte nga dom Zefi e dom Pashk Krasniqi. Më 9 shkurt të vitit 1913, konsulli austrohungarez në Shkup, Heimroth, i shkruan Vjenës zyrtare se imzot Mjeda, raportonte duke u thirrur në informacionet e dom Zefit.

Edhe vetë Heimroth, në një rast shkruan: "Ashtu siç shkruan Mjeda në letrën mbi tmerret (ndaj shqiptarëve, v.j) më kanë ardhur edhe mua në vesh. Famullitari i Shkupit, dom Ramaj më tregoi se ai ishte dëshmitar dhe përmend një ushtar serb me emrin Ciceriç". Konsulli vazhdon tutje duke thënë se këto gjëra i kishte parë edhe murgesha katolike që vepronte në spitalin e Shkupit e që ishte edhe mësuese e subvencionuar nga Austrohungaria. Fjala është për murgeshën dhe mësuesen në shkollën shqipe të Kishës Katolike në Shkup e quajtur Protegjena Bekes nga Stublla, bashkëvendëse e dom Zefit. Ajo kishte parë shumë kufoma të shqiptarëve myslimanë në lumin Vardar. Më vonë, konsulli shkruan se burim informacioni i dom Zefit, ishte edhe Luigi Neraci, që njihej shumë mirë me dom Zefin. Konsulli, në këtë raport përmend jo më pak se shtatë herë emrin e dom Zefit, për grumbullimin e informacioneve mbi masakrat ndaj shqiptarëve.

Edhe zëvendëskonsulli anglez, W.D.Peckham, njofton Londrën zyrtare për tmerret ndaj shqiptarëve. Ai shkruan se raporti është i bazuar në të

From this paper we can understand that Mjeda was welcomed in a magnificent way in Skopje and in Kumanovo by Don Nikolla Mazarreku and Pashk Krasniqi, and almost all of Skopje's believers, counting about 140 houses at that time (according to the speech) awaited for him train station in and then at the church yard in Skopje. Guest came as far as from the consulate of Austria-Hungary, France and Italy, to meet Mjeda. From the railway station, they went to the church in Skopje, accompanied by church bells, as Zefi Zefi says. "After everyone saluted the Archbishop Lazer Mjeda, they all went to the Church, accompanied by church bells, announcing that the catholics had a big celebration…..When he entered the curch yard, our heart filled with joy and happiness '

Consul of Austria-Hungary in Skopje, DR. Heimroth, on August 25, 1910, reports on the many problems Mjeda has with the Turkish authorities. The latter did not allow Mjeda to exercise the office of Archbishopric in Skopje, despite the fact that at least three times he had requested permission for the pastoral activity within the Archbishopric. Mjeda asked the Austro-Hungarian consulate to take the necessary measures to regulate the matter in question, since he was also the protector of the Balkan Christians. So it happened.

In conversation with Cardinal Gotti, a special interest was taken on the issue of Mjeda and his advisers and the problems the Turks .

With officials in Vienna on July 23, 1911, Mons. Mjeda also talked about potential investments in the Archbishopric where it was decided as follows:

- build a new bishop's residence in the amount of up to 20,000 krona (allowed);
- to build a parish church in Skopje (as early as possible, perhaps by 1912, but not sure);
- build a parish church in Prizren (which was not definitive);
- fund the school in Peja and provide income for teachers;
- asks for another teacher for Janjevo (Kromic to go to Shkodra and Mitrovic to come as a teacher at the school in Janjeva);
- He also seeks a teacher for Zym's school, (who would go to Shkodra to the Jesuits);
- He wants a school teacher in Prizren to come to the School in Skopje, since he believes that it was somewhat neglected in recent years;

- Seeks legalization of the order of the Jesuits in Skopje by Turkey, as they were not accepted by the latter;

- Asks for more than 500 krona to be approved for street expenses in its Archbishopric

As it is seen, points 2, 7 and 8 deal directly with the parish of Skopje, where Dom Zef Ramaj served. Certainly this parish was important to Monsignor Mjeden. Support from Austria-Hungary was a great moral impetus for this parish. Protest were organized opposing the transfer of Mjeda from Skadar to the Archbishopric of Skopje. The Austro-Hungarian Consulate announces on June 28, 1909 (No. 35-40) that Catholics of Shkodra had sent a protest letter to the Pope in Rome to withdraw the Decree on the transfer of Mejda to Prizren. It is also clear from this letter that neither Austro-Hungary wanted Mjeda leave Scadar. They think that Italy was involved in this.

Cardinal Francesco Gotti had announced the arrival of Mjeda in Vienna. Cardinal Gotti also cared for Mjeda's health of Mjeda, who was taking part in talks on the concordat between Serbia and the Vatican, with whom Mjeda had been in constant and very good contacts, sending occasional reports on the issue in question. Apart from that, according to the talks between the Vatican and Serbia, Mjeda was set to become Belgrade's first archbishop and lead the bishop's Seminar in Belgrade and become priests in this seminar, but one thing Austria and Hungary have requested from this seminar in Belgrade to teach in Albanian as well, and this to be led by Lazër Mjeda. these demands for Serbian daily politics were not acceptable.

Lazer Mjeda was familiar to the German public as Archbishop of Skopje. The famous book "Illyrisch-albanische Forschungen" with the main authors of the time, such as Shuflay, Jirecek, Ippen, Thallóczy, Béla, Thopia and others, has a paper bout the canon and a paper by Lazër Mjeda.

Mjeda had contributed in a special way for the Declaration of Independence of Albania, and if it were for the help that L. Mjedes gave to Ismail Qemali to arrive in Vlora on 28 November 1912, Ismail Qemali probably would not have reached at all in time. Ismail Qemali was in Vienna before declaring independence and had financial problems traveling back to Albania. He was left in Vienna and could not come to Albania. So Archbishop Lazar Mjeda mobilized his Austro-Hungarian government

friends and allowed Ismail Qemali to go to Durres through a special ship payed by the Austro-Hungarian government.

Mjeda was supposed to attend the ceremony in Vlora for the act of Albania's Declaration of Independence. Austro-Hungarian consulate in Skopje in a telegram sent to Vienna in November 1912 wrote that the Albanian delegates had begged Archbishop L. Mjeda, the Vicar of Skopje Dom Zef Ramaj and the teacher Logorezi to form a delegation to come to Vlora, to talk about the current situation of Albanians and possibly for the "autonomy" of Albania. The memoradum of 12 November 1912 (compiler and the first signatory of this memorandum is dom Nicholas Kaçorri) is also mentioned. It was sent to Emperor Franz Josef I. asking support for the independence of Albania and in this memorandum they demand from the Emperor Franz Josef to protect the entire Albanian territory. For this reason, a delegation from Skopje and Prizren was required to go to Vlora to ask L. Mjeda to assemble the delegation.

Report (Facsimile):

In his farewell letter on the occasion of his departure from Skopje's Archbishopric, in 1921, Mjeda among other things wrote:

"...it wasn't easy for us at the time, to leave our birthplace and the First Headquarters of Albania to come in this place, where our sacred faith was facing difficulties." From this we can see that it wasn't his descision to leave Scadar in 1909, just as it wasn't his will to leave the Archbishopric of Skopje-Prizren. Simply, he was fulfilling his duty, in the best way possible , always for the good of the people and of the Church.

Lazer Mjeda was the one who communicated, through diplomatic channels, with various countries such as The Vatican, Austria-Hungary, Italy, France, Germany, England. His reports are known to testify for the difficult situation of the Albanian people, not only of Catholics but of all Albanians. Gjergj Gashi's has written three volumes "Kosova altar of Arberia" and in the book "Monsignor Lazer Mjeda - Protector and promoter of Albanian Identity", St. Gallen 2011 regarding the life and work of Lazer Mjeda.Also the foreign media of the time wrote about the importance of Mjeda's activity.

Some authors believe that Mjeda left the Archbishopric of Skopje since 1911, but that does not stand at all. Mejda acted in 1921 in the Archbishopric of Skopje. The 1914 Concordat between Vatican and Serbia was not in favor of the Albanians. Mjeda was considered a very dangerous

man by the Yugoslav daily politics because he was defending Albanians, but Archbishop Mjeda faced another problem. He was a citizen of Albania, and because of, with the signing of the Concordat of 1914, the priests were forbidden to be foreign, except for those born in Yugoslavia. The Yugoslav government knew very well that L. Mjeda had strong ties to the Western world and saw him as dangerous.

On February 25, 1915, Mjeda wrote to Belgrade regarding the appointment of a new parish priest of Skopje since it has been more than a year after the death of the parish priest Dom Zef Ramaj. The Kingdom of Serbia wanted to have the final say at the appointment of parishioners. Mjeda vetoes, so without consulting them, appoints Dom Shtjefën Zadrima a new parish priest, without an understanding from Belgrade. Also Mjeda, on a letter from February 29, 1915, we can see that he had a problem with the imprisonment of three priests of his archbishopric and he demanded their release, of which two were to serve in the parish of Nis - the parish was part of Skopje's archiepiscopacy, and one of them wanted to come to serve in Skopje. Mjeda was accused of acting for the return of Albania to the territory of Macedonia and Kosovo.

Lazer Mjeda had received a letter in Italian from Dom Mikel Tarabulluzi dated January 15, 1920, arguing on the reasoning of the regime that these two were acting against the Yugoslav state, and this was only because they requested not to close the schools in Albanian, near the parishes in Kosovo and Skopje. This letter was handed over to the government officials and Dom Tarabulluz was imprisoned (again) on July 24, 1921, where he was sentenced by the court in Gjilan to 8 months in prison.

Mjeda's departure would be a difficult move for the Yugoslav Kingdom. An important step taken by Milivoj Jovanovic, Minister for Religious Affairs, was the order addressed to the local police to take Mjeda secretly under arrest, to decide later how to deal with him. So the local authorities, with Belgrade's instruction, forced Lazër Mjeda to secretly leave the Archbishopy of Skopje and return to Albania. So Mjeda didn't have a choice. In 1921 he left "silently" from the Archbishopric of Skopje. On February 14, he arrives at the Metropolitan Archbishopric of Shkodra, a step taken without his will. So, as the main justification of Serbian structures, was the letter of the late Mikel Tarabulluz, of January 15, 1920, which fell to the hands of political circles, where it was determined that he ought to be tried on the court of law or to leave the Archbishopric. This was the reason, but not the

cause. Assessments of Serbian police and political circles had judged that the Catholic clergy was preparing a kind of revolution against the Serbian armies in Kosovo.

There is a well-known farewell letter to the priests and people of his archbishop that Lazer Mjeda had left on November 27, 1921. With the arrival of Archbishop Lazer Mjeda in Skopje in 1909, he had brought with him his servant from Shkodra, named Leze Suma , born in Shkodra in 1882, and died in Velezha (served in this parish until death), near Prizren, in 1968. She says: "Before Christmas, the Archbishop had received a letter from the government. He looked very upset and asked for as soon as possible to prepare some of his things that were needed because he had to go to Shkodra urgently. He said that he didn't know is he was going to return, but if he did not return, he wanted to have his other things send to Shkodra. On the following day, he left Prizren. He did not return and we sent him all his belongings to Shkodra "; while at night, before leaving, he writes the farewell letter we are presenting here that was published in the magazine Drita: Luka Filić says about Lazër Mjeda:

"After this tempestuous and gloomy time, the wheel of our chief archbishop was received by His Highness, Lazer Mjeda. First, with the benediction, example and words, he began to work for the well-being and warmth of the people. After a while, we could see spiritual advancement of souls. In other words:

1. He made the Jesuits in charge of the Archbishopric;

2. Established two new parishes: Novosella and Becin, and the third in Velez;

3. He sent the pupils to study for priests in Skadar, while the theologians in Innsbruck;

4. In this way, he assured the future of his archbishopric concerning the priests;

5. He built a large building in Skopje opposite the curch;

6. Provided a fund of 1,000,000 (million) dinars for the construction of a small seminar.

As long as he was the archbishop, there was no shortage of priests, because the parishes were filled with parishioners, while there were two and three parishes without priests. Then there was no need for money collections, nor the need for taxes towards the curch. All this lasted even after the departure of His Excellency, Archbishop Lazer Mjeda. He did not

have "very honest clergyman" because he did not need it. In any case the Jesuits were there, and so our archbishop flourished "

Mons. Lazër Mjeda said, "I do not know any other politics, besides doing my job, both as an Albanian and as a bishop. Christ never did politics. He always spoke clearly."

II.6 MEMORANDUM PËR POZITËN E POPULLIT SHQIPTAR NË MBRETERIN E JUGOSLAVISË

(Dom Gjon Bisaku, dom Shtjefën Kurti dhe dom Luigj Gashi)



[55]

[55] Dom Shtjefën Kurti në vitet e 20'a të shekulit XX në Shkup. Kjo fotografi eshtë në pronësi ne familjes Ukajdari./ Don Shtjefën Kurti of the 20's years of the XX century. The picture is part of the personal documentationof the Ukajdari family

1930 GJENDJA E PAKICËS SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI - MEMORANDUM DORËZUAR KËSHILLIT TË KOMBEVE NGA DOM GJON BISAKU, DOM SHTJEFAN KURTI, DOM LUIGJ GASHI[56]

Ky memorandum, i shkruar fillimisht në frëngjisht, iu drejtua Lidhjes së Kombeve në vitin 1930 nga tre priftërinjtë katolikë, Gjon Bisaku, Shtjefën Kurti, Luigj Gashi, i cili kishte punuar në Kosovë në vitin 1920 në emër të Kongregatës së Shenjtë të Propagandës në Romë. Apeli i tyre i dëshpëruar tregon se situata e shqiptarëve në Kosovë nuk ka përmirësuar shumë një gjeneratë pas pushtimit nga Serbia nga viti 1913.

Shkëlqesi :

Ne poshtë të nënshkruarit:

Dom Gjon Bisaku, me prejardhje nga Prizreni, deri tash famullitar në parahidën Bec, rrethi i Gjakovës – Jugosllavi.

Dom Shtjefën Kurti, me prejardhje nga Prizreni, deri tash famullitar në parahidën Novo Sellë, rrethi i Gjakovës – Jugosllavi.

Dom Luigj Gashi, me prejardhje nga Shkupi, deri tash famullitar në parahidën Smaç, rrethi i Prizrenit – Jugosllavi.

Që të tre misionarë të kongregacionit të shenjtë "Propaganda Fide", shtetas jugosllavë me origjinë shqiptare.

Kemi nderin që në emër të banorëve shqiptarë në Jugosllavi t'jua dërgojmë këtë peticion, respektivisht gjendjen e pakicës etnike dhe e lusim Shkëlqesinë Tuaj që të urdhërojë, me të t'i njoftojë anëtarët e Lidhjes së Kombeve.

Shkëlqesisë së Tij,
Zotërisë
Erik Dramondit,
Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve
Gjenevë

Ne, i nderuar Sekretar i Përgjithshëm, nuk jemi emisarët e parë të popullit shqiptar të ngelur në Jugosllavinë Mbretërore që dërgojmë informacion para Lidhjes së Kombeve për gjendjen e mjerueshme të kësaj pakice, të krijuar nën regjimin serb. Ne, gjithashtu, me siguri nuk do të jemi

[56] Ky dokument është marrë nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, Paris, në orgjinal është në gjuhën frenge, siç e kanë dërguar hartuesit dhe i njëjti është përkthyer në gjuhën shqipe për nevojat e inkorporimit në këtë libër që po botojmë.

as të fundit që të kërkojmë para këtij institucioni të lartë të së drejtës ndërkombëtare përgjigje nëse politika e udhëhequr nga Beogradi nuk e ndryshon veprimin e saj ndaj qytetarëve të vet shqiptarë.

Kjo politikë, tashmë tepër e pasur për nga fatkeqësitë dhe zjarrvëniet , përbëhet nga kjo fjali: "Të ndryshohet me çfarëdo lloj çmimi karakteri etnik në krahinat ku banojnë shqiptarët."

Metodat janë si vijon:

a) Përndjekje të çfarëdo lloji qoftë, me qëllim që të na detyrojnë të shpërngulemi;

b) Përdorimi i dhunës për asimilimin e detyrueshëm të popullatës, e cila nuk është në gjendje të mbrohet;

c) Përndjekjen dhe zhdukjen e elementëve që nuk dëshirojnë ta lëshojnë vendin, ose që nuk e pranojnë serbizimin.

Këtyre tri metodave u përgjigjen tri kategoritë e nënshtruara:

Kategoria e parë e flijuar janë 140.000 e më shumë shqiptarë të cilët kanë qenë të detyruar t'i lëshojnë vatrat dhe pronat e tyre dhe të shpërngulen në Turqi, në Shqipëri dhe në vende të tjera fqinje, kudo ku kanë shpresuar të gjejnë strehim, pjesë të bukës, edhe atë në grupe të mëdha njerëzish.

Kategoria e dytë e përfshin masën prej 800.000-1.000.000 shqiptarëve, shumica të besimit islam, e cila jeton kompakte në krahinat në afërsi të kufirit të Shqipërisë Mbretërore, deri te linja e cila në veri dhe perëndim shkon deri te lugina e Moravës dhe vazhdon në perëndim deri në luginën e Vardarit.

Kategoria e fundit përfshin personalitetet shqiptare në Jugosllavi gjithnjë në rritje, të cilët përndiqen për shkak të ndjenjave të tyre nacionale, si dhe ata që përpiqen të ndërpresin shkombëtarizimin, nga të cilët i flijuari i fundit është vëllai ynë për nga Krishti, i nderuari françeskan Atë Shtjefën Gjeçovi, i cili është kapur në pritë nga xhandarët dhe është vrarë më 14 tetor, vitin e kaluar.

Shkëlqesi, për t'iu larguar fatit të këshilltarit tonë ekzekutiv nga lufta e Gjeçovit, ne qemë të detyruar t'i lëshojmë vatrat tona dhe detyrën tonë të shenjtë në mesin e bashkëqytetarëve tanë të pafat dhe të shqetësuar.

Detyra jonë e parë është që ta njoftojmë Lidhjen e Kombeve dhe botën e civilizuar për vuajtjet e vëllezërve tanë, të cilët jetojnë nën shtypjen e Jugosllavisë.

I detyruar nga fati i zi, që të kalojë nga një torturë në tjetrën, kjo pjesë e popullit shqiptar, që për nga numri po aq i rëndësishëm si dhe ai që jeton

në shtetin e pavarur të Shqipërisë, tashmë disa shekuj nuk e ka përjetuar asnjë çast lirinë. E drejta për vetëvendosje të popujve, e aprovuar nga themeluesit e Lindjes së Kombeve, apostull i paqes ndërkombëtare, ngel për ne një ide e shenjtë, që vetvetes ia ka parashtruar si qëllim kryesor mënjanimin e çfarëdo lloj konflikti ndërmjet shteteve, është dashur gjithashtu ta ndërpresë nëpërmjet "Marrëveshjes për pakicat" çfarëdo lloj konflikti të këtyre shteteve dhe banorëve të tyre , të cilët janë të racës, të gjuhës dhe të fesë tjetër.

Dispozitat e kësaj "Marrëveshje", solemnisht të pranuar nga qeveritë në tërësi, në të shumtën e rasteve e kanë pakësuar frikën, posaçërisht u kanë dhënë shpresë banorëve, të cilët kanë qenë të detyruar të jetojnë nën udhëheqjen e huaj. Në mesin e tyre, më e madhja, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të popujve, gjithsesi se është pakica shqiptare në Jugosllavi. Ajo gjendet, për fatin e saj të keq, në një gjendje të mjerueshme, të cilën e ndien më shumë se cilido popull tjetër i nënshtruar, sepse qeveritë janë shumë pak korrekte, të cilat, përkundër asaj se bashkëpunojnë me Lidhjen e Kombeve, në anën tjetër veprojnë që çdo mënyrë t'i shmangen aprovimit të "Marrëveshjes", që atyre u takon, përkundër asaj se vullnetarisht e kanë pranuar.

Ky është pikërisht rasti i dispozitave që u takon pakicave sipas "Marrëveshjes së Sen Zhermenit", e që është nënshkruar nga qeveria serbo-kroate-sllovene më 10 shtator 1919.

Asnjë e drejtë e paraparë në këtë "Marrëveshje" nuk i është dhënë pakicës shqiptare në këtë shtet, duke filluar nga mbrojtja e jetës dhe e pasurisë e deri te lëvizja e lirë, siç del nga faktet e dispozitave të radhitura. Posaçërisht dispozitat të cilat synojnë që t'i sigurojnë pakicat se do të pamundësojnë shkombëtarizimin e tyre kanë ngelur shkronja të vdekura. Duke shpejtuar që t'i sigurojë vetes posedimin e atyre krahinave të shqiptarëve etnikë, qeveria jugosllave fare nuk është e interesuar që t'u japë madje as ato të drejta minimale që Lidhja e Kombeve dëshironte t'i garantonte pakicës sonë, përkundrazi, nuk janë zgjedhur mjete dhe metoda për arritjen e qëllimeve të caktuara paraprakisht.

Shkëlqesi,

Ne vijmë për të kërkuar të drejtat tona që dalin nga "Marrëveshja", të cilat fare nuk respektohen, e jo kundër dominimit jugosllav dhe "Marrëveshjes" së arritur. Të bindur se Lidhja e Kombeve nuk do të durojë shkeljen permanente të "Marrëveshjes", zbatimi i së cilës është nën mbikëqyr-

jen tuaj të lartë, popullata shqiptare në Jugosllavi, myslimanët dhe të krishterët, paraqesin ankesën e tyre, me bindje të thellë që e ka nën mbrojtjen e saj.

Të bindur se Lidhja e Kombeve do t'i marrë parasysh insistimet tona, ne jemi ashtu të lirë që të përcjellim vëmendjen e saj aq të lartë për masat që duhet të ndërmerren që të përmirësohet gjendja, e cila dita-ditës po bëhet e papërballueshme dhe kundër së cilës po proteston pakica e shqiptarëve. Sipas mendimit tonë modest, do të ishte tepër e nevojshme që kohë pas kohe të dërgonin një komision, i cili do ta kontrollonte zbatimin e "Marrëveshjes për pakicat". Por, metoda më efikase , për zbatim të sigurt, do të ishte që nga ana e Lidhjes së Kombeve të dërgohet një komision ose një komisariat i përhershëm, i cili do të vendosej në një qytet të krahinave të pakicës. Kontrollimi i vërtetë do të detyronte respektimin ndaj obligimeve të dhëna, në këtë mënyrë do të ishte vlerë të dyfishtë. Në njërën anë, kontrollimi i saj do t'u jepte fund raporteve dyfytyrëshe të Qeverisë, e cila i refuzon kërkesat e pakicës, ndërsa para Lidhjes së Kombeve paraqet krejtësisht një gjendje tjetër, duke iu shmangur në tërësi realitetit. Si shembull mund të jepet dokumenti i fundit jugosllav për pakicën shqiptare (M.C.370 nga 26 gushti 1929), ku thuhet se në krahinat tona ekzistojnë shkolla. Komiteti që e studion këtë çështje shpreh kënaqësi, duke menduar se ekzistojnë shkolla ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërkaq e vërteta thotë që janë 800.000 shqiptarë që nuk e kanë asnjë shkollë fillore dhe se nuk kanë asnjë funksion të rëndësishëm në administratën shtetërore. Në anën tjetër, fuqia që tashti po zbaton shkombëtarizimin do të binte me prezencën e Komisariatit të përmendur, me këtë edhe dhuna dhe përndjekja e çfarëdo lloji në masë të madhe do të mënjanohej. Me pak fjalë: Lidhja e Kombeve do të imponontе zbatimin më efikas të "Marrëveshjes" dhe rregullimin e marrëdhënieve mes pushtuesve dhe të nënshtruarve.

Ju lusim Juve, që të besoni, Zotëri Sekretar i Përgjithshëm, në besimin dhe paluhatshmërinë tonë në misionin e Lidhjes të Kombeve dhe në respektin e lartë që e kemi ndaj Shkëlqesisë Suaj.

Gjenevë, 5 maj 1930
Të nënshkruar: Dom Jovan Bisaku
Shtjefën Kurti dhe Luigj Gashi

PASQYRA E SHTOJCAVE

Në shtojcat që pasojnë dëshirojmë të paraqesim me fakte të argumentuara insistimin tonë të vërtetë, të cilin patëm nderin ta paraqesim në këtë ankesë. Ngjarjet e lartpërmendura janë vendosur si shembuj të qartë, të marrë prej masave e që kanë ngjarje të ngjashme. Për një qartësi më të madhe, i kemi përmendur dispozitat e "Marrëveshjes për pakicat", nënshkruar nga ana e Mbretërisë Jugosllave, duke i vendosur në të faktet që vërtetojnë që ato dispozita nuk janë zbatuar në favor të pakicës shqiptare.

Këto fakte flasin vetë:

SHTOJCA NUMËR 1

I. MBROJTJA E JETËS

"Shteti SKS obligohet që t'u japë shtetasve të vet mbrojtje të plotë të jetës dhe të lirisë së tyre, pa marrë parasysh lindjen, kombësinë, gjuhën, racën ose fenë."

(Neni 2 i "Marrëveshjes për pakicat")

I.- FILLIMI I PUSHTIMIT SERB

Në drejtimin e ruajtjes së jetës dhe të lirisë së qytetarëve shqiptarë, të cilët jetojnë brenda kufijve të Mbretërisë Jugosllave, mund të shkruhen shumë libra, nëse do të dëshironim t'i numëronim të gjitha ngjarjet ku ajo mbrojtje qëllimisht nuk ka ekzistuar.

Vuajtja e kombit tonë fillon me vendosjen e trupave "çliruese " në vitin 1912 në krahinat e banuara me shumicë shqiptare. Ja pasojat e marrjes së këtyre krahinave dhe deri te përfundimi tragjik që ka bërë Komisioni anketues, i formuar nga Instituti Karnegi (Carnegie Institute) :

"Djegia e shtëpive dhe e fshatrave, vrasje në masë e banorëve të pafajshëm dhe të paarmatosur, dhuna e paparë, grabitjet dhe maltretimet e llojllojshme janë mjetet me të cilat janë shërbyer trupat serbo-malazeze dhe akoma shërbehen me qëllim të ndryshimit të pasqyrës etnike në krahinat e banuara kryesisht me shqiptarë."

Por, ne këtu nuk kemi për qëllim të paraqesim historikun e ngjarjeve që kanë ndodhur para nënshkrimit të "Marrëveshjes për pakicat". Ata që dëshirojnë të njihen me ato ndodhi, duhet të gjejnë gazetat dhe literaturën e posaçme ku do t'i gjejnë emrat, vendin dhe datën e një pjese që kanë vdekur nga tortura dhe dhuna.

II. DHUNA NË MASË

Ka ndodhur pas nënshkrimit të "Marrëveshjes për mbrojtjen e pakicave".

1. Vendbanime të shkatërruara: Prishtina, Mitrovica, Juniku, Shtimja dhe Vrella. Vende që të përkujtojnë dhunën, vrasjet masive ndaj banorëve të pafajshëm, faji i vetëm i të cilëve ka qenë vetëm se janë shqiptarë.

2. Masakra në Dumnicë: në Dumnicë, rrethi i Vushtrrisë, më 10 shkurt 1924, me urdhër të prefektit Llukiç dhe majorit Peroviç, fshati ka qenë i rrethuar dhe i djegur, me qëllim që të gjithë banorët të digjen për së gjalli. Faji i tyre ka qenë ky: xhandarët kanë dashur të kapin kaçakun Mehmet Konjuhin, por pa sukses. Pasi kaçaku ka ikur, pushtetarët fajësojnë jo vetëm farefisin e Mehmet Konjuhit , të cilët që të gjithë kanë qenë të masakruar, por edhe tërë fshatin. Në këtë flakë kanë vdekur 25 anëtarë, në mesin e tyre 10 gra, 8 fëmijë nën moshën 8 vjeç dhe 6 persona mbi 50 vjeç. Askush nuk është dënuar për këtë tmerr.

3. Një fshat është zhdukur për gjoja një krim, për të cilin fshati nuk ka qenë fajtor. Në rrethin e Rugovës, disa hajdutë e vrasin një xhandar. Koloneli Radovan Radovanoviç qe dërguar në vendngjarje për të hetuar ndodhinë. Duke mos gjetur fajtorë, koloneli e bastis fshatin dhe e djeg. Ne nuk dimë se sa persona kanë vdekur atje.

Në këtë pjesë të rezymesë lidhur me dhunën serbe në Kosovë ndaj shqiptarëve shënojmë se janë: 12.371 të vrarë, 22.110 të burgosur, 6.050 shtëpi të shkatërruara, 10.525 familje të grabitura.

III. KRIMI DHE MASAKRAT E ORGANEVE TË PUSHTETIT

Numri i krimit, i kryer herë pas here nga ata që janë vendosur ta mbrojnë dhe sigurojnë jetën e njeriut, është shumë më i madh se sa vdekjet që kanë ardhur si pasojë e vrasjeve në masë.

Që të mund të kemi një pasqyrë për këtë shifër, poshtë e japim një pasqyrë brenda gjashtë muajve të nënprefekturës Rekë, rrethi i Dibrës:

Emri dhe vendbanimi *I vdekuri Fajtori*	Emri dhe grada	Data e krimit	Metoda
1.Islam Zhuzhanji nga Zhuzhanji	Kapter Çedomiri xhand. në stacionin Tajmisht	nëntor 1928	I vrari ka qenë i thirrur nën pretekstin që të kryejë ndonjë punë dhe vritet në rrugë.
2.Mexhid Beqiri nga Bogda	Kapter Markoviç nga stacioni Jerdoviç	nëntor 1928	
3.Vili Boga nga Bogda	Xhandar. Nëntoger Rada Tërziç	nëntor 1928	Vritet me pretekst se është frikacak
4.Ismail dhe Qazim që të dy nga Orgunji për në Gostivar	Popoviç dhe Markoviç nga stac. Terniç	10-XII-1928	Vritet në rrugë
5.Musli Bajrami kryetar Komuna Sellcë	Kapter Markoviç stac. i Tërniçit	qershor 1929	Vritet para shtëpisë së vet
6.Jakup Ibrahimi nga Nivishtja	xh. Niko Millovanoviç dhe 1 postier nga stac. i xh. Tanushë	5-VII-1929	Duke u kthyer nga tregu i Gostivarit
7.Zeqir Ismaili nga Preshevci	Reshat Kopriviç xh. i stac. në Rekë	15-VII-1929	ish-kryetar i Komunës
8.Zyrap Fazliu nga Niçipuri	Rreshter Llazoviçi stac. i xh. Niçipur	15-VII-1929	vritet para shtëpisë së vet
9.Ranit Miftari nga Greka	një agjent i nënprefekturës	18-VII-1929	vritet para kishës Beki, pasi lirohet nga burgu

IV. VRASJA E FAMULLITARIT SHTJEFËN GJEÇOVI

Famullitari Atë Shtjefën Gjeçovi është vrarë më 14 tetor 1929 në rrethana që nuk lënë asnjë dyshim, respektivisht shkas për krimin e bërë ndaj tij.

Atë Gjeçovi fatkeqësisht nuk është i pari famullitar i cili ka rënë viktimë për shkak të ndjenjave nacionale dhe fetare. I pari ka qenë Pjetër Ludvig Paliçi, i cili energjikisht refuzon që fenë e tij katolike ta shndërrojë në atë ortodokse, për çka ushtarët e thërrasin dhe duke i pranuar urdhrat e një hajduti, që kishte kaluar në fenë ortodokse dhe i njëjti ishte shpallur prift, e mbysin me shkopinj dhe bajonetë. Rasti ka ndodhur me 7 mars të vitit 1913 në Gjakovë. Atë Gjeçovi gjithashtu është vrarë për shkak të ndjenjave të tij si një i krishterë i mirë dhe si njeri entuziast për drejtësi dhe dituri.

I lindur në vitin 1874 në Janjevë, rrethina e Prishtinës, e cila tash i takon Jugosllavisë, Atë Gjeçov Kryeziu ka kërkuar shtetësinë shqiptare për-kundër të gjitha rreziqeve dhe pikërisht për këto arsye ai ishte i përndjekur gjatë kohës që jetonte në territorin jugosllav. Duke mbaruar shkencat filozofike dhe teologjike, një kohë të gjatë ka kryer misionin e vet në Shqipëri, ku ishte i nderuar nga të gjithë që do ta njihnin. I lidhur me studimet etnografike, ai i pari boton veprën shumë të rëndësishme rreth traditave të drejtësisë shqiptare *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Për këtë vepër ai mori shumë mirënjohje, si dhe titullin doktor nderi në Universitetin e Lajpcigut.

Si adhurues i madh i traditave kulturore të kombit të vet, ai i pari e filloi studimin e folklorit shqiptar. Për këtë qëllim ai udhëtoi në të gjitha krahinat shqiptare dhe më vonë e pranoi detyrën që të vazhdojë me veprimtarinë hyjnore në fshatin Zym, në mesin e shqiptarëve në Jugosllavi.

Zymi, rrethina e Prizrenit-Jugosllavi, është fshat shqiptar prej 120 shtëpish, në mesin e të cilave njëqind shtëpi janë katolike, ndërsa 20 myslimane. Për shkak të kombësisë, Qeveria hapi shkollën e parë në vitin 1926, por nuk duhet të mendohet se ajo u lejoi banorëve që mësimin ta zhvillojnë në gjuhën amtare – shqipe. Përkundrazi, ajo emëroi një mësues serb, i cili madje ua ofendonte nxënësve fenë, sepse ai ishte ortodoks. Atë Gjeçovi, me iniciativën e tij vullnetare, u ligjëronte nxënësve katekizëm në gjuhën shqipe dhe për këtë arsye nuk ishte në marrëdhënie të mira me mësuesin serb, i cili e sulmonte si "patriot shqiptar".

Në anën tjetër, për shkak se e studionte folklorin, shovinistët serbë te kjo e shikonin propagandën politike dhe kjo mjaftoi që ta likuidojnë.

Atë Gjeçovi në disa raste e ndiente armiqësinë e qeverisë jugosllave, si dhe mbështetësit e shoqërisë shoviniste "Mbrojtja Popullore", e cila plotësisht e lirë dhe në tërë Jugosllavinë kryen terror mbi popullin shqiptar. Por, nuk ka mundur ta parashohë se do t'ia marrin jetën vetëm për shkak të ndjenjave të tij. Duke e parë që nuk do të arrijë aq shpejt shansi i favorshëm, kriminelët vendosën të përdorin këtë metodë të sigurt për ta vrarë:

Me 13 tetor, vitin e kaluar, lajmërohen tek Atë Shtjefën dy xhandarë, të cilët me siguri punonin në stacionin që gjendet në afërsi të fshatit Zym, për ta njoftuar se e kërkon nënprefekti nga Prizreni dhe se duhet patjetër t'i lajmërohet sa më parë. I habitur nga kjo urdhëresë, Atë Gjeçovi filloi të dyshojë dhe nuk dëshiroi të nisej i vetëm.

E shoqëruan shërbëtori i shkollës dhe një roje e komunës. Pasi arrin në Prizren, shkon deri tek ipeshkëvi, që ta lajmërojë se e ka kërkuar nënprefekti. Nënprefekti paraqitet si i habitur dhe thekson që nuk ka dhënë urdhër që ai të lajmërohet. Dyshimi, që fillimisht ai e pati, filloi tash të bëhet realitet. Ai përsëri shkon tek ipeshkëvi që ta njoftojë për përfundimin e vizitës te nënprefekti dhe vazhdon rrugën për në shtëpi, i përcjellë nga dy shoqëruesit e tij. Kur arrin jo shumë larg fshatit, dy persona të armatosur i dalin në pritë dhe pasi e ofendojnë Atë Gjeçovin, shtijnë ndaj tij, ai bie që në gjuajtjen e parë, mirëpo kriminelët për të qenë të sigurt, nga afërsia gjuajnë breshëri mbi trupin e tij të vdekur.

Duhet të rikujtojmë se në rrugë, afër vendit ku ndodhi krimi, kanë qenë shumë punëtorë që meremetonin rrugën; gjithashtu, kanë qenë dy shoqëruesit e të ndjerit; jo shumë larg po ashtu gjendet stacioni i xhandarmërisë. Përkundër të gjitha këtyre dëshmitarëve, vrasësit krimin e tyre e kryejnë shumë lirë dhe largohen pa kurrfarë pengesash, si njerëz që kanë kryer detyrën e tyre, duke mos u frikësuar në një asnjë çast për pasojat. Kishin pasur të drejtë që nuk janë brengosur. Hetimet nuk dhanë kurrfarë rezultatesh dhe asnjëherë nuk do të japin, sepse si duket nuk udhëhiqen në mënyrë të drejtë. Përkundrazi, tentojnë ta shfrytëzojnë këtë rast që duke e përkujtuar të flijuarin, në anën tjetër, të përforcohet përndjekja e elementëve shqiptarë. Në kundërshtim të realitetit, tentohet të ndryshohet karakteri politik i krimit, mirëpo publikisht është vërtetuar se përse erdhi deri te krimi, pasi në rrethet udhëheqëse serbe u pranua me kënaqësi kjo

vrasje. Njëri nga këta zotërinj oficer, kur ne të nënshkruarit e këtij peticioni shprehëm keqardhje për këtë humbje të madhe, na u kërcënua që Atë Gjeçovi mori atë që e meritonte dhe se fatin e njëjtë e presin edhe mbështetësit e tij.

SHTOJCA NR. 2

MBROJTJA E LIRISË

(Ka ndodhur pas nënshkrimit të "Marrëveshjes për mbrojtjen e pakicave", Neni 2 dhe 3)

I.-RASTI ME TË NËNSHKRUARIT E KËTIJ MEMORANDUMI

(Klerikët Gjon Bisaku, Shtjefën Kurti dhe Luigj Gashi)

1. Ne kemi qenë të detyruar ta lëshojmë vendin tonë për shkak të kufizimeve gjithnjë në rritje të lirisë së të folurit, të lëvizjeve, ardhjes në ndihmë të vobektëve etj. Çdo lëvizje dhe punë nga ana jonë, për qeveritarët ishte e dyshimtë, nga arsyeja e thjeshtë që nuk kemi dëshiruar të bëhemi "patriotë" serbë dhe t'u shërbejmë qëllimeve të shoqërisë terroriste **"**Mbrojtja Popullore" dhe t'ua imponojmë bashkëkombësve tanë shovinizmin absolut serb, të cilët dëshirojnë të njihemi si serbë të shqiptarizuar dhe për këtë arsye, nuk duhet t'i lutemi Zotit në gjuhën shqipe, as t'i mësojmë fëmijët në gjuhën amtare.

Padëgjueshmëria jonë është konsideruar si një shkelje kundër interesit shtetëror, prandaj nuk është mundur të harrohet e as të falet. Në pamundësi që t'i përballojmë fyerjet dhe kërcënimet, ne në dhjetorin e kaluar i lëshuam parahidat dhe shkuam në Beograd që atje të kërkojmë nga pushteti qendror ndihmë dhe mbrojtje. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme na qetësuan, duke mos i dhënë kurrfarë rëndësie ankesës sonë.

Por, si duket, ankesa jonë në vend se të ndikojë në zbutjen e presionit, edhe më tepër e rriti urrejtjen e pushtetarëve. Kështu, sa kemi mbërritur në Shkup, kuptuam se policia na kërkonte për të na burgosur. Këtë e morëm vesh nga një oficer i xhandarmërisë, i cili u shpreh: "Në Jugosllavi nuk ka vend për shqiptarët; afera e Gjeçovit është vetëm fillimi, kështu që do t'u vijë radha edhe juve." Pas kësaj vendosëm që ta lëshojmë përgjithmonë vendin, që ta ruajmë jetën dhe nderin tonë. Meqë nuk kemi mundur as të mendojmë për t'i marrë pasaportat për Romë dhe t'i paraqitemi kongregacionit të shenjtë "Propaganda Fide", nën udhëheqjen e së cilës jemi si

komisionarë, u detyruam të kalojmë në drejtim të kufirit shqiptar, duke shkuar drejt çdo rreziku, me shpresë se atje do të kemi mbrojtje për jetën tonë, në zëvendësim për krejt atë që qemë të detyruar ta braktisnim: atdheun, farefisin dhe pasurinë.

2 . –Letër dërguar para shkuarjes sonë Shkëlqesisë së Tij, Apostol Nunci në Beograd

Shumë i shenjti dhe shumë i respektuari Shkëlqesi,

Me keqardhje të madhe lamë farefisin dhe shokët tanë, posaçërisht popullin tonë të varfër, i cili, megjithatë, duke parë se ne bashkërisht me të i ndajmë hallet e tyre, kishte një shpresë të vogël.

Shkurtimisht e njoftojmë Shkëlqesinë Tuaj me arsyet për gjithë këtë ngjarje. Tashmë disa vite gjendja dhe qëndrimi ynë në rrethin e Gjakovës është i panevojshëm dhe i pamundshëm. Nga viti në vit ai bëhet edhe më i rëndë, kështu që më ka arritur kulmin. Letra kërcënuese, kontrollime personale dhe të parahidave tona, është bërë gjithçka me qëllim që të fajësohemi para ligjit dhe tërë kjo na lodhi. Masat arritën kulmin më 14 tetor 1929, me vrasjen e Atit Shtjefën Gjeçovi. Përse? Kush e vrau? Ne e lëmë në gjykimin e të tjerëve, sepse Shkëlqesia Juaj ka të dhëna të sakta. Më së shumti qarkullojnë zërat, madje shkojnë deri atje sa oficerët flasin: "Ky është vetëm fillimi!?" Si për shembull, kapiteni i xhandarmërisë nga Prizreni. Komandanti i xhandarmërisë në Pejë, Popoviç duke u qeshur i thotë njërit prej nesh: "Tash është radha për ty." Një oficer tjetër, Zharko Angjellkoviç, ka theksuar: "E vramë atë Gjeçovin, tashti do ta vrasim atin nga Peja." Serbët, miqtë tanë, na kanë thënë që të ruhemi. Përse, çka kemi bërë ne? Kërkojnë prej nesh që të përgjigjemi, madje, edhe për fjalimet tona në kishë etj. Njërit prej nesh i kanë thënë se është anëtar i "Komitetit të Kosovës" në Shkodër, tjetri akuzohet se e ka ndërtuar kishën me mjete të huaja etj. Në pika të shkurtra, ne jemi të padëshiruar dhe "me një vështrim të keq", të padashur nga ana e Qeverisë; neve vetë na ka treguar arkipeshkëvi në tubimin e së mërkurës në mbrëmjen e dy qendrave kishtare, Pejës dhe Gjakovës, kur gjatë bisedës me Atin Lubomir Galiçin pranoi se kjo është e vërtetë, mirëpo vështirë është të gjejmë klerikë për këto parahida.

Në këto rrethana çka të bëjmë? Të qëndrojmë që neve të na vrasin, jo për arsye të fesë, por për shkak të akuzave të pamoralshme, siç është rasti me të ndjerin Gjeçovin, e kjo na duket neve jofrytdhënës, aq më tepër që neve aspak nuk na duket si akt i heroizmit. Si mbetëm, si qëndruam, parahidat tona ngelin pa klerikë. Ne e kemi njoftuar zotëri Biskupin disa herë për krejt këtë. Ne jemi të detyruar që ta shpëtojmë jetën tonë, që t'i lëmë dioqezat tona, parahidat tona dhe popullin tonë shumë të dashur, dhe të mos flasim edhe për atë pasuri të vogël që posedojmë, për ta shpëtuar jetën tonë.

Pra, ne e lusim Shkëlqesinë Tuaj shumë të Shenjtë dhe shumë të Nderuar, që të merremi vesh me kongregacionin e shenjtë "Propaganda Fide", nxënës të së cilës jemi ne, që të na gjejnë ndonjë detyrë tjetër ku do të mundemi të vazhdojmë në thirrjen e klerikëve të shenjtë dhe të na dërgoni neve tek i njëjti Kongregacion i Shenjtë, ku do t'i dorëzonim ankesat dhe nevojat tona, së cilës do t'i betohemi për gjithçka, edhe atë sa më parë, sepse jemi në çdo moment të rrezikuar dhe nga frika se jemi të përndjekur për t'u burgosur.

Me shpresë që Shkëlqesia Juaj do t'i marrë parasysh të gjitha këto dhe se do të na ndihmojë, i ngelemi Shkëlqesisë Suaj djem të përbetuar:

Don Gjon Bisaku, Don Luigj Gashi, Don Shtjefën Kurti.

Beograd, 14-XII-1929.

II. SHPËRNGULJA E DETYRUESHME

1.Shpërngulja për shkak të përndjekjeve

Para okupimit serb, shpërngulja ishte krejtësisht e panjohur për kombin shqiptar, i cili ka jetuar në krahinat që tash janë nën regjimin jugosllav. Është e vërtetë se punëtorët përkohësisht janë shpërngulur në vendet fqinjë, por asnjëherë me familjet e tyre. Arsyet për shpërngulje masive, e cila vërehet që nga viti 1912, pa mëdyshje është përndjekja e çdo shprese, që e ka pamundësuar jetën e një mase të madhe, duke e detyruar që t'i lëshojë vatrat e veta.

2.-Mjetet e përdorura për shpërngulje

Mjetet e përdorura nga pushtetarët jugosllavë, që t'i detyrojë shqiptarët ta lëshojnë tokën e tyre, janë të shumta. Kërcënimi me jetë, kufizimi i lirisë

në të gjitha fushat e aktiviteteve njerëzore, ekspropriimi pa dëmshpërblim, shkatërrimi i vatrave shtëpiake, kontrolli dhe burgosja e shpeshtë pa arsye të mjaftueshme, ndalimi i mësimit në gjuhën amtare, ose shprehja e ndjenjave të tjera nacionale përveç atyre që u pëlqejnë patriotëve serbë - këto janë mjetet të cilat përdoren për çdo ditë.

Shumica e këtyre mjeteve të përdhunshme janë kryer me ndihmën e shoqërive shoviniste siç është "Mbrojtja Populllore".

3.-Shpërngulja në Shqipëri

Në Shqipëri ka tashmë rreth 10.000 emigrantë të pafat, në gjendje të mjerueshme, që i hasni kudo. Qeveria e Shqipërisë ka bërë përpjekje të paparë për vendosjen e këtyre refugjatëve, por është më se e qartë se vetëm vullneti i mirë i saj nuk do të mjaftojë që të pranojë dhe furnizojë nevojat e të gjithë atyre që kanë dëshiruar të vijnë. Ajo ka qenë e detyruar që t'i refuzojë vizat për hyrje të shumë prej tyre dhe atëherë ata kanë kërkuar strehim tjetër, kryesisht në Turqi.

4.-Shpërngulja në Turqi

Numri i refugjatëve në Turqi ka arritur mbi 130.000 veta. Qeveria turke ka ditur të shfrytëzojë fatkeqësinë e këtyre njerëzve që t'i popullojë vendet pak a shumë shkretëtira të Anadollit, me klimë të vështirë. Kjo shpërngulje e parë si duket nuk do të ndërpritet derisa nuk ndalet përndjekja që e ka iniciuar. Kështu, kohë më parë në Turqi kanë shkuar 200 familje shqiptare. Ka edhe diçka. Nga dëshira që të lirohet prej elementëve shqiptarë, qeveria në Beograd ka filluar bisedimet me qeverinë në Ankara për dërgimin në Turqi të 300.000-400.000 shqiptarëve-myslimanë nga Kosova. Nëse ky plan nuk është kryer më, kjo është e sigurt dhe vetëm mbahet fshehtë nga Lidhja e Kombeve dhe opinionin botëror, të cilët nuk do ta lëshonin shansin që ta paraqitnin fjalën e tyre.

5.-Grabitja e të shpërngulurve

Që ta ndihmojnë shpërnguljen për Turqi, pushtetarët jugosllavë bëjnë edhe privilegje, si për shembull kjo: një i ri me prejardhje shqiptare, i cili e ka kryer shërbimin ushtarak, është liruar para afatit që të mund të shkojë me prindërit e tij që janë detyruar të shpërngulen.

Por, shpërnguljen në Shqipëri nuk e shohin me sy të mirë. Qeveria jugosllave e sheh interesin, që këto deportimi dhe grabitje të shkojnë sa më larg kufirit të saj. Për këtë arsye, u bëjnë mijëra pengesa atyre që dëshirojnë të shkojnë te farefisi i tyre në Shqipëri.

Dhoma e avokateve dhe e nëpunësve janë bashkuar që t'i grabisin ata qytetarë të mjerë dhe të pafat: për marrjen e pasaportave ata maltretohen aq shumë, derisa detyrohen të paguajnë shuma marramendëse prej 4.000 deri 5.000 dinarë, që në të shumtën e rasteve përbën krejt pasurinë e tyre. Ja, të flijuarit e fundit të këtij eksploatimi jonjerëzor, që na është dorëzuar neve para se të kalojmë:

a) Një fshatar shqiptar, mysliman nga fshati Leshan, rrethina e Pejës, ka qenë i detyruar t'i paguajë 6.000 dinarë si taksë për pasaportë avokatit serb Zoniç Peja.

b) Avokati serb Luba Vusanoviç nga Peja i ka kërkuar 8.000 dinarë një fshatari tjetër shqiptar për marrjen e pasaportës, sepse puna për nxjerrjen e saj qenka shumë e rëndë.

c) Gegë Meta, shqiptar, katolik nga Shkupi, i shpërngulur në Shqipëri, ka marrë pasaportën për gruan dhe djalin tek pas 5 muajsh maltretimi dhe 2.000 dinarëve që ka dhënë.

Shtojmë se taksa e paraparë për pasaportë nuk është më shumë se 50 dinarë.

ç) Detyrimi i shqiptarëve për shpërngulje bëhet me qëllim që të vendosin në vend të tyre boshnjakë dhe malazez. Në fshatrat e shqiptarëve të shpërngulur ose në pronën e tyre të konfiskuar dhe të eksproprijuar, vendosen malazez dhe boshnjakë nga Sremi dhe Banati për popullim, me qëllim të qartë-që të ndryshohet pamja etnike në këto krahina. Shkëmbim i ngjashëm njerëzor është kryer pak a shumë gjithkund dhe akti vazhdon me energji të shtuar. Si shembull po i paraqesim këto vende:

a) Në rrethinën e Gjakovës: fshatrat Lugbunari, Piskota, Dubrava, Ershit i Vogël, Dashinoc, Fogël i Vogël, Fusha e Turbës, Betesheti, Marilumeti, Neçi etj.

b) Në rrethinën e Pejës: Fusha e Isniqit, Turjaka, Krusheci, Malet e Deçanit, Krusheva, Vitomirica etj.

c) Rrethina e Prizrenit: Graniça, Xherxhe, Llapova etj.

U ka ndodhur banorëve shqiptarë, të cilët përkohësisht i kanë lëshuar shtëpitë e tyre, kur janë kthyer të gjejnë serbë të vendosur në shtëpitë e tyre nga pushteti.

III.-KUFIZIME TË NDRYSHME TË LIRISË PERSONALE

1.-Burgosje, kontrollime, kidnapime

Fillimisht duhet të përkujtojmë se arrestimet dhe burgosjet, në prag të shtëpisë, janë mjetet e përhershme që i përdor administrata e pushtetit kundër popullatës shqiptare. Secila akuzë e formuluar kundër shqiptarit menjëherë sjell masat e kufizimit të lirisë, duke mos marrë parasysh besueshmërinë e akuzës dhe rëndësinë e burimit. Shumica e aktakuzave vijnë nga ngatërresat personale. Shpesh vijnë nga agjentët provokatorë, ndërsa në disa raste janë të paramenduara nga pushtetarët. Kryesisht, mjafton një arsye e vogël që të dyshohet, e cila e ngarkon banorin shqiptar të paraqesë para syve të pushtetit ndonjë akt të kryer dhe të marrin masa të rrepta kundër personave të pafajshëm. Rastet janë të panumërta, ndodhin thuajse për çdo ditë. Ne po kufizohemi në disa shembuj më të afërt:

a) Hafet Halili dhe Shukri Dogani, deri tash kryetarë të rrethit të Kaçanikut, qarku i Shkupit, pasi që nuk kanë qenë në marrëdhënie të mira me pushtetin, u akuzuan se mbajnë lidhje me "Komitetin e Kosovës", i cili ekziston vetëm në kryet dhe mendjen e lodhur të shovinistëve serbë. Nën akuzën e tillë, të lartpërmendurit qenë burgosur.

b) Tregtari Mulla Rifati, i lindur në krahinën e njëjtë, u burgos për arsye të ngjashme.

c) Sherif Gjinovci, personalitet shumë i njohur në mesin e shqiptarëve, para gjashtë muajsh u burgos, sepse është përzier në aferën e pajtimit të dy familjeve shqiptare të hasmëruara.

2.-Veshja

Në aksionin e saj të fuqishëm sa i përket unitetit etnik të shtetit, qeveria në Beograd nuk e kundërshton ndryshimin e veshjes, sepse kjo sjell diferencimin etnik në mesin e banorëve që jetojnë në ato krahina të mbretërisë. Në disa vende, si në Rekë, ku bashkërisht jetojnë shqiptarë të besimit ortodoks me sllavë të të njëjtit besim dhe shqiptarë mysliman, kjo diferencë qëndron në mbajtjen e kësulave të formave të ndryshme. Shqiptarët mbajnë "qeçe" (qeleshe), serbët "kasketë". Që të mënjanojmë këtë diferencë të tejdukshme, zotëri Sokolloviç, nënprefekti, u ka lëshuar urdhëresë në muajin maj vitin kaluar të gjitha stacioneve të xhandarmërisë që t'ua ndalojnë fshatarëve shqiptarë të mbajnë qeçe. Të gjithë janë të detyruar të mbajnë kësulë serbe. Xhandarët me padurim e kanë që kësulën shqiptare ta kthejnë në atë serbe.

3.- Liria e lëvizjes

Një metodë tjetër e përndjekjes paraqet përkufizimi i lirisë së lëvizjes. Në shumë vende shqiptarët nuk guxojnë t'i lëshojnë fshatrat e tyre pa lejen paraprake të pushtetit. Të vizitojnë farefisin në fshatrat fqinjë, të shkojnë të shesin prodhimet e tyre, të shkojnë në treg dhe të blejnë çka u nevojitet - për gjithçka që përmban lëvizje, duhet të njoftohet shefi i stacionit të xhandarmerisë. Këso lloj masash posaçërisht kanë marrë formë të ashpërsuar vitin e kaluar në qarkun e Dibrës. Kuptohet se pushteti nuk do të jetë aq xhentëlmen dhe të kënaqë menjëherë fshatarin nëse ai paralelisht me kërkesën, nuk i jep ndonjë dhuratë.

4.- Kulaku

Për ndërtimin dhe meremetimin e rrugëve shtetërore dhe komunale, si edhe për të gjitha punët e rënda, shfrytëzohen fshatarët e atyre krahinave, serbë dhe shqiptarë, mirëpo sa i përket veprimit, bëhet diferencimi; përderisa serbët rregullisht paguhen si mëditorë, shqiptarët rregullisht nuk marrin asgjë, ose thuajse asgjë. Aq më tepër, ata janë të detyruar të sjellin me vete mjetet e punës, kafshët për ngarkim etj., pa kurrfarë dëm-shpërblimi.

SHTOJCA NR. 3

E DREJTA E PRONËS

Ata (persona që kanë kërkuar shtetësi tjetër) kanë të drejtë të ruajnë atë që e posedojnë në territorin e SKS dhe mund ta marrin tërë pasurinë e tyre të tundshme.

("Marrëveshja për pakicat", Neni 3)

Është e vërtetë se ky nen më shumë vlen për ata që kanë kërkuar shtetësinë austriake, hungareze dhe bullgare, mirëpo duke pasur parasysh karakterin e përgjithshëm të "Marrëveshjes", e cila përfshin mbrojtjen e të gjitha pakicave, mund të konkludohet se dispozitat, respektivisht e drejta e pronësisë, që kjo në shumicën e shteteve faktikisht ekziston në legjislacionet e përgjithshme, duhet të zbatohet po ashtu edhe te shqiptarët, të cilët janë bërë banorë të shtetit shqiptar, ose të çdo tjetri, ose kanë ngelur banorë të Jugosllavisë.

1. Metoda e marrjes së pronës

Në fakt, ndaj shqiptarëve zbatohen masa të tjera. Ekspropriimi më i thjeshtë, pa shpërblimin paraprak, është një ndër mjetet më të përdorura dhe e cila është më efikasja që i detyron shqiptarët të shpërngulen. Konfiskimi i pasurisë gjithashtu praktikohet në masa të mëdha kundër popullatës sonë. Së fundmi vjen reforma agrare, një masë e pushtetit e cila asnjëherë nuk ka kaluar nëpërmjet parlamentit, por të cilën pushtetarët e komentojnë ndryshe, varësisht nga personi ndaj të cilit zbatohet.

2. Konfiskimi dhe ekspropriimi

Konfiskimi i pasurisë kryesisht është zbatuar ndaj atyre që përkohësisht kanë munguar, posaçërisht ndaj atyre banorëve shqiptarë të cilët janë dyshuar për ndjenjat e "patriotizmit" serb. Sa i përket vërtetësisë formale, këtu nuk ka kurrfarë dileme. Secila akuzë, e cila vjen nga ana e një serbi kundër një shqiptari, vendoset në dëm të shqiptarit. Nëse nevojiten dëshmi plotësuese, anëtarët e "Mbrojtjes Populllore" dhe "Dora e Bardhë"[57] gjithmonë janë gati ta kryejnë atë shërbim patriotik.

Ne këtu nuk mund t'i japim të gjitha rastet e konfiskimit të padrejtë, të cilat neve na janë të njohura, sepse kjo do të ishte e pamundur. Përsëri do t'i japim disa raste shumë të mëdha për një rreth të kufizuar:

a) U kanë konfiskuar pasuritë, edhe pse nuk është ditur shkaku, personave në vijim nga rrethi i Pejës:

Jusuf Arifi nga fshati Bec

Grosh Arifi nga fshati Papiq

Bajram Sula nga fshati Kërtsoc

Mahmut Beu

Krejt kjo pasuri e patundur është llogaritur në mbi dy mijë hektarë.

b) Është bërë ekspropriimi i pasurisë së patundshme i shumicës së shqiptarëve të pasur, që t'i detyrojnë që, pa protestuar, t'i nënshtrohen pushtetit jugosllav. Vetëm disa shembuj nga qarku i Gjakovës: Asllan Kurt Beu, Ibrahim Beu, Ismet bej Kryeziu, Ahmet bej Berisha, Poloshka, Halit Bakalli, Muhamet Pula, Preng Gjoka, Mark Nikollë Biba nga Brekoci, Miftar Dema nga Zhubi, Hysni beu nga Zhubi, Gjon Marku nga Guska, Gjon Doda nga Pllançori.

[57]Organizatë shoviniste e oficerëve, e cila mbështetej nga mbreti Aleksandër Karagjorgjeviq.

3. Konfiskimi i pasurisë së përbashkët

Jo vetëm personat individualisht, por edhe fshatrat kanë qenë të prekura nga ekspropriimi dhe konfiskimi. Kështu u janë marrë kudo kullotat fshatarëve shqiptarë. Ja disa shembuj:

a) Në qarkun e Gjakovës: Marrmullë, Rezinë, Brodesanë, Lumbardhë, Llugë, Xherinë, Lugbunar, T. Rakaniç, Bec, Pallabardh, Gërgoc, Dobrixhë, Firajë, Ramoçen i Madh, Fushë e Kronit, Te Plaka (Piskota), Baballoç, Deçan, Lloçan, Vekçë, Kalavajë e Junikut, Batushë, Pacaj, Racaj, Plançor, Dujakë, Hereç, Ponashec, Brovinë, Nec, Babajt e Bokës, Koronicë, Mejë, Guskë, Fushë e Turpos, Breskoc, Vogovë, Zhup, Firzë, Moglicë, Raçe, Pjetershan, Kusar, Dodë, Kushavec.

b) Disa shembuj të tjerë nga qarku i Pejës: Isniq, Strellc, Fushë, Pishtajkë, Baran, Leshan, si dhe tërë kullosat deri te lumi i Drinit dhe që andej, deri në Gjerovicë, Rakosh, Ujmir, Rudnik.

Fati i njëjtë i ka përfshirë edhe krahinat tjera të banuara me shqiptarë.

4.- Reforma agrare

Dom Toma Gusic was a parish priest in Janjevo until 1871, he was succeeded by dom Ndue Bytyqi, who was a parish priest there for only a year, and in 1872 Filip Canci was appointed parish priest.

On March 25, 1891, Schmicker's consul reported that Janjevo's priest Ndue Bytyqi was robbed on the street of Ferizaj and this indicates that in that year Dom Ndue Bytyqi was a parish priest in Janjevo. However, two years later he, he was again parish priest in Skopje.

On October 1893, after having changed many positions as priest in different cities, was re-appointed as Vicar in Skopje, instead of the Vicar Don Vittorio Pvassich. He had to have served in Prizren, but at the same time we learn that they appointed him as the secretary of Skopje Archbishop, Pashk Trokshi, but it turns out that Bytyqi was also secretary of the former Archbishop of Skopje, Fulgenzio Carev.

In June 1894, the Archbishop of Skopje, Pashk Trokshi, had requested from the Vienna government for the support of the construction of the Catholic church in Skopje. The government rejects this request, but then Trotsky contacts the Emperor Franz Joseph I. Since some kind of support was provided at this time, they required more information from Skopje. Skopje, at this time, did not have any suitable church; there was only a small chapel where Dom Ndue Bytyqi served. Trokshi felt that there was no money to build a church in Skopje. Whereas the parish priest of Skopje dom Ndue Buqyti wrote to the Empror that he himself gives 150 napoleons for the building of the church in Skopje. The Consul of Austro-Hungarians in Skopje, Julius Pisko, made a request for 5,000 gulden to be paid back in two installments for the construction of the Catholic Church in Skopje, and the bills would have to be paid in 1897 and 1898. Pisko thought that it is important for Skopje to build a church because a lot of people visited this city and it was in the interest of Austro-Hungaria to have such an object. The government in Vienna rejected Pisko's request, but at the same time, for restoring the chapel in Skopje in January 1897, they donated 200 francs. In May 1898, he requested help regarding the building of the church in Skopje, and in January 1898, with the pretext that the Chapel in Skopje was almost completely destroyed, he asked for their help once again. This is also proven by the Jesuit missionaries led by Domenico Pasin, who visited Skopje at the time.

Following this request from Piskos, Vienna approves 10,000 francs for the construction of the Catholic Church in Skopje, on January 1899 in two installments and the first installment was paid in January the same year.

It should be borne in mind that at this time Austro- Hungary financed an elementary school near the Catholic Church where Ndue Bytyqi served as a teacher.

Dom Ndue Bytyqi at this time is invited by the country's derebey (lord of the valleys during the Ottoman Empire) to report on the construction of the Church in Skopje, as he wanted to know the source of funding, while the Austro-Hungarian consul thought that Austro- Hungary deemed appropriate to be recognized as a supporter of the Church construction in Skopje.Hector Finazzer, who was the successor to Engineer Schusser, who initially planned a church that would only host about 150 people, was the leader of the architects team charged with the building of the Church in Skopje. The Church of Skopje should be for about 250 people, because at that time 234 Catholics lived in Skopje, while 112 were foreign, of which 49 were only from the Austro-Hungarian Monarchy. Thus, the Austro-Hungarian Empire for the construction of the Catholic Church in Skopje, for the building of which 1,000 napoleons were needed, gave 500 napoleons.

For the construction of the Catholic Church in Skopje, completed in 1903 under the supervision of Hector Finazzer and Franz Jenisch, the Austro-Hungarian Empire decorated some of its people,.It is interesting to note that Consul Para, in 1902, had presented to the Ministry of Foreign Affairs of Austria the accounts for the construction of the Church in Skopje the following sums: the total construction was 37,176.30 francs, from which the Roman Catholic scholars paid 760 francs, large sums came from foreigners living in Skopje at that time, while the Ministry of Foreign Affairs of Austria paid up to 1903 a total of 28,794.8 francs.

We have found several documents and letters from Skopje's parishioners in support of the construction of the Catholic Church in Skopje, especially letters from Ndue Bytyqi, parish priest of Skopje, as well as other parishioners, such as Pashk Dukagjini, Nikola Glasnovic and Dom Mikel Tarabulluzi. In these papers and documents we can see the engagement of Dom Ndue Bytyqi for the construction of the Catholic Church of Skopje, for which, he himself had donated 200 francs. We have found letters signed by the Catholics of Skopje on May 15, 1898, featuring the names of Joseph Lukas, Paloka Latif, Prenki Tunis, Mark Tosh, Angel Marku, together with

Dom Ndue Bytyqi. Attached to these documents is the plan for the construction of the Catholic Church in Skopje and accounts of how much the construction has cost, which ended in 1903 when he was ordained by the Archbishop of Skopje, Pashk Trokshi, in the presence of Kolë Bojaxhiu as seen in a photograph in front the church. The Jesuit and the Italian missionary, Domenico Pasi, on October 21, 1896, finally traveled from Prizren to Letnica through Ferizaj, together with Nicholas Mazarek and Lush Kurt. In Ferizaj, he writes about meeting Dom Ndue Bytyqi, who came from Skopje where he was a parish priest, and who was traveling to Letnicë, for spiritual exercises. Spiritual exercises are practiced by priests or nuns, who retreat for some days in silence, to have time for prayer and meditation.

In 1903, the Catholic Church of Skopje was ordained. For this event, the church had also received some gifts from Austria's Tyrol, namely two wooden altars and two figures, one of Our Lady's, and the other of St. Ndou (Antony), also made of wood., Dom Ndue Bytyqi had fought for the donation of these figures, which he had blessed in Skopje.

According to a report by Domenico Pasi, a Jesuit who served as a missionary in the Albanian territories called "Missio Volante" (1888-1912), in 1910 wrote to Dom Ndue Bytyqi that he had offered his property to his missionaries in Skopje so that they could work freely, while in Skopje they received the help of Gaspet Zadrima from Skadar.

IV.2 LORENC ANTONI (1909-1991)



-Me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së kompozitorit, dirigjentit dhe etnomuzikologut të njohur shqiptar, Lorenc Antoni, Postat e Maqedonisë emituan pullën postare me figurën e tij.

-On the occasion of the 25th anniversary of the death of the well-known Albanian composer, conductor and ethnomusicologist Lorenc Antoni, Postal stamps with Lorenc Anton's portrait were promoted, in cooperation with the Post of Macedonia.



-Shkup, 21.10.2016 – Me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së kompozitorit, dirigjentit dhe etnomuzikologut të njohur shqiptar, Lorenc Antoni, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup, në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë, u organizuan tribunë përkujtimore, ku edhe u promovua pulla postale me figurën e Lorenc Antonit. Mori pjesë edhe vajza Lorenc Antonit, znj.Vilma Antoni–Bejtullahu.

-Skopje, 21.10.2016 - On the occasion of the 25th anniversary of the death of the well-known Albanian composer, conductor and ethnomusicologist Lorenc Antoni, at the Institute of Spiritual and Cultural Heritage of Albanians in Skopje (ITSHKSH), in cooperation with the Post of Macedonia, a memorial tribune was organized, where postal stamps with Lorenc Anton's portrait, were promoted. The daughter of Lorenzo Antony, Mrs. Vilma Antoni-Bejtullahu, also attended this event.

Është nderë i Institutit që të rikthejë vëmendjen te figurat e mëdha që kanë lënë gjurmë në lëvizjet kombëtare dhe kulturore për popullin shqiptar. Familjet Antoni dhe Bojaxhiu kanë dhënë kontribut të madh në shqiptarësinë e Shkupit, andaj nderi ynë është që të zbardhim të kaluarën e tyre historike, si një mesazh për gjeneratat e ardhshme.

Lorenc Antoni lindi në Shkup më 23 shtator 1909; vdiq në Prishtinë më 21 tetor 1991. Ishte kompozitor, dirigjent dhe etnomuzikolog i shquar shqiptar. Qysh fëmijë aktivizohet në ansamble të ndryshme muzikore të shqiptarëve. Studion privatisht muzikë në Shkup dhe Beograd. Pas shkollimit në Fakultetin Filozofik të Shkupit kthehet në Ferizaj dhe më pas ngre të parën shkollë të ultë dhe të mesme muzike "Josp Sllavenski" në Prizren më 1948. Po në këto vite drejton si dirigjent edhe korin e shkollës muzikore, atë të shoqërisë kulturore artistike "Agimi" si dhe orkestrën simfonike të qytetit të Prizrenit. Pas këtyre viteve vazhdon të merret intensivisht me

kompozime, dirigjime të veprave, veprimtari pedagogjike etj.Në fushën e studimit të folklorit, Lorenc Antoni vlerësohet se i pari mblodhi dhe botoi shtatë vëllime të muzikës popullore shqiptare të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Moravës Jugore të shoqëruar me analiza etnomuzikologjike mbi gjithë këtë lëndë që është transkiptuar po prej tij.Ka kompozuar edhe muzikë, ndër to dallohen kompozimet vokale. L. Antoni konsiderohet edhe si kompozitori i brezit të parë të kompozitorëve të Kosovës. Gjithashtu ai bëri përpjekje për hapjen e shkollës së parë të muzikës më 1948 në Kosovë.

Në shenime mbi vepren e prof. Akil Mark Koci: "Kompozitori Lorenc Antoni-Jeta dhe veprat", Lorenc Antoni ka qenë mësues, si qindra të tjerë, ka qenë drejtues shkolle, ka punue në Radio, si pak të tjerë, dhe mund të mos linte asgja mbas vedit, veç punës së tij… Edhe sikur të mos kishte ba asnjenën prej punëve të masiperme, Antonit do t'i mjaftonte ajo punë e jashtzakonshme si mbledhës i folklorit, si etnomuzikolog, (për të mos i vue tituj të tjerë), pra sikur të na kishte lanë vetëm këte punë "të papagueme", të bame jashtë orarit të punës së zakonshme, që L. Antoni të kishte vendin e vet në panteonin e kombit. Por L. Antoni ishte shumë ma tepër!

Është me të vertetë e habitshme se si nganjiherë edhe rastësia të ban të takohesh me historinë... Do të mjaftonte ndoshta edhe vetëm ajo kangë, e shkrueme nga i riu 19 vjeçar Lorenc Antoni për motrat Gongje e Angje Bojaxhiu me rastin e një veprimtarie bamirësie, që emni i tij të kujtohej për të mirë. (Bahet fjalë për kangën "Në breg të liqenit" kompozue nga gjimnazisti i ri, sipas poezisë së Hilë Mosit, krijue për atë rast). Pra jemi në vitin 1928 e njena prej atyne motrave do të bëhej Nanë Teresa: e përvujtuna dhe e madhja, e krrusuna nga pesha e vuajtjes së njerëzve dhe e naltësuemja në qinda shtatore në mbarë botën...deri në altar. Ajo kangë i solli mbarësi Lankut, o ndoshta, ma shumë, ai "takim" do t'i jepte kuptim asaj rruge të pashkelun që do ta bante edhe atë të pavdekshëm për kombin e vet.[64]

Veprat letrare

"Këngë popullore shqiptare të Kosovës dhe Metohisë", Prishtinë 1953; "Folklori muzikor shqiptar", me shtatë vëllime, Prishtinë 1956-1977; "Balada dhe legjenda", Prishtinë 1973; "Përrallat". I, Prishtinë 1979;

[64]Robert Prennushi, "Kompozitori Lorenc Antoni Jeta dhe veprat", https://www.facebook.com/notes/the-albanian/kompozitori-lorenc-antoni-jeta-dhe-veprat/10150132973327258/

"Kërkime folklorike", Prishtinë 198; "Përrallat", II, Prishtinë 1982ë; "Këngë kreshnike", I,II,III; "Vajtime, gjamë dhe elegji; "Këngë dasme", I,II etj.

Artikuj shkencorë

"Folklori muzikor shqiptar", tek "Jeta e re", 1949, nr. 1; "Format e ritmit të këngëve popullore shqiptare", tek "Jeta e re", 1949 (nr. 1), 1950 (nr. 5 dhe 6) 1951(nr. 1); "Bazat tonale të këngëve popullore shqiptare", tek "Përparimi", , 1952, nr. 11-12; "Këngët popullore nga Opoja", tek "Përparimi", 1959, nr.2-3; "Të kënduemit popullor shqiptar", tek "Zvuk", 1960, nr. 41-42; "Dy mënyra të kënduemit te shqiptarët e Malit të Zi", tek "Përparimi", 1961; "Format muzikore të këngëve popullore shqiptare", tek "Zvuk", 1963; "Trajtat polifonike të muzikës popullore vokale të gegëve", "Gjurmime Albanologjike", II/1972; "Elementët polifonikë në muzikën popullore të Opojës", Gjurmime Albanologjike", II/1974 etj.

LORENC ANTONI (1909-1991)

The Institute has the honor to commemorate the great personalities that have played an important role on the national and cultural movements of the Albanian people. The Antoni and Bojaxhiu families have given a great contribution to the Albanian population of Skopje, so our honor is to unravel their historical past as a message to the future generations.

Lorenc Antoni was born in Skopje on September 23, 1909; died in Prishtina on October 21, 1991. He was a distinguished Albanian composer, conductor and ethnomusicologist. From early childhood, he was an active member of different Albanian music ensembles. He studied music in Skopje and Belgrade.

After graduating from the Faculty of Philosophy in Skopje, he returned to Ferizaj and then opened the first music elementary and high school "Josp Sllavenski" in Prizren in 1948. In these years, he also conducted the choir of the music school, the artistic and cultural society "Agimi" as well as the symphony orchestra of the city of Prizren. After these years, he continued to work intensively by composing music, conducting, pedagogical activities, and so on. In the field of folklore research, Lorenc Antoni is estimated to be the first to gather and publish seven volumes of Albanian folk music in Kosovo, Macedonia, Montenegro and Southern Moravia accompanied by an ethnomusicological analysis of this subject. He has also composed music, whose vocal compositions were distinguished as the best. L. Antoni is also considered being the first generation of composers in Kosovo. He also made efforts to open the first music school in 1948 in Kosovo.

According to the notes on the work of prof. Akil Mark Koci: "The Composer - Lorenc Antoni's -Life and Works", Lorenc Antoni has been a teacher, like hundreds, has been a schoolmaster, has worked on Radio, like a few others, and could leave nothing behind to be remembered by other than his work. Even if it had not been for his work, Anton would have enough of that extraordinary work as a collector of folklore, as an ethnomusicologist (for not having other titles), so if he had left only this "unpaid" job, work he did outside his job, it would be enough for L. Antoni to secure his place in the pantheon of the nation. But L. Antoni was much than this!

It is surprisingly how sometime coincidence gives you the chance to meet history ... It would be enough just that tune, written by the young 19 year old Lorenc Antoni for the sisters Gongje of Angje Bojaxhiu on the occasion of a charity activity , that his name should be remembered for good. (the song was "On the shore of the lake" composed by the young high school boy, based on the poem of Hilk Mosy, creates for that occasion). So, we are in 1928 and one of the sisters would become Mother Teresa: the humble and the great, burdened by the burden of suffering of the people and the subject in the hundreds of statues all over the world ... up to the altar. That song brought Lankut to prosperity, or perhaps more, that "meeting" would make sense of that unknowing way that would also make him immortal to his nation.

Literary works

"Këngë popullore shqiptare të Kosovës dhe Metohisë", Prishtinë 1953; "Folklori muzikor shqiptar", me shtatë vëllime, Prishtinë 1956-1977; "Balada dhe legjenda", Prishtinë 1973; "Përrallat". I, Prishtinë 1979; "Kërkime folklorike", Prishtinë 198; "Përrallat", II, Prishtinë 1982ë; "Këngë kreshnike", I,II,III; "Vajtime, gjamë dhe elegji; "Këngë dasme", I,II etj.

Scientific work

"Folklori muzikor shqiptar", tek "Jeta e re", 1949, nr. 1; "Format e ritmit të këngëve popullore shqiptare", tek "Jeta e re", 1949 (nr. 1), 1950 (nr. 5 dhe 6) 1951(nr. 1); "Bazat tonale të këngëve popullore shqiptare", tek "Përparimi", , 1952, nr. 11-12; "Këngët popullore nga Opoja", tek "Përparimi", 1959, nr.2-3; "Të kënduemit popullor shqiptar", tek "Zvuk", 1960, nr. 41-42; "Dy mënyra të kënduemit te shqiptarët e Malit të Zi", tek "Përparimi", 1961; "Format muzikore të këngëve popullore shqiptare", tek "Zvuk", 1963; "Trajtat polifonike të muzikës popullore vokale të gegëve", "Gjurmime Albanologjike", II/1972; "Elementët polifonikë në muzikën popullore të Opojës", Gjurmime Albanologjike", II/1974 etj.

IV.3 DOM GASPËR GJINI (1930-198), KLERIK, INTELEKTUAL, POLIGLOT, KRIJUES DHE SHKENCËTAR

Jeta dhe vepra e dr. dom Gaspër Gjinit janë përmendore e vërtetë, fetaro-kulturore për mesin tonë, edhe më gjerë, për popullin tonë shqiptar që nuk vrugnohet nga pluhuri i harresës as nga vjetërsia e moteve. Ai i pari e dha një paraqitje panoramike të historisë së krishterizmit në popullin shqiptar, prej kohës apostollike e deri në ditë tona. Kjo pasqyrë e së kaluarës sonë, të përgjakshme dhe të lavdishme, pa pikë dyshimi do të jetë dritë dhe rrugë për një ardhmëri më të mirë. Këtë e theksojmë sepse ai ka hulumtuar në shumë biblioteka botërore, si njohës i shumë gjuhëve të huaja, kurse në Bibliotekën e madhe të Vatikanit ai ka vjel nga burimet e tyre materiale të shumta për etnogjenezën nacionale dhe fetare, që për ato shkrime shkencore janë dhënë vlerësime të shumta pozitive për punën e tij të madhe shkencore. Pa dyshim se, vepra kruciale e tij është studimi shumë i rëndësishëm *'' Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj''.*

Shumë kohë duke kaluar dhe gjurmuar nëpër arkiva dhe biblioteka botërore, libri i don Gasprit sjell bibliografi tejet të pasur, me dokumenta dhe materiale arkivor, me burime dhe literaturë të shfrytëzuar, që bën veprën jashtëzakonisht qenësore dhe të rëndësishme për historinë dhe shkencën tonë, si edhe të përgjithshmen.

Dr. dom Gaspër Gjini lindi në Ferizaj. Në Shkodër shkoi herët, për të marrë mësimet prej shkollarëve të devotshëm françeskanë. I shtangur nga prirja dhe suksesi i treguar në shkollë, pas kthimit nga Shkodra shkollimin e vazhdoi në Pazin* të Istrisë, e Fakultetin Teologjik katolik e kreu në Gjakovo të Sllavonisë. Pas shërbimit ushtarak dhe studimeve u kthye në Shkup ku kryente detyrën e sekretarit të ipeshkvit Smiljan Cekada**, pas tërmetit (1962) shërbimin meshtarak e bëri në Ferizaj. Më vonë ishte kancelar, dhe së fundi, deri në vdekje, famullitar i katedrales së Shkupit, e cila është ndërtuar më 1982.

Për vite me radhë ishte kryetar i Gjyqit Kishtar Dioqezian, anëtar dhe bashkëpunëtor i zellshëm dhe tejet i frytshëm redaksisë ''Drita'' (gazetë e përmuajshme fetare-kulturore e Kishës katolike) dhe studiues i

palodhshëm i së kaluarës sonë fetaro-kombëtare. Për këtë gazetë u dallohej si bashkëpunëtor i përhershëm me shkrime të ndryshme mbi të kaluarën e besimtarëve katolik dhe me tema fetare.

Nga fytyra e tij e ndritshme mund të veçohet: mikpritja dhe zemërgjerësia, butësia, buzëqeshja dhe ngrohtësia që kishte për çdo njeri pakufi dhe pa dallim feje, race e ngjyre. Ai për të gjithë ishte prind, babë dhe vëlla, njeri prekatar, por edhe bari i popullit. Në mbamendje pozicionohet si njeri modest e vetëmohues , me diapazontë gjërë të njohurive të thella dhe të arsimimit të lartë teologjik, i cili prore me gjithë zemër dhe i përkushtuar ka ndihmuar në raste të nevojshme. Tërë jetën ia kushtoi Hyjit dhe popullit. Përherë ka mbetur punëtor i palodhshëm me gjykim të drejtë.

Hapur mund të thuhet se don Gaspri ka qenë fryt i pjekur e i zellshëmi një bashkësie krishterë. Një fryt i tillë nuk lind nga asgjëja. Ai qëndron në mbarim të rrugës njerëzore krishterë i cila është nderë i bashkësisë prej së cilës vjen. Veçohet kujdesi dhe puna e ij vetëmohuese në famulli, mençuria, modestia, optimizmi dhe komunikimi, urtia dhe fjala e mirë që kishte për çdo kënd dhe çdoherë. Entuziazmi i tij për punë, për shtyp , për bashkëpunim vëllazëror me tërë klerin, për të mirë të ipeshkvisë, edhe më gjerë, për të mirë të popullit rinohej gjithnjë. Ishte vizitor i famullive të ndryshme, duke përhapur shpirt të lutjes apostolike. Kolegët nëpër famullit me gjithë zemër i këshillonte dhe orientonte. Të tërë aftësinë dhe dijeninë e ka derdhur për të mirën e kishës dhe të besimtarëve të vet. S'ka krijuar familje, por ka jetuar me të tjerët e për të tjerët. Pjesën më të madhe të jetës meshtarë ia kushtoi veprimtarisë baritore dhe studimeve. Toka kosovare rriti një njeri prift e atdhetar dhe e mban në gjirin e saj, e neve na takon ta falënderojmë Zotin dhe ta kujtojmë me pietet.

Doktoroi në Romë të drejtën kanonike në Universitetin e famshëm ''Propanganda Fide – Urbaniana'' në vitin 1968 me temën '' De fontibur historico-juridicis ecclesiae Scopiensis'', Romae, 1968 (Mbi burimet hisorike-juridike të Kishës së Shkupit), shkruar de mbrojtur në gjuhën latine, me suksesin më të lartë. Për sukses të treguar, si student më i mirë në Kolegjin internacional Papnor të Vatikanit në Romë, papa Pali i VI e dekoroi me medalje të art, dhe për ditën e Shën Pjetrir dhe Shën Palit, mbi varrin e tyre çou meshën shenjtë së bashku me papën.

Ai është doktorant i parë shqiptar nga Kosova pas Luftës së Dytë Botërore. Temën e doktoratës më vonë e ka punuar dhe në formë të zgjeruar e botoi në gjuhën kroate (Skopsko-Prizrenska biskupija kroz stoljeca – KS –

Drita, Zagreb, 1986), më vonë në gjuhën shqipe(Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj – Drita, Ferizaj, 1992), më vonë në gjuhën angleze (The Shkup – Prizren Diocese Through Centurie – Drita, Prizren, 2000). Ky libër i jashtëzakonshëm do të jet plotësim i mirëseardhur i bibliotekave të të gjithë atyre që iu kanë kushtuar studimit të ilirëve të lashtë, qofshin shkencëtarë apo lexuese të rëndomtë të cilët dëshirojnë të pasurojnë dijeninë e vet mbi ilirët.

Ja si e përfundon librin dom Gaspri:

''Jetojmë me plot shpresa se ardhmëria do ta plotësojë krejt atë që na e kanë marr shekujt. Le të na ndihmojë i Miri Zot që këto përpjekje fisnike të realizohen''.

DON GASPËR GJINI (1930-198) CLERIC, INTELLECTUAL, POLIGLOT, CREATOR AND SCIENTIFIC

Life and Works of Dr. Don Gasper Gjin are a true religious and cultural monuments for the Albanian people and beyond, for those not ruined by the dust of forgetfulness or the passing of time. He was the first to write an extended history of Christianity among the Albanian people from the apostolic times to our day. This mirror of our past, bloody and glorious, without doubt will be the light and the way for a better future. We emphasize this because he has researched in many world libraries, as a polyglot, whereas in the great Vatican Library he has collected from their numerous material resources information and documents for the national and religious ethno-genesis. His scientific writings earned him numerous positive evaluations. Undoubtedly, his crucial work is the very important study " Diocese of Skopje-Prizren through centuries".

Dr. Don Gasper Gjini was born in Ferizaj. He moved to Skadar as a young man, to study from devoted Franciscan scholars. Impressed by the tendency and success shown at school, after returning from Shkodra he continued his education in Pazin * of Istria, and he graduated from the Catholic Theological Faculty at Gjakova, Slavonia. After military service and studies returned to Skopje where he served as the secretary of bishop Smiljan Cekada **, after the earthquake (1963) he performed the Mass in Ferizaj. Later he became chancellor, and then, until his death, he served as a parish priest of the cathedral of Skopje, which was built in 1982.

For many years he was President of the Diocesan Court, a diligent and extremely fruitful member and collaborator of the "Light" - the Catholic religious-cultural monthly newspaper and tireless researcher of our national-religious past, where he was distinguished as a permanent collaborator with various papers on the past of Catholic believers and religious themes.

He has poured out all his ability and knowledge for the benefit of his church and believers. He did not have a family but lived with others and for others. Most of his clerical life was devoted to pastoral activity and studies. He finished his PhD in Rome on the subject- canonical law, at the famous Propanganda Fide - Urbaniana University in 1968 under the theme

of De fontibur historico-juridicis ecclesiae Scopiensis, Rome, 1968 (On the Religious – historic Resources of the Church of Skopje) written and presented in Latin, with the highest success. For the success shown, as best student at the Vatican International College in Rome, Pope Paul VI decorated him with a golden medal, and for the day of St. Peter and St. Paul, he lead the the holy mass together with Pope.

He is the first Albanian PhD from Kosovo after World War II. He worked and expanded his doctoral thesis later in live, in Croatian (Skopsko-Prizren biskupija kroz stoljeca - KS - Drita, Zagreb, 1986), than in Albanian (Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj – Drita, Ferizaj, 1992), më vonë në gjuhën angleze), after that in English (The Skopje - Prizren Diocese Through Centuries - Drita, Prizren, 2000). This extraordinary book will be a welcome addition to the libraries of all those who have devoted themselves to the study of ancient Illyrians, be they ordinary scientists or readers who want to enrich their knowledge of the Illyrians.

Here's how Don Gaspri concludes:

"We live full of hope that the future will fulfill all that the centuries has taken from us. May Good Lord help us to achieve these noble efforts. "



Nëna Tereza dhe Gaspër Gjini[65]

[65] Vinçenc, Gjini. 2012. Unë jamVinçenc Gjini (I am Vinçenc Gjini). Zagreb, 58.



Papa Pali I Vi dhe Don Gaspri[66]

[66] Fotografia eshtë marrë nga fondi familijar Gjini. The picture is taken from personal funf from the Gjini family

IV.4 VINÇENC GJINI



[67]

Vinçenc Gjini[68]

Vinçenc Gjini ka lindur në Ferizaj më vitin 1935. I përket gjeneratës së parë të muzikantëve akademik shqiptar në trevat veri – lindore (Kosovë dhe Maqedoni). Një pjesë të shkollimit fillor e ka mbaruar në Shkup, ndërsa studimet universitare dhe pasuniversitare i ka kryer në Beograd dhe bëhet magjistër i parë i shkencave muzikore në trevat etnike shqiptare nën ish

[67] Vinçenc, Gjini. 2012. Unë jamVinçenc Gjini (I am Vinçenc Gjini). Zagreb, 129.
[68]Vinçenc Gjini, Unë Jam,Velika Gorica, 2012,321.

federatën jugosllave. Më vonë në Shkup ka kryer edhe studimet e rregullta të kompozimit.

Ka jetuar e punuar në Prishtinë mbi 30 vjet, deri në pension, e prej vitit 1993, me familje, jeton në Kroaci, në qytezën e Istrisë – Bujë. Ndërsa, familja më e gjërë ende jeton në qytetin e Shkupit.

Është koautor i librave të parë shkollor në gjuhën shqipe, për Edukatën e muzikës, si dhe autor i librit "Harmonia", të dedikuar për studentë.

Ka kompozuar vepra të ndryshme muzikore: për fëmijë, korale, solistike, instrumentale, kamerale, orkestrale (4 simfoni e 1 simfoniet), vokalo – instrumentale (shtatë kantata) etj. Është edhe autor i katër edicioneve të muzikës sakrale: Libër këngësh korale kishtare, Eni t'i këndojmë Zotit I dhe II dhe i kantualit Ta lavdërojmë Zotin. Nënës Terezë ia ka kushtuar dy vepra formatit më të madh, të kompozuara për solist, kor dhe orkestër: Meshën klasike dhe oratorion Dallëndyshja Mirandjellse.

Si nismëtar dhe profesor i parë universitar i muzikës konsiderohet si pionier i shkollimit të lartë në Kosovë. Është cituar në disa Enciklopedi dhe është anëtar i Shoqatës së kompozitorëve të Kosovës (SHKK) dhe i Shoqatës së kopozitorëve të Koroacisë (HDS).

VINÇENC GJINI

Vincenc Gjini was born in Ferizaj in 1935. He belongs to the first generation of Albanian academic musicians in north-eastern areas (Kosovo and Macedonia). He finished a part of his elementary education in Skopje while his undergraduate and postgraduate studies have been conducted in Belgrade making him the first master of musical sciences in ethnic Albanian areas under the former Yugoslav federation. Later in Skopje he also completed his composing studies .

He lived and worked in Prishtina for over 30 years until his retirement, and since 1993, with his family, he has been living in Buje, a town in region of Istria, Croatia.. While the widest family still lives in the city of Skopje.

He is co – author of first school books in Albanian language, used in musical education. In addition, he is the author of the book Harmonia, written for college students.

He has composed various types of compositions, such as children's, chorale, solo, instrumental, chamber, orchestral (4 symphonies and 1 sinfonietta), vocal and instrumental (7 cantatas),. He is also the author of four editions for sacred music: Libër këngësh korale kishtare, Eni t'i këndojmë Zotit I dhe II and the book Ta lavdërojmë Zotin. He has devoted two compositions of larger format to Moher Theresa, composed for soloists, choir, and orchestra: Meshë klasike, and the oratorio Dëllëndyshja Mirandjellse.

As the initiator and the first university professor, he has been considered a pioneer of higher education in Kosovo. He is quoted in several encyclopedias and he is a member of the Association of Composers and the Croatian Composers Society.



[69]

[69] Vinçenc, Gjini. 2012. Unë jamVinçenc Gjini (I am Vinçenc Gjini). Zagreb, 16.

IV.5 FOTOGRAFI ME KOSTUME TRADICIONALE TË SHQIPTARËVE KATOLIK NË SHKUP

Veshja paraqet një element tejet të rëndësishëm të qenësisë sonë identitare, veçmas të kulturës popullore. Ajo fsheh gjurmë, apo elemente të një të kaluare të largët duke filluar nga kultura ilire, kultura e shqiptarëve të mesjetës, si dhe të shqiptarëve të kohës më të re. Veshja popullore poqese kundrohet nga pikëpamja e elementeve të zbukurimit që përmban në sfondin e saj përmbajtësor, pastaj nga trajtat e nduarduarshme artistike që i posedon brenda saj, por edhe nga roli dekorativ që ngërthen në strukturën kompozicionale, rezulton se është një përbërës tejet i çmuar estetik i trashëgimisë sonë kulturore, në veçanti të asaj shpirtërore.

Veshja popullore ka qenë një element specifik që ka përcaktuar edhe përkatësinë kombëtare shqiptare, madje si e tillë ajo ka qenë edhe një faktor tejet integrues, apo përbashkues pa marr parasysh divergjancat e natyrës konfesionale fetare. Pra, ajo ishte një kod i mirëfilltë i unitetit të përkatësisë kombëtare shqiptare. Në këtë drejtim, edhe shqiptarët e konfesionit katolik të Shkupit në periudhën midis dy luftërave botërore kishin ruajtur me xhelozinë më të madhe të gjitha pjesët e veshjes sonë popullore. Në të vërtetë, elementi më karakteristik i veshjes së tyre, por gjithsesi edhe i asaj shqiptare, ishin tirqit, në cilësinë e pantallonave të ngushta prej shajaku të bardhë e ndonjëherë edhe të murrmë ose të zi, me dy shqeka përpara që ngjisheshin pak më poshtë belit. Tirqit zbukuroheshin anës të qepurave dhe përqark xhepave e shqekave me gajtan të zi ose të bardhë. Një karakteristikë e këtyre veshjeve ishte edhe plisi i bardhë në trajtë gjysmësferike që padyshim se ishte një përcaktues kryesor i përkatësisë kombëtare shqiptare, nënkuptohet krahas gjuhës amtare. Në këtë kontekst, duhet shtuar se veshja e tipit me tirq si zakonisht shoqërohej nga këmisha, brekët ose tlinat, brezi çorapët, opingat, jeleku, xhamadani, varësisht nga krahina etnografike - herrka dhe mintani. Gjatë muajve të ftohtë të dimrit si pjesë e veshjes në fjalë ishte edhe xhurdia.

Në kuadër të veshjeve popullore, qoftë nga aspekti i llojllojshmërisë, por edhe nga aspekti i dekoracionit, ishte e begatshme ajo e gjinisë femërore, sidomos ajo e nuseve të reja. Në këtë drejtim, edhe gjinia femërore e

përkatësisë shqiptare e konfesionit katolik në Shkup në kohën midis dy luftërave botërore e kishte ruajtur me fanatizëm të madh çdo detaj, apo pjesë të veshjes sonë popullore. Në të vërtetë, pjesa femërore e këtij komuniteti kishte ruajtur në mënyrë aktive veshjen me këmishë të gjatë e një përparëse, apo pështjellak. Kjo veshje paraqet njëherit edhe tipin më të përhapur të veshjeve shqiptare në përgjithësi. Duhet shtuar se veshja me këmishë të gjatë është shoqëruar nga brekët ose tlinat, jeleku, mintani, brezi ose shoka, çorapët, opingat, mbulesat e kokës, siç janë marhama ose shamia, si dhe me aksesorë e stoli të ndryshme të arit e argjendit, si vathët, qaforet e vargje tjera në gjoks, bylyzikët, unazat dhe ndonjëherë edhe ndonjë amulet rruazash të ndryshme.

Si pjesë më e dalluar e kësaj veshje popullore veçohet pështjellaku, apo futa e cila krahas brezit, konsiderohet se i përket gjenezës, apo pjesës më të hershme të veshjes popullore, nënkuptohet nga aspekti historik. Në funksion të këtij konstatimi mund të merret fakti, përkatësisht e dhëna apo mënyra e mbajtjes së pështjellakut i cili qëndron i varur mbi trup, në cilësinë e një mbulese të rëndomtë të organeve të caktuara, apo delikate të trupit, përkatësisht të prehrit. Në këtë kontekst, pretendohet dhe besohet se në një kohë primordiale, apo parake, pështjellaku ka qenë pjesa e vetme e veshjes popullore, sidomos gjatë stinës verore.

Edhe veshja e cilësuar si orientale ka mbizotëruar në veshjen popullore shqiptare duke përfshirë edhe komunitetin shqiptar të Shkupit me përkatësi fetare katolike. Në të vërtetë dihet mirëfilli se ndikimet orientale fillimisht kishin kapluar qendrat urbane, kurse veshja si trajtë e kulturës materiale ishte përhapur me një shpejtësi të madhe. Veshja, apo moda çdoherë përhapet në mënyrë spontane, nënkuptohet me anë të procesit të imitimit. Si rrjedhojë, veshja me dimija kishte kapluar edhe komunitetin shqiptar të përkatësisë katolike në Shkup. Dimitë, në cilësinë e veshjeve orientale, vishen nga beli e poshtë, kurse nga beli e lartë kombinohen me këmishë, jelek, kurse për të reja edhe me dollamë, mintan me fije ari. Në këtë kontekst duhet shtuar se veshjet e sipërme që i shoqërojnë dimitë janë bartur edhe në veshjen e mirëfilltë popullore shqiptare, por ato tani marrin emërtime të karakterit oriental, punohen me materiale të fabrikuara dhe dekorohen me fije ari.

Struktura përmbajtësore e këtyre veshjeve popullore ka qenë e dekoruar me motive të ndryshme duke përfshirë ato të natyrës gjeometrike (pika, vija, rrethi, spiralja, kryqi, shenja "S", trekëndëshi, rombi, etj.),

kozmike (dielli, ylli, hëna), fitomorfe (druri i botës, lule të ndryshme, etj.), zoomorfe (gjeli, dallëndyshja, flutura, shqiponja, zogjtë, gjarpri, etj.), antropomorfe (figura e Nënës së Madhe, organe njerëzore, si syri, zemra, etj.). Të gjitha motivet në fjalë rezultojnë të jenë shumë të lashta dhe ndërlidhen me mitologjinë ilire, por edhe të mëvonshme. Në të vërtetë, në pjesën dërmuese të motiveve në fjalë pasqyrohet logjika e njeriut me bindje pagane kundruall realitetit objektiv.

Edhe ngjyra e veshjeve popullore flet me logjikën e saj përkatëse. Në këtë kontekst duhet cekur faktin se thjeshtësia e ngjyrave, përkatësisht përdorimi i zbehtë i tyre, apo përdorimi vetëm i ngjyrës së bardhë dhe të zezë i dedikohet një periudhe më të lashtë në aspektin kohor, kurse sistemi shumëngjyrësh me siguri se i dedikohet një kohe më të re. Pjesa më e dekoruar dhe më e ngjyrosur e veshjes popullore gjithsesi se ka qenë pështjellaku i nuseve të reja si simbol i pjellorisë, apo një jete të re[70].

[70] Interpretimin të fotografive me kostume tradicionale të shqiptarëve katolik në Shkup e ka shkruajtur prof. Dr Izaim Murtezani.

Photografs of traditional clothes of the Catholic Albanian families in Skopje

Raditional clothes are a very important element of our identity, especially of folk culture. It hides traces, or elements of a distant past, starting from the Illyrian culture, the culture of the medieval Albanians, as well as the Albanians of the newer era. The folk costume, if viewed from the point of view of the decorative elements contained in its substantive background, and of the peculiar artistic attributes within it, but also of the ornamental role embodied in the compositional structure, turns out to be a highly prized esthetic ingredient of our cultural heritage, in particular of that spirituality.

The folk costume has been a specific element that has determined the Albanian nationality, and as such it has also been a highly integrative factor, or a composite regardless of the divergences of religious beliefs. Therefore, it was a genuine code of unity among the Albanian nation. In addition to this, the Catholic Albanians of Skopje in the period between the two world wars had preserved with great jealousy the traditions of our folk costumes. Indeed, the most characteristic element of their dress, but of course the Albanian one, were Tirq- long pants worn by men in white or sometimes black or brown color. The Tirqs were embellished black or white laces on the sides and around the pockets. One characteristic of these clothes was the semi-spherical white traditional hat or aplis that was undoubtedly a major determinant of Albanian nationality, in addition to the mother tongue. In this context, it should be added that this type of clothes were usually accompanied by shirts, tlina, çorapeor traditional socks, opingat, traditional vests, xhamadan, depending on the ethnographic province - herrka and mintani. During the cold winter months as part of the dress code was also xhurdia.

Female Albanian folk costumes were, both in terms of variety and in terms of decoration, richer and more diverse, especially costumes for the new brides. Albanian Catholic women in Skopje between the two world wars had kept, with great fanaticism, every detail or part of our folk costumes. Indeed, the women of this community had preserved the tradition ofclothes with long-sleeved shirt and an embroidered apron. This type of clothes represents, at the same time, the most widespread type of Albanian clothing in general. It should be added that long-dressed clothing is accom-

panied by tlina, vest, mintani, brez- traditional belts, socks, opingat, head-scarf, as well as accessories and various gold and silver jewelry, such as earrings, necklaces, braces, rings and sometimes even amulets of different beads. The most famous part of this folk costume is pështjellakuwhich is, historically,the earliest folk costumewhich consistent of a long white shirt, and two ‘'pështjellak'' (a white apron), the front and the back one. ‘'pështjellakuiparmë'', or the front apron is as long as the shirt, and it was tailored to fit the woman's hip. ‘'pështjellakuipasëm'', the back apron was shorter than the front one. Among the earliest traditional clothing was xhurdia which is a type of clothing worn by young boys is mostly known and symbolizes pride. It was made of soutane and tailors were usually the ones who made it. It had long and tight sleeves, open-chested, waist-length, and had a loose part at the back.

Even the oriental costume dominated the Albanian folk costume, including the Catholic Albanian community of Skopje. Indeed, it is well known that oriental influences in clothes originally had started at the urban centers, while clothes and costume as a material culture or fashion, had spread at a great speed. Fashion style had always spread spontaneously, mostly by the imitation process. As a consequence, the wearing of a headscarf had also became part of the fashion in the Albanian Catholic community in Skopje. Muslims and Christians all wear the so-called Veshje me dimi (traditional embroidered pants similar to pantaloons). The clothing was combined with shirt, vest, mitani, pështjellak, socks, moccasins, head-scarf, and accessories such as earrings, bracelets, rings, necklaces and clasps.

These folk costumes had been decorated with various motifs including those of geometric forms (dots, lines, circles, spirals, crosses, "S", triangles, diamonds, etc.), cosmic (sun, the moon), phytomorphs (world wood, various flowers, etc.), zoomorfe (rooster, swallow, butterfly, eagle, birds, serpent, etc.), anthropomorphic (grandmother's figure, human organs such as eyes, hearts ect.). All the motives in question result to be very ancient and relate to Illyrian mythology. In fact, most of the motifs in question reflect human logic associated with pagan beliefs versus objective reality. In this context, it should be noted that the simplicity of colors, or the use of pale colors,like the use of white and black color, originates from an earlier period in history, while the multicolored system belongs to more modern times. The most decorated and most colorful part of the folk costume, however, has been the shred of new brides as a symbol of fertility, or a new life.

KARNAVALET

Nga definicionet e ndryshme që ekzistojnë për karnavalin, ky i fundit duke iu referuar botës krishtere, përkufizohet përgjithësisht si një manifestim përmbyllës, ose një lloj parakalimi para fillimit të agjërimit për hir të festës së Pashkëve. Meqenëse gjatë agjërimit nevojitej përmbajtja nga mishi dhe ushqimi me yndyrë, në ditët para agjërimit, sidomos në botën krishtere, mbaheshin manifestime kolektive në të cilat pjesëmarrësit i konsumonin pikërisht këto ushqime të ndaluara. Në përputhje me këtë logjikë, ndërlidhet edhe etimologjia e fjalës *karnaval.* Edhe pse nuk është plotësisht e qartë etimologjia e kësaj fjale, megjithatë dominon supozimi se kjo fjaë buron nga fjala latine *carnem levare,* ose *carnelevarium* që në përkthim do të thotë "të shmangësh mishin", ose "të privohesh nga mishi". Ndërkaq, përveç kësaj etimologjie, ekziston edhe një shpjegim tjetër i kuptimit të fjalës *karnaval.* Sipas këtij interpretimi, fjala karnaval buron nga kompozita *carrus navalis* që domethënë "hudhje, shtyerje e qerres", përkatësisht në kuptimin figurativ shënon një qerre të mbushur me të liga (të akumuluara në periudhën e dimrit) e cila ritualisht hudhet në ujë.

Pa marr parasysh etimologjinë e fjalës *karneval* dhe ndërlidhjen e tij me momente të caktuara të fesë krishtere, është e qartë se bëhet fjalë kryesisht për një manifestim parakrishter me domethënie kryesisht të natyrës pagane. Disa studies, madje edhe futjen në përdorim të fjalës *karnaval* në kulturën evropiane e konsiderojnë shumë të vonshme, apo e ndërlidhin me dekadën e tretë të shekullit XIX. Pra, kemi të bëjmë me një manifestim, apo ritual kolektiv me prapavijë pagane nëpërmjet të cilit shënohet ndonjë kalim në një periudhë të re kohore, kryesisht nga cikli dimëror në atë veror. Pra, si dukuri parakrishtere, karnavalet, ndoshta mund të ndërlidhen, madje edhe me festimet e Dionisit që kremtonin daljen e dimrit dhe kalimin në verë. Në vija të përgjithshme, karnavalet varësisht nga mjedisi i praktikimit të tyre, klasifikohen në dy lloje, apo karnavale të ashtuquajtura *magjike* ose *luperkaliane* që organizohen në mjedise rurale dhe karnavale të natyrës *kritike,* ose *saturnaliste* që organizohen në mjedise urbane. Në karnavalet e llojit të parë që ndërlidhen me ambiente të karakterit blegtoral hasim praninë e shenjave të mbijetojave të besimeve magjike dhe ritualeve që ndjellin pjellorinë, kurse në karnavalet e llojit të dytë, apo të atyre urbane

hasen elemente nëpërmjet të cilave atakohet realiteti shoqëror, përkatësisht dukuritë devijuese të njeriut dhe shoqërisë.

Karnavalet në cilësinë e manifestimeve popullore ishin dhe janë ende pjesë e rëndësishme e metropoleve evropiane ku grupe njerëzish parakalojnë nëpër rrugë e bulevarde të ndryshme, të maskuar e të transformuar në identitete të ndryshme duke denoncuar gjithmonë dhe duke u tallur kryesisht me vese e dukuri negative të realitetit jetësor, apo shoqërisë njerëzore në përgjithësi. Pjesë përbërëse e këtyre manifestimeve janë muzika, vallja, kënga, paroditë e ndryshme e kështu me radhë.

Jashta rrjedhave të këtij lloji të ritualit, përkatësisht karnavalit, apo atmosferës që krijohej me këtë rast, veçmas nëpër qendra urbane, nuk ishin edhe shqiptarët e përkatësisë katolike të Shkupit në kohën midis dy luftërave botërore. Ata organizonin mbajtjen e karnavaleve të tilla duke u veshur me maska të ndryshme dhe duke parakaluar nëpër rrugë e vende publike të Shkupit. Ky fakt flet se ata ishin pjesë përbërëse e rrjedhave të përgjithshme të kulturës popullore që praktikohej në Evropën e qytetëruar, përkatësisht nëpër qendrat e saja më të fuqishme urbane. Pra, rezulton se edhe shqiptarët katolikë të Shkupit, në kohën midis dy luftërave botërore, shijonin frytet e këtyre kremteve popullore, përkatësisht karnavaleve kur shpërthente gëzimi dhe hareja në zemrat e tyre. Pjesë e këtyre aktiviteteve karnavaleske ishin edhe qytete tjera ku jetonin shqiptarët si Korça, Shkodra, Gjirokastra e kështu me radhë.

Pra, karnavali ishte një kremte popullore, apo siç thotë Peter Burke, një pjesë teatrale vigane gjatë të cilit rrugët dhe sheshet kryesore bëheshin skena, qyteti bëhej një teatër pa mure dhe banorët, aktorë dhe spektatorë, e shihnin skenën nga ballkonet e tyre. Në të vërtetë nuk kishte një dallim të prerë midis aktorëve dhe spektatorëve, përderisa zonjat nga ballkonet e tyre mund të hidhnin vezë mbi turmën poshtë dhe të maskuarit shpesh ishin të lejuar të hynin në shtëpitë private. Karnavali ishte një kremte kur njerëzit çliroheshin përkohësisht nga trysnitë psikike të vitit, po ashtu harronin problemet me të cilat ballafaqoheshin paraprakisht dhe nëpërmjet të qeshurave e elementeve komike që praktikonin me këtë rast, mëtonin të ndjellnin shëndet dhe pjellori gjatë periudhës kohore që do të pasonte. Në këtë drejtim, Bahtini kishte të drejtë kur theksonte se karnavali nëpërmjet gostisë, të qeshurave dhe "barkut të ngopur" ndikonte në aspektin magjik

në ndjelljen e pjellorisë dhe njëkohësisht shijimin e një jete të re që shkaktonte ardhja e periudhës verore. Ngrënia dhe pija, por edhe të qeshurat e dëbojnë simbolikisht vdekjen dhe në mënyrë figurative ia hapin rrugën një jete të re, siç ndodh me periudhën verore kur fillon natyra të hapet dhe të gjelbërohet nga të gjitha anët e saj. Përmbajtja e karnavaleve afirmonte gjithsesi një logjikë të kësaj natyre[71].

[71]Interpretimin të fotografive me kostume tradicionale të shqiptarëve katolik në Shkup e ka shkruajtur prof. Dr Izaim Murtezani.

CARNIVAL

A Carnival, referring to the Christian world,is generally defined as a celebratory event that happens before the period of fasting and penitence in preparation for Easter. Since during fasting the consume of meat and fat is prohibited, in the days before fasting, especially in the Christian world, events like this were organized, where in which participants consumed exactly these prohibited foods. Although the etymology of this word is not completely clear, however, the assumption is that this word originates from the Latin word carnemlevare, or carnelevarium, which translates to "avoid flesh" or "deprive of flesh." Meanwhile, in addition to this etymology, there is another explanation of the meaning of the word carnival. According to this interpretation, the word carnival originates from the composite carrus-navalis, meaning "naval wagon, i.e. float", which, represents a cart filled with evil (accumulated during the winter period) which is ritually thrown into the water at the beginning of spring.

Regardless of the etymology of the word carnival and its interconnection with certain moments of Christian religion, it is clear that it is mainly about a pre-Christian ritual of mainly pagan nature. According to some studies, even the introduction of the word carnival in European culture, consider it related to the third decade of the nineteenth century. So, we are dealing with a manifestation, or a pagan collective ritual through which is marked a transition to a new period, mainly from the winter cycle in that of summer. Therefore, as a precursor phenomenon, the carnivals could probably be linked, even with the Dionysus celebrations that celebrated the end of winter and the arrival of summer. In general, carnivals, depending on their place where they were practised, are classified into two types, or so-called magical or luperkalian carnivals organized in rural areas, and carnivals of critical nature or saturnalist, organized in urban areas. On the first type of carnivals held in rural areas, we encounter the presence of the signs of the survival of the magical beliefs and the rituals that induce fertility, whereas in the second or the urban types of carnivals there are elements in which social reality is attacked, respectively deviant phenomena of man and society.

Carnivals in the form of popular public events were and still are an important part of European metropolises where groups of people overlook

various boulevards, masked and transformed into different identities by always denouncing and mocking the negative phenomena of everyday life or society in general. Integral part of these manifestations were music, dance, songs, and various parodies and so on. An integral part of this kind of ritual, namely the carnival or atmosphere that was created on this occasion, especially in urban centers, were the Catholic Albanians of Skopje at the time between the two world wars. They organized such carnivals, wearing different masks and parading the streets of Skopje. This fact suggests that they were an integral part of the general folk culture tradition that was practiced in civilized Europe, namely in its most powerful urban centers.

Dushë Gjini (1906-1971) ka lindur në Ferizaj, në një familje të sinqertë dhe të klasës punëtore. Origjina e prindërve të saj ishte nga Zym, u zhvendos në Ferizaj për një kohë të gjatë para se të lindte.

Kola ishte kreu i familjes. Ai ishte tregtar dhe zotëronte një kafene. Nga natyra ishte i përulur, i qetë dhe i mëshirshëm. Si një gjë e rrallë dhe kureshtje e kohës, për një shqiptar, mund të përmendim rastin që në vitin 1933 në Beograd ai mori një patentë shoferi dhe një makinë amerikane Chevrolet, të cilën e përdori si taksi në Ferizaj, Gjilan, Prizren, Shkup dhe Mitrovicë. Në vitet e dyzetë të shekullit të kaluar, Kola në Ferizaj kishte një fabrikë me tulla dhe një fermë delesh.

Kolë Gjini, si dhe vëllai i tij Ded Gjini ishin fëmijë të Markut dhe Prenë Gjinit. Vëllezërit Kola dhe Deda, si fëmijë të vegjël, mbetën jetimë kur e humbën nënën e tyre dhe babai i tyre Marku u martua me një grua nga Janjeva. Ajo lindi djalin Zef. Deda dhe gruaja e tij, kishin tre fëmijë: Florina, Viktori dhe Antoni (Toni). Ata u vendosën në Pullë, ku ende jetojnë edhe sot. Zefi nuk kishte fëmijë dhe jetonte në qytetin Novska. Ai ishte një njeri i qetë, i butë, i sjellshëm dhe i përulur.

Nëna Dushe, si shtëpiake, e mençur, e urtë dhe e guximshme, ka qenë kreu dhe shtylla e familjes. Një dëshmi e qartë për këtë është fakti që ajo në shtëpi ka lindur 12 fëmijë (pa mami).

Prindërit e nënë Dushës ishin Baltazar (Bala) Prenkpalin dhe Jane. Ajo lindi 14 fëmijë, nga të cilët vetëm katër, dy vëllezër Andrea (Nreka) dhe Toni, dhe dy motra Maria dhe Dusha, mbijetuan. E gjithë familja e përdori emrin e babait të tyre si një mbiemër familjar. Xhaxha Andre, me bashkëshorten e saj Liza, kishte tetë fëmijë: Shtjefin, Baltazarin (Baltën), Bernardin (Nadin), Qilën, Verën (të gjithë të ndjerë), Gjinën, Jozefinën (Pinën) dhe Elzën. Xha Toni me bashkëshorten e saj patën gjashtë fëmijë: Gjika, Gjina, Kola, Zefina (të gjithë të vdekur), si dhe Mirjanën e Tomisllavën. Vëllezërit Andrea dhe Toni, si dhe motra e tyre Dusha, jetonin në Ferizaj, ndërsa motra e saj Mari (Mirjana) jetoi së pari në Nish, dhe më vonë (1941) deri në

fund të jetës së saj në Zagreb. Baltazar (Balë) Prenkpali, ishte viktimë e një vjedhjeje dhe vrasjeje në një qytet të quajtur Jezera në vitin 1912.

Për arsye ekonomike dhe sociale, anëtarët e familjes shkojnë në kërkim të ekzistencës së tyre, duke kërkuar punë dhe mirëqenie, e duke u shpërndarë nëpër vende dhe shtete të ndryshme. Kështu, Marku jeton në Zagreb (Kroaci); Angjeli, Gaspri dhe Luigi në Shkup (Maqedoni); në Prishtinë (Kosovë) jeton Vincenti, në Buje (Kroaci) - Gjergji dhe Roza; Maria në Ferizaj, Jozefina në Prizren, tani në Ulqin (Mal të Zi); në Beograd (Serbi) ishte Karolina dhe Vilma. Karakteristikë është ajo e 11 fëmijëve, të lindur në Ferizaj, vetëm motra më e vogël, Maria qëndroi në vendlindjen e saj - Ferizaj, ku u martua.



Familja Gjini: rrjeshti 1: Nëna Dushë, Roza, Luigji, (Vera), Maria, Gjergji, baba Kolë.
Rrjeshti 2: Marku, Jozefina, Gaspri, Karolina, Vinçenci, Engjëlli, Vilma

124

[124] Vinçenc, Gjini. 2012. Unë jamVinçenc Gjini (I am Vinçenc Gjini). Zagreb, 31.



Engjell dhe Age Gjini /

Enđel and Age Gjini Enđel[125]

[125] Fotografia eshtë marrë nga fondi familijar Nreca. The picture is taken from personal fund from Nreca family.

GJINI FAMILY

The Gjini family was one of Ferizaj's oldest families. The members of this family attained the highest achievements in education. For time and for life they established themselves as patriots, religious devotees and activists. They built up the branch activity in all spheres of life - social and religious, cultural and educational.

Parents, dad Kolo Mark Gjini and mother Dusha Bala Gjini, taught their children to be honest in life and to adorn the high virtue and the excellent moral values.

The Gjini family was close, affectionate and prosperous. Since it was a postwar time, with a general crisis, in every aspect of life, living conditions were severe, large and difficult. Mother Dushë and Dad Kolë were those who educated their children.

Kolo Gjini (1900-1978) was born in Gjakova, but his ancestor moved a long time ago from Albania to Kosovo. In early childhood he became an orphan. He grew up in poverty. In early childhood he moved to Ferizaj / Uroševac and slowly recovered and stabilized. Life made him a man of goodwill and courage. Dushë Gjini (1906-1971) was born in Ferizaj, in an honest and working class family. Her parents were from Zym, moved to Ferizaj a long time before she was born.

Kola was the head of the family, he was a tradesman, and he owned his own coffee shop. By nature, he was humble, calm and gracious. As a rarity and curiosity of the time, for an Albanian, one can mention the case that in 1933 in Belgrade he got a driver's licence and he had an American car Chevrolet, which he used as a taxi/cab in Ferizaj, Gjilan, Prizren, Skopje and Mitrovica. In the 1940s of the last century, Kola had a brick factory and sheep farm in Ferizaj.

Kolo Gjini, and Dede Gjini were the children of Mark and Prene Gjini. Brothers Kola and Deda, became orphans very young when they lost their mother, and their father Mark married a woman from Janjeva. She gave birth to a son Zef.

Deda and his wife, had three children; Florina. Viktor and Antonin (Tonin). They moved to Pulja, where they still live today. Zef had no children and lived in the town of Novska. He was a calm, gentle, kind and humble man. Mother Dushe, as a housewife, blessed with wisdom and

knowledge, has been the head of the family and the pillar of this home. She was a brave and courageous woman. A definite proof of this is the fact that she gave birth at home to her 12 children (without a midwife!).

Mother Dushë's parents were Baltazar (Bala) Prenkpalin and Jane. She gave birth to 14 children of whom only four, two boys Andrea (Nreka) and Toni, and two girl, Maria and Dusha, survived. The whole family used their father's name as a family surname. Uncle Andre, with his spouse Liza, had eight children: Shtjefn, Baltazar (Baltën), Bernard (Nadin), Qila, Vera(all tof them deceased), Gjina, Jozefina (Pinna) and Elza, Uncle Ton, and his spouse, had six children; Gjika, Gjina, Kolola, Zefina (all of them deceased). Mari's name was Mirjana and Tomislava. The brothers Andrea and Toni, as well as their sister Dusha, lived in Ferizaj, while her sister Mari lived first in Nis, and later (1941) until the end of her life in Zagreb.

Baltazar (Balë) Prenkpali, was a victim to a robbery and murder in a town named Jezera in the year 1912

For economic and social reasons, the family members move in pursuit of their own survival, searching for work and comfort, scattered and divided across countries. Brothers and sisters and their families still live in these places; Mark in Zagreb - Croatia; Angel, Gaspri and Luigi in Skopje - Macedonia; in Pristina - Kosovo - Vincent, in Buje - Croatia, Gjergji and Roza; Maria in Ferizaj, Jozefina in Prizren, now in Ulcinj - Montenegro; in Belgrade - Serbia were Karolina and Vilma. Of 11 children, born in Ferizaj, only the youngest sister, Maria stayed in her hometown - Ferizaj, where she married.

VI.6 FAMILJA NRECA



Natasha Didenko dhe Skender Asani me Drita Nreca - Didenko/

Natasha Didenko and Skender Asani with Drita Nreca - Didenko

Rrëfimi i Drita Nreca - Didenko

Jeta ime si një vajzë e vogël ishte shumë mirë dhe e gëzuar. Ajo u mbush me shumë gëzime, lojëra dhe të qeshura. Unë kam lindur në një familje katolike shqiptare, por u rrita në lagje të ndryshme. Një lagje e rrethuar nga shumë nacionalitete dhe tradita. Kjo është ajo që unë e definoj si një lagje e pasur. Megjithatë, nga të gjitha fetë e tjera me të cilat u rrethova, gjeta besimin tim katolik më të bukur dhe më të pasur në botë.

Gjyshja ime kishte një tel të punuar me shtiza prej mëndafshi dhe pambuku, ashtu si në Prizren. Shumëkush bleu nga ajo pëlhurë për qepje të veshjeve, këmisha, bluza dhe kështu me radhë. E ndihmuam aq sa mundëm. Por kjo nuk ishte e gjitha.

Nga pranvera deri në vjeshtën e vonë ne mblidheshim në oborrin tonë dhe thurrnim këmisha, çorape dhe çfarë jo. Kalonim gjithë kohën në këngë, në qeshje, në shaka dhe në lumturi. Ne të gjithë ishim vetëm një, pavarësisht nga feja apo kombësia së silëc i përkisnim. Ne të gjithë u rritëm së bashku sepse ishim miq, luanim, këndonim dhe ndanim bashkë ushqimin mes nesh. Nuk kishte ndarje. Ata që kishin më shumë do të ndanin në mënyrë të barabartë me të gjithë. Në mbrëmje, prindërit uleshin në oborrin e shtëpisë, me këngë dhe qeshje, duke luajtur letra, shah, domino, lojëra për fëmijë, etj. Ndërkohë që ne fëmijët, luanim letra, lojëra sportive e të tjera.

Gjatë ditëve të nxehta të verës, ne shkonim në pushime për 15 ditë në Vodno ose në Içiçi. Ne të gjithë u rritëm si një. Ne gjithashtu ndihmuam njëri-tjetrin në të mirën dhe në të keqen. Për këtë arsye, edhe pse sot secili nga ne jeton në pjesë të ndryshme të qytetit, sa herë që e shohim njëri-tjetrin, ndihemi shumë afër, si vëllezër e motra.

Derisa ishim fëmijë, kishim shumë dëshirë të shkonim në Shkollën e së Dielës në Kishë. Ne mblidheshim pa i njoftuar prindërit tanë dhe shkonim në kishë, mësonim lutjet, dhe pyetnim për shumë gjëra të tjera rreth jetës. Prifti na shpjegonte pa hezitim. Në kohën tonë, ishte e ndaluar që individët (komunistët) të shkonin në kishë. Për këtë, të gjithë kërkonin justifikime me anëtarët e vjetër të familjeve.

Kur mblidhesim bashkë nëpër festa, neve vajzat na vishnin në të bardha, ndërsa burrat visheshin me kostume. Ishte e mrekullueshme! Meshkujt dhe femrat ndërtonin një tunel nga krahët e tyre, ku fëmijët kalonin drejt oborrit. Këto momente pikturuan një pamje të përsosur të oborrit të kishës sonë. Tavolina ishte e mbushur plot me biskota, ëmbëlsira, fruta, perime dhe shumë gatime të tjera. Në njërën anë ishin vajzat që luanin kundër djemve. Muzika lëshohej, dhe ne fillonim të kërcenim. Dukej si një martesë e vërtetë.

Për festën e Zonjës së Bekuar, shkonim në Letnicë, fshat që ndodhet në Viti (të Kosovës). Na thonin se për atë ditë, i Shenjti zbret në fshat gjatë natës për të ndihmuar më pak fatlumët. Prandaj, nuk ishte aspak e çuditshme që më 15 gusht, të gjithë mblidheshim për Zonjën e Bekuar të Virgjëreshës Mari para Kishës Katolike të Bitpazarit, me karroca të udhëtimit, dhe fillonim një ditë të hershme, për të arritur atje në kohë. Përgatitnim enët dhe gjërat e ndryshme, ashtu siç bënim për një piknik, dhe ishim të përgatitur mirë për udhëtimin e gjatë.

Sot, Letnica është një vendbanim i zhvilluar, me arkitekturë moderne. Megjithatë, ajo që vura re kur isha atje së fundi, ishte se nuk ka më të njëjtën bukuri dhe ndjenjë për mua.

Çfarë tjetër mund t'ju them për besimin dhe zakonet? Kjo është diversiteti në secilin prej nesh, veçanërisht të moshuarve. Ne duam të sjellim besimin dhe gjuhën tonë shumë më afër brezave të rinj, sepse një njeri pa besim ose pa gjuhë, nuk është njeri.

Më 1 nëntor, në Ditën e Shenjtorëve, të gjithë shkonim në varreza. Këtu, të gjithë takoheshim dhe kishim mundësinë t'i shohim të gjithë. Asnjë varr nuk do të mbetej i papastër. Prandaj, në çdo varr vendosnim një qiri dhe lule. Pasi këndohen lutje te çdo varr, shkonim në mes të varrezave ku ndriçon varri i madh i të panjohurës (ata që nuk kanë familje dhe një numër më i madh i priftërinjve dhe peshkopëve të Kishës Katolike), dhe më në fund, e gjithë ceremonia përfundon përsëri me një këngë. Prej këtu, shkonim në kishë për meshë. Pas meshës, shkonim në një kafene.

Për Krishtlindje bënim përgatitje të mëdha. E ndërtonim skenën e krishtlindjes. Por, ky është detaji më i bukur i festimit. Një mal është i improvizuar, ku ushqehet një qengj, fëmijët e engjëjve ecin dhe një shpellë në të cilën lind një fëmijë. Në djep e vendosnim një foshnjë kukullash që përfaqësonte lindjen e Jezusit. E njëjta skenë e krishtlindjes, por më e madhe, është paraqitur në Kishën Katolike. Ne të gjithë mblidheshim rreth tij, me një tortë shtëpie. Në atë moment këndohen shumë këngë të bukura, dhe zëri i bukur përhapet dhe prek shpirtin e gjithsecilit. Pamja ishte shumë e bukur, dhe për ndjenjën, unë vërtet nuk kam fjalë. Ne e bënim të njëjtën gjë edhe për Pashkët, vetëm atëherë shpella është e zbrazët, sepse Jezu Krishti ringjallet. Dhe pastaj këndojmë, lutemi, etj.

Në kohën tonë, ne i pëlqenim shumë festat, sepse merrnim dhurata dhe madje edhe ndonjë dinarë. Ishim shumë modestë dhe ekonomikë. I mblidhnim të gjitha paratë në një vend, pastaj shkonim në lagje ose në kinema, në dyqan ëmbëlsirash, në teatrin e kukullave e kështu me radhë.

Sot, është bërë krejt ndryshe. Dhe, unë nuk mendoj më për këto çështje. Është bërë monotone, e ekzaltuar, pa ndonjë ndjenjë të veçantë. Jeta shkon shumë shpejt, si një erë.

Megjithatë, jam krenare që jam një katolike shqiptar, sepse unë kam përparësinë e saj. A e dini pse? Sepse të gjitha festat ishin dhe ende janë para të tjerëve, të tilla si Viti i Ri, Pashkët, Shën Nikolla, etj. E pra, nuk është çudi që po festoj deri sot!



Anëtarët më të vjetër të familjës Nreca në Shkup (prej majtas në të djathtë: Marija, Anjusha dhe Roza) / The oldest members from family Nreca in Skopje (from left to right: Marija, Anjusha and Roza)[126]

[126] Fotografia eshtë marrë nga fondi familijar Nreca. The picture is taken from personal fund from Nreca family.



Familja më e gjerë Nreca në Shkup /

All memmbers from family Nreca in Skopje[127]

[127] Fotografia është marrë nga fondi familijar Nreca. The picture is taken from personal fund from Nreca family.



Anela Nreca më shoqet e saja në kursin e rrobaqepësisë në Shkup /

Anela Nreca on a sewing course with her friends in Skopje[128]

[128] Fotografia eshtë marrë nga fondi familijar Nreca. The picture is taken from personal fund from Nreca family.

Confession of Drita Nreca - Didenko

My life as a little girl was very good and cheerful. It was filled with a lot of joy, games and laughter. I was born in an Albanian Catholic family, but I grew up in a diverse neighbourhood. A neighbourhood surrounded by many nationalities and traditions. It is what I define as a rich neighbourhood. However, of all other religions that I was surrounded with, I found my Catholic faith the most beautiful and richest in the world.

My grandmother had a loom and knitted canvas of silk and cotton like they did in Prizren. Everyone purchased from that canvas for sewing dresses, shirts, blouses and so one. We helped her as much as we could. But that was not all.

From spring until late autumn we gathered in our yard and we knitted shirts, socks and what not. We spent all the time in song, laughter, jokes and happiness. We were all just one. No matter what the religion or nationality we belonged to.

We all grew up together because we were friends, we played, we sang and we shared food between us. There was no segregation. Those who had more would share equally with everyone. In the evenings, the parents would sit in the backyard, with songs and laughter, playing cards, chess, dominoes, board games etc. While we, the children, we played puzzles, sports and many other games.

During the hot summer days, we went on vacation for 15 days at Vodno or at Ičići. We all grew up as one. We also helped each other in good and bad. For this reason, although today each of our lives in a different part of the city, whenever we see each other,r we feel very close, like brothers and sisters.

While we were children, we wanted to go to Sunday School at Church. We would gather without our parents knowing and we would go to the Catholic Church, learned prayers, but we also inquired about many other things about life. The priest explained to us without hesitation or limitation. In our time, it was forbidden for individuals (Communists) to go to church. Everyone would seek excuses with older members of their families.

When we took the communion, the girls would dress us in white, and the men dressed suits. It was magnificent!

Men and women would construct a tunnel from their arms, and the children from pass-through happily running towards the yard. Those moments painted a perfect picture of our Church's yard.

The table would have countless plates full of various cookies, cakes, fruits, vegetables and many other prepared dishes.

On one side were the girls playing against the boys. The music was on, and then we danced. It looked like a real wedding.

For the holiday Assumption of the Blessed Virgin Mary, we would go to Letnitsa, located in Vitina. They say that for that day the Saint is coming down in the village at night to help the less fortunate. Therefore, it is not strange at all that on August 15 we all gathered for the Assumption of the Blessed Virgin Mary before the Catholic Church of Bitpazar travelling carts, we headed a day early, to get there in time. We prepared dishes just like we did for a picnic and we were well-prepared for the long line.

Today, Letnica is a developed town, with modern architecture. However, what I noticed when I was there is that it no longer has the same beauty and feeling for me.

What else can I tell you about faith and customs? That is the diversity in each of us, especially the elderly. We want to bring our faith and language much closer to the younger generations because a man without faith or a language is not a man.

On the 1st of November, on the All Saints' Day, we all go to the cemetery. Here, we all meet and we have the opportunity to see everyone. No grave will remain uncleaned. Therefore, there is a candle and flowers on each tomb. After each tomb is sung, it goes to the middle of the cemetery and enlightens the great grave of the unknown (those who have no families, and a greater number of priests and bishops from the Catholic Church), and finally, the whole ceremony ends again with a song. From here, go to Mass in the church. After the mass, we would go to a cafe.

For Christmas, we would make great preparations. We would construct the Nativity scene. Yes, that's the most beautiful detail of celebration. A mountain is improvised, through which a lamb feeds, children-angels are walking and a cave in which a child is born. In the cradle, we would place a puppet-baby representing the birth of Jesus. The same Nativity scene, but bigger, is presented at the Catholic Church. We all gather around it, with a homemade cake. At that moment, many beautiful songs are sung, and the

beautiful voice spreads and touches everyone's soul. The view is very beautiful, and for the feeling, I really have no words.

We do the same for Easter, only then the cave is empty because Jesus Christ is resurrected. And then we sing, pray, etc.

In our time, we loved the holidays very much, because we would receive gifts and even a dinar. We were very modest and economical. We collected all money in one place, then we went to the neighbourhood or in the cinema, a cake shop, at the puppet theatre, and so on. Today, it's different. I do not think anything of all these matters. It will be monotonous, exalted, without any particular feeling. Life goes by very quickly, like a wind.

However, I am proud to be an Albanian Catholic, because I have the advantage of it.

Do you know why? Because all the holidays were and still are in front of others, such as the New Year, Easter, St. Nicholas and others. Well, it's no wonder I'm celebrating to this day.

VI.7 FAMILJA MARKU



Intervistë me Angjelina Marku, maj 2018 /

Interview with Angjelina Marku, may 2018

INTERVISTA ME ANGJELINA MARKUN

Pyetje: Cilët janë të parët tuaj dhe çfarë mbani mend nga jeta e fëmijërisë në Shkup?

Përgjigje: Unë kam lindur dhe jam rritur në Shkup, nga prindërit shqiptarë. Gjyshi im Nue Marku ka pasur dy djem: Zefin dhe Markun. Zefi bashkë me Gjylënkanë pasurgjashtë fëmijë: Angjelina (unë), Ana, Toma, Vera, Elizabeta (e ndjerë) dhe Lena. Kurse, Marku dhe Marijakanë pasurtre fëmijë, përkatësisht: Kolën, Lidijen dhe Leonardin.

Prindërit e mi u martuan në vitin 1947. Në fakt, unë kam lindur në qendër të Shkupit, përkatësisht në lagjen afër shtëpisë së Nënës Terezë. Kur i mbusha gjashtë vjet, familja jonë u shpërngul dhe u vendos te lagja afër

varrezave franceze, pranë Kalasë së Shkupit . Ne çdo ditë të diel shkonim në kishë, ku luteshim dhe mësonim çështje të ndryshme të besimit në gjuhën kroate, në të cilën gjuhë na shërbenin priftërinjtë.

Pyetje: A mbani mend ndonjë prift shqiptar në Shkup apo ndonjë meshë që është udhëhequr në gjuhën shqipe?

Përgjigje: Po e mbaj mend priftin shqiptar Gjergj Gjergji,kurse kur isha shumë e vogël më kujtohet edhe don Gaspër Gjini, por jo edhe mesha në gjuhën shqipe. Por, pavarësisht kësaj, gjyshi ishte ai i cili na i mësonte uratat apo lutjet e nevojshme në gjuhën shqipe. Fatkeqësisht, të gjitha ritet fetare në kishën katolikete Shkupit janë mbajtur në gjuhën kroate. Më kujtohet shumë mirë gjyshi, i cili na thoshte, sapo ta kaloni pragun e derës, nuk dua të flisni as edhe një shkronjë në gjuhë tjetër, pos shqipes! Ai ishte një edukator dhe shqiptar shumë i mirë.

Pyetje: Na thoni diçka rreth asaj se si i keni shënuar festat katolike?

Përgjigje: Po festat katolike janë festuar në kishat tona. Të gjitha festat i kemi festuar bashkë edhe me familjet tona, shkonim për vizitë tek familjarët dhe miqtë që i kishim në Shkup apo gjetiu, gostiteshim dhe bisedonim për hallet e jetës.

Pyetje: Cilat familje katolike shqiptare nga Shkupi i mbani mend?

Përgjigje: Në Shkup ka pasur mjaft familje shqiptare katolike. Unë i mbaj mend: familjen Kurti, familjen Ukëhajdari, familjen Jaki, familjen Simoni dhe familjen Sereqi, cilat ishin miq të mirë të familjes sonë, dhe me ta kishim raporte shumë miqësore dhe familjare.

Në rrethanat në të cilat jetonim, megjithatë jeta jonë kishe një harmoni shembullore, jo vetm se me familjet katolike,por edhe me familjet myslimane të Shkupit, të cilat ishin në numër shumë më të madh. Ne i kishim të gjitha festat bashkë, si Bajram e Pashkë. Më kujtohet shumë mirë kur gjatë muajit të Ramazanit, nëna gjithmonë na e ndalonte të marrim ushqime kur dilnim të luanim në lagje, sepse na thoshte se është keq ndaj miqve tanë myslimanë, të cilët agjërojnë dhe nuk përdorin asnjë ushqim gjatë tërë ditës. Dhe ne e respektonim këtë kërkesë të nënës, dhe i respektonim vëllezërit e motrat tona nga gjaku.



Nga e majta në të djathtë / From left to right:

Zef Marku, Gjyla Marku, Nue Marku; fëmijët: Ana Marku, Tomë Marku, dhe Angjelina Marku (e intervistuara)



Fotografia është bërë në parkun e Shkupit për festen e Pashkëve /

The photo was take at the Skopje City Park for the Easter Festival:

Ana Marku, Tomë Marku, Angjelina (Gjina) Marku



Familja Marku me familjen Ndreca - mysafirë nga Prishtina /

The Marku family with the Ndreca family - guests from Prishtina:

Gjyla, Toma, Fila, Marku, Zefi, Nue, Mikeli, Drita, Vitorja, Angjelina (Gjina), Vera, Ana



Zef & Gjyla Marku dhe Marija & Mark Marku



Angjelina Marku në periudhën 1954/55

FAMILY MARKU

INTERVIEW WITH ANGJELINA MARKU

Question: Can you remember your ancestor and your childhood life in Skopje?

Answer: I was born and raised in Skopje by Albanian parents. My grandfather Nue Mark had two sons: Zef and Mark. Zefi together with Gjyle had six children: Angjelina (I), Ana, Tom, Vera, Elizabeth (the late) and Lena. Meanwhile, Mark and Mary had three children, respectively: Kolë, Lidije and Leonard.

My parents married in 1947. In fact, I was born in the center of Skopje, respectively in the neighborhood near Mother Teresa's home. When I was six years old, our family moved and settled in a neighborhood near the cemetery of the French army, near the Skopje Fortress. Every Sunday we went to the church where we prayed and learned about religion in the Croatian language, in which the priests preached.

Question: Do you remember any Albanian priest in Skopje or a time when a Mass was held in Albanian?

Answer: I remember the Albanian priest Gjergj Gjergji, and when I was a bit younger, I recall meeting Don Gaspër Gjini, but I do not remember a Mass being held in Albanian language. But, in spite of that, my grandfather was the one who taught us the prayers in the Albanian language. Unfortunately, all religious rites in the Catholic Church in Skopje were in Croatian. I remember my grandfather, who told us, as soon as you cross the doorstep, I do not want to hear you speak a single word in a language other than Albanian! He was a very good educator and a true Albanian patriot.

Question: Tell us something about how you celebrated the Catholic holidays?

Answer: The Catholic holidays are celebrated in our churches. We celebrated all the holidays together with our families, went to visit our family and friends in Skopje or elsewhere, and we talked and talked about the everyday trouble ond joys of life.

Question: Which Catholic Albanian families from Skopje do you remember?

Answer: In Skopje there were many Albanian Catholic families. I remember the family Kurti, the family Ukëhajdari, the family Jaki, the Simoni family and the family Sereqi, who were good friends of our family.

In the circumstances in which we lived, however, our lives had an exemplary harmony not only with Catholic families, but with the Muslim families in Skopje, which were in a much larger number.

We celebrated all our holidays together, like Eid and Easter. I remember very well when during the month of Ramadan, our mother would always forbade us to eat when we went out to play in the neighborhood because she told us that it was bad for our Muslim friends who fast and do not eat any food all day long. And we respected our mother's request, and we respected our brothers and sisters by blood.

VII. VARREZAT KATOLIKE SHQIPTARE NË SHKUP[129]

Një mbështetje e fuqishme dokumentuese për praninë e vazhdueshme të shqiptarëve të konfesionit katolik në Shkup është edhe onomastika. Si një lëmi shkencore e cila studion dy grupe të mëdha emrash, pra emrat vetjakë (antroponimet dhe patronimet) dhe emrat e vendeve (toponimet), onomastika del e një rëndësie tejet të madhe. Kjo, meqë këta emra-onoma, janë në të vërtetë një lëndë shumë e vjetër, sa edhe vetë gjuha, lëndë e ngulitur thellë në mbamendjen popullore, dhe e bartur brez pas brezi deri më sot.

Në brendinë e lëndës onomastike me fanatizëm janë të shtresuara e të ruajtura gjurmë të sundimeve të ndryshme e të ndikimeve të tyre në të gjitha poret e jetës, në tërë mendësinë e një etnikumi, por edhe gjurmë që ndriçojnë rrënjë të historisë e të kulturës materiale e shpirtërore të secilit popull në veçanti. Prandaj, lidhja e saj me historinë, arkeologjinë, gjeografinë, etnografinë, mitologjinë, po ashtu edhe me sociologjinë e psikologjinë e me letërsinë e folklorin, është më se e kuptueshme.

Rëndësia e saj vjen e rritet sidomos për ata popuj që kanë një dokumentim shkrimi të vonë. E tillë është edhe gjuha shqipe. Studiuesit pohojnë se përkundër dokumentimit të vonë, shqipja mund të jetë gjuha *"më e vjetër në Ballkan"*. Dhe pikërisht në këtë drejtim, del në pah rëndësia e onomastikës, e cila, kur mungojnë dokumentet arkivore historike e gjetjet arkeologjike, shfaqet në rolin e një "arkivi gojor", duke shpalosur të dhëna edhe për ato shekuj për të cilët në histori nuk ka dokumente të shkruara. Këto të dhëna, mbi të gjitha shërbejnë si një mbështetje për argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre. Në botën e larmishme të emrave të tokës e të njerëzve, qofshin ata edhe në përdorim të sotëm, onomastika gjen material tejet të rëndësishëm për të provuar vijimësinë në përputhje me rregullat fonetike dhe gramatikore të shqipes. Kjo vijimësi, qysh prej ilirishtes e deri te shqipja e sotme, është provuar në mjaft antroponime dhe

[129] Teksti për interpretimin e emrave dhe mbëemrave në varrezat katolike shqiptare në Shkup është bërë nga studiuesja Hidajete Azizi / The teskt for catholic albanian cementary in Skopje, with name and sufname is written by Hidajete Azizi.

toponime shqiptare. Një vijimësi të tillë që dëshmon për përputhshmërinë e zhvillimit sipas natyrës së gjuhës shqipe janë edhe emrat dhe mbiemrat që kanë bartur dhe që bartin shqiptarët e konfesionit të krishterë.

Në një rast, A. Kostallari do të shprehet "*Emri rron edhe pas njeriut, për t'u kujtuar pasardhësve veprën e tij."* Në rastin tonë, duke u mbështetur në korpusin e fotografive të shkrepura në varrezat e shqiptarëve katolikë në Shkup, ne do të thoshim që emri rron i skalitur në këto rrasa guri, për të na dëshmuar praninë e shqiptarëve katolikë këtu në Shkup. Dhe kjo prani e tyre këtu, përcillet me dy të vërteta që shpalosen pasi të analizohet ky material onomastik.

E para, shqiptarët e konfesionit katolik, në repertorin e tyre të emrave e të mbiemrave, ruajnë me fanatizëm emrat më të vjetër të traditës shqiptare. Një pjesë e mirë e tyre janë emra të nomenklaturës kishtare. Emrat si *Gjin, Gjergj, Gjon, Pal, Kolë, Zef, Pjetër, Shin, Nu* etj., të cilët në ditët tona kanë arritur edhe si mbiemra: *Gjini, Gjoni, Marku, Prenku, Jaki* dhe shumë të tjerë, megjithëse të gurrës latino-romane, trajtohen nga onomastika si "emra tradicionalë shqiptarë", meqë paraqesin shtresën më të vjetër të emrave të huaj në gjuhën shqipe dhe përdorimin shumëshekullor e të pandërprerë ndër shqiptarë. Duke u bërë pjesë e zhvillimit historik të gjuhës shqipe, këta emra janë larguar dukshëm nga trajta e tyre e lashtë krishtere prej së cilës kanë rrjedhë. Ndër shekuj, ata i janë përshtatur natyrës së gjuhës shqipe, duke u bërë të zakonshëm vetëm për të.

Pjesa tjetër e repertorit të emrave e mbiemrave të shqiptarëve katolikë në Shkup flet për ruajtjen dhe kultivimin e emrave të gurrës autoktone. Aty gjejmë edhe njërin ndër emrat më të moçëm të gjuhës shqipe, *Ukë*, i cili del në funksion të patronimit. Të gurrës autoktone takojmë edhe emra të tjerë të moçëm, si *Cub* (Cub Ndue Gjini, 1884-1970), *Bib*, *Drane* (nga Drandofile), *Shaqe* (nga Manushaqe) dhe emra të tjerë si *Engëll, Albina* etj. Në repertorin e patronimeve gjejmë edhe një numër të konsiderueshëm të emrave të fiseve shqiptare, si: Shala, Berisha, Gashi e shumë të tjerë.

E dyta, shqiptarët e konfesionit katolik në Shkup, po i nënshtrohen një procesi të vazhdueshëm asimilimi. Kjo mund të dëshmohet, përveç tjerash, edhe me faktin që një pjesë e mirë e mbishkrimeve të dëshmuara në gurët e këtyre varreve, janë të shkruara në maqedonishten dhe në alfabetin e saj cirilik. Dhe në rastet kur personat bartin emra të nomenklaturës kishtare të ndikuar nga sllavishtja, ose edhe emra të tjerë të huaj, do të bëhej shumë e vështirë të gjurmohej përkatësia etnike e bartësve të tyre po qe se nuk do të

na shërbenin disa të dhëna të tjera që shkojnë në dobi të saktësimit se bartësit e këtyre emrave janë shqiptarë. Në dobi të kësaj do të shkonte fakti që materiali i fotografuar onomastik është marrë nga varrezat e shqiptarëve të konfesionit katolik në Shkup. Mund të bie në sy që ekzistojnë varre në të cilët janë të regjistruar më shumë emra e që sipas gjithë gjasash duhet të jenë varre familjare. Në disa raste mund të vërehet që mbiemri i personit të parë, si bie fjala *Prenk* është shkruar me alfabet latin, ndërkaq pasardhësit e tij janë regjistruar në po të njëjtin varr me alfabetin cirilik, me emër të nomenklaturës kishtare sllave (*Иван)* dhe me mbiemër të cilit i është shtuar prapashtesa sllave (*Пренк-овски)*. Në po të njëjtin varr, anëtari i tretë i gjinisë femërore, po ashtu regjistrohet në alfabetin cirilik (*Вероника*) dhe me një mbiemër sllav (*Маринковић*), gjë që flet edhe për një anë tjetër të së vërtetës së shqiptarëve katolikë, martesat e përziera me sllavë, përkundër martesave të pakta midis shqiptarëve katolikë myslimanë, një tjetër dëshmi kjo për asimilimin e vazhdueshëm të shqiptarëve të këtyre trojeve.

I tërë ky material onomastik flet për një sfidë të rëndë me të cilën janë ballafaquar shqiptarët katolikë të Shkupit, në përpjekjet e mundimshme për të ruajtur traditën dhe kulturën e gjuhën shqipe dhe në luftën kundër asimilimit të pashmangshëm i cili kohëve të fundit po del fitimtar kundrejt forcave të fundit të shqiptarëve katolikë në Shkup.

CATHOLIC ALBANIAN CEMETERY IN SKOPJE

Onomastics provides a strong documentary support for the continued presence of Catholic Albanians in Skopje. Onomastics or the study of the history and origin of proper names, namely personal names (anthroponyms and patronyms) and names of places (toponyms), is of utmost importance. That's because names are actually a very old subject, as old as the language itself, deeply embedded in the history of every nation and it has been passed down for generation to this day.

The study of onomastic with fanaticism has stratified and preserved traces of various rulings and their influences in all aspects of life, in the collective memory of an entire nation, but also traces that illuminate the roots of history and material and spiritual culture of each nation in particular. Therefore, its connection to history, archeology, geography, ethnography, mythology, as well as sociology and psychology, and folklore literature, is quite understandable.

It has a significant importance especially for those nations who started documenting their written language very late in history. Such is also the Albanian language. Researchers claim that despite late documentation, Albanian may be the "oldest language in the Balkans". Moreover, precisely in this regard, the importance of onomastics, which, when the historical archive documents and archeological findings are missing, undertakes the role of an "oral archive", disclosing data even for those centuries for which history does not have any written documents. These data, most all, serve as a support to arguing the autochthony of Albanians in their lands. In the diverse world of names of land and people, even those that we still use today, the onomastics finds material to prove the continuity in accordance with the phonetic and grammatical rules of the Albanian language. This continuity, from Illyrian to today's Albanian, has been proved in many anthroponyms and Albanian toponyms. This continuity is proven by the names and surnames carried by the Catholic Albanians throughout the centuries.

On one occasion, A. Kostallari said: " One's name will live on even after one dies, to remind one's descendants of one's deeds." In our case, relying on the corpus of photographs scattered at the cemeteries of Catholic Albanians in Skopje, we can say that the name lives in these tombstones to prove the presence of Catholic Albanians here in Skopje. In addition, their

presence here is followed by two truths unfolding after analyzing this onomastic material. First, the Catholic Albanians, in their repertoire of names and surnames, fanatically guard the oldest names of the Albanian tradition. A good part of them had names of ecclesiastical nomenclature. Names such as Gjin, Gjergj, Gjon, Pal, Kolë, Zef, Pjetër, Shin, Nu etc., who in our days are used as surnames like: Gjini, Gjoni, Marku, Prenku, Jaki and many others, although with Latin-Roman roots, are treated by onomastics as "traditional Albanian names" as they represent the first use of foreign names in Albanian language testifying the uninterrupted use of these names by Albanians. By becoming part of the historical development of the Albanian language, these names have largely disappeared from their ancient Christian form from which they originate. Throughout the centuries, they have adapted to the nature of the Albanian language, becoming more common to it.

The rest of the repertoire of Catholic Albanian names and surnames in Skopje testifies of preserving and cultivating autochthonous Albanian names. There we find one of the oldest names of the Albanian language, Ukë, which comes out in the function of patronage. Of the autochthonous line of names we meet other old names like Cub (Cub Ndue Gjini, 1884-1970), Bib, Drane (from Drandofile), Shaqe (from Manushaqe) and other names like Angle, Albina etc. In the repertoire of patronyms we find a considerable number of names of Albanian tribes, such as: Shala, Berisha, Gashi and many others.

Secondly, the Catholic Albanians in Skopje are undergoing a continuous assimilation process. This can be evidenced, among other things, by the fact that a good part of the inscriptions shown on the tombstone are written in Macedonian and in its Cyrillic alphabet. In addition, in cases where persons carry names of ecclesiastical nomenclature influenced by Slavs or other foreign names, it would be very difficult to trace the ethnicity of their bearers unless they were had some other data, which go to the benefit of specifying that the bearers of these names were Albanians. To the benefit of this is the fact that the photographed onomastic material was taken from the cemeteries of Catholic Albanians in Skopje.

It may be noticeable that there are graves in which more than one name is written and that they probably are family tombs. In some cases, it can be noticed that the first person's surname, like Prenk, is written in Latin alphabet, while his descendants are written in the same tomb with Cyrillic

alphabet, by the name of the Slavonic nomenclature (Иван) and my surname to which the Slav suffix has been added (Пренк-овски). In the same grave, the third female member is also recorded in the Cyrillic alphabet (Вероника) and a Slavic adjective (Маринковић), which also speaks of another aspect of the truth of Catholic Albanians, marriages mixed with Slaves, despite the scarce marriages among Muslim and Catholics Albanians, another testimony to the continued assimilation of Albanians on these lands.

All of this onomastic material speaks of a serious challenge faced by the Catholic Albanians of Skopje, in the effort to maintain the tradition and culture of Albanian language and in the struggle against the inevitable assimilation which has recently emerged victorious against the efforts of Catholic Albanians in Skopje.



130

[130] Fotografimi është berë me leje nga drejtori I varrezave të Butellit, z. Sait Hajroviç-Buco / Photos from Albanian catlolic cementery in Butel Skopje, are taken with approve from director Sait Hajroviç- Buco.


Dashtnija fillon n'familje
nene Tereza
Љубовта почнува во семејството
мајка Тереза
Love begins at home
mother Teresa


KY TU
PUSHON
TRUPI
I
GUB NOUE GJNI
U LIND ME 1884-1930 VOIC



Andrija Logoreci – ipeshkv i Ipeshkëvisë së Shkupit /

Andrija Logoreci – diocese of Skopje


KËTU PUSHOJN
ÊNGJELL M. GJEÇI
1857-1911
LIZA Ê. GJEÇI
1863-1945
LIHA K. GJEÇI
TOKA E LET IU KJOFT
PERMÊNDOREN
E ÇON I BIRI
FRANA
ME BASHKSHORTEN
E FEMIT


ENDEL DINI
1926-1999
SUPRUGA SA DJECOM


ÇENA KURTI


VILMA M.GAŠI
UC-CA I-RAZ GIMN.
Rod 25-III-1943 +17-II-1955 g.
Draga jedino Čedo Vilma
Labude naš lijepi bijeli!
Pupuljče aprilska!
Tko ti tako u proljeće
slomi nježna krila?!
Letjela si u zanosu
prema majskoj zori,
i odjednom milo srce
prestade da gori...
Potrudi se draga zemljo,
kao prava majka,
da joj vječni san bar bude
kao divna bajka!
A tvoj lik će vječno biti s nama
Srce naše


РУГАЛЕ
ВИКТОР
1904 1972
ЦВЕТАНК
БЕЛ
КУЛЕВАН СОФИЈА
ТOMI
ANTON
1925-2008


ЕКАТЕРИНА ПЕЕВА
1886 – 1969
БОРИС ПЕЕВ
GJYLA
MARKU
1929-2005
ZEF
MARKU
1922-2005
ELIZABETA


KËTU PUSHOJNË ESHTRAT E
UKAJDARI
MARIJA
1934-1947
FILOMENA
1875-1952
SHAQA
1907-1994
PUSHOFSHIN NË PAQË
ZEF
1901-1945
NËNA IME FËMIJTË


VILA
ANTON
1907-1966
CANA
1917-1995
FROK
1943-1999
PËRMENDORËN
E NGRITË FAMILJA


1910 - 1979
A.P.A.V.K.


Počivajte u miru
ĐIN N KUĆI 1887–196
ĐUSTA Đ KUĆI 190?–1944
MARIJA F KAJTAZ 1872–1935
MIKEL] F KAJTAZ 1914–1943
OŽALOŠĆENA DECA
SPOMENIK PODIZU SINOVI
STEVO I ALOIZ KUĆI


KAJTAZI
KATA
1906-1984
BARTOLOMEJ
1900-1944
RAFAEL
1932 - 1999


KAJTAZI
VIKTOR
1933-2011
OD SEMEJSTVOTO


1931
РУДОЛФ
ШИРОКА
2017


ВЕРА ШОНИ
1934-1995


ANTON SEREÇI
1932 - 1983
ELIZABETA SEREÇI
1933 - 2011


JU NA MËSUAT ME RESPEKTU
NJERIUN, FAMILËN, ME ADHËRU
ZOTIN, ME E DASHTË KRISHTIN,
ME JU GEZUE JETËS...
DRONA SHALA-GULIJA 1890-1958
CICILIJA SERREQI 1926-1992
MARK SERREQI 1922-2001
PUSHONI NË PAQË


MARK NU MARKU
1927 - 1984
MARIJA MARKU
1933 - 2004
E PËRKUJTOJNË
BASHKËSHORTËJA
DJEMTË DHE VAJZA


OVDE POČIVA
MOJ DOBAR SUPRUG VOLJENI
OTAC I MILI DEDA
PETRUŠ DŽON PRENK
ROĐEN 1900 GOD. UMRO 5.IX. 1962 GOD.
POČIVAJ U MIRU
ПРЕНКОБСКИ ИВАН
1932 - 1991
МАРИНКОВИЋ ВЕРОНИКА
1930 - 1994
ЉУБИЦА
1910 - 1994
SPOMENIK POBRIŽU OŽALOŠĆENI
SUPRUGA LJUBA SIN DŽONI
ĆERKE KAROLINA I VERONIKA


ZEF JAKI
1923 - 1988
ALBINA JAKI
1929 - 2007


OBITELj JAKI
SIMON 1913-1999
MARIJA 1923-2013
ROBERT 1950-2010
PETAR 1945-2013
OD OBITELj JAKI


DŽON ANTON
1907-1980
DŽON DUŠA
1915-2004
SOPRUGATA SO SINOVÍTE


OVDE POČIVA
ANA STEFANI
ROĐENA 17-IX-1919 GOD. † 8-X-1968 GOD
DRAGA ANA, VOLELA SI ŽIVOT ALI TVOJE BOLNO
SRCE NIJE IZDRŽALO. SMRT JE BILA JAČA OD
NAŠE LJUBAVI. TVOJ LIJEPI PLEMENITI LIK I
DOBROTA OSTAĆE NAM U VJEČNOJ USPOMENI
DA VJEČITO DO GROBA ZA TOBOM TUGUJEMO.
POČIVALA U MIRU
SPOMENIK PODIŽE SUPRUG
LUIGI STEFANI-BUZI SA ĆERKOM.


ОВДЕ ПОЧИВА
КЕШНЕЦ ЈАГА
РОЂЕНА 7.II.1903 ГОД.
ПРЕМИНУЛА 22.V.1973 Г.
СПОМЕНИК ПОДИЖЕ
СУПРУГ ЂУРО СА ПОРОДИ-
ЦОМ


ЦОН ДОЧИ
1940-1989
ОД СОПРУГАТА
СО ДЕЦАТА


Blessed Mother Teresa-Gonxhe Bojaxhiu
her Father's tomb.
Z C F BIBA
1930-1990
IVA BIBA
1928-2008


СИНКОЛОВИ
Бозомир
-Боби
KETU PUSHOJNE ESHNAT E
GJYSTES PALIT DELHYSA
VDEKE ME 6-III-1914
SIMONIT HAXHI PALIT SHAHTA
LE ME 25-X-1855 VDEKE ME 11-III-1940
PALINES SIMONIT HAXHI PALIT SHAHTA
LE ME 25-V-1865 VDEKE ME 14-VIII-1946
KET PERVENDORE VA NOREHIN DJELMET
E BIJAT DJELMET:NOSH SHAHTA PAVLO
VSKI AHTON,LORA SHAHTA PAVLOVSKI
LORENG,BIJAT MARIJA LUZ KOLVESHIT,
GJULA PALGASHIT.
1.XII-1962 SHKUP.
PAJDIGA


VIKTORIJA JAKIT ANTONI
1911-1947
JAKI SARËS
1892-1915
MANIKA JAKIT LUMEZI
1899-1971


ОВДЕ ПОЧИВА
НАШИОТ МИЛ ПИКОГА НЕП-
РЕЖАЛЕН СУПРУГ И ТАТКО
ЗЕФ ТУПЕЦ
МАРКОВСКИ
РОДЕН 19-III-1885
УМРЕЛ 6-V-1952
СПОМЕНИК ПОДИГА
СУПРУГА И СИН


KËTU PUSHOJNË
ESHNAT E PLEÇVE
LEKAJ
DODA
dhE GRAT
POMENDOREN E
NIPI
ANTONI


GULIJA
IGNJAC 1928-1994
VICENC
ROKI
NREKA
KAROLINA


SEBOV
PAL 1901-1979
ANUSHA 1912-1988
TË VRAN GJAT
BOMBARDIMIT
24-1-1944
SHKUP
VERONIKA 1935
GJERGJI 1938
KATARINA 1941
KAROLINA 1943
ANTONETA 1943
GJEKA
1839-1921
KATA
1863-1938
ANTONETA
1937-1938
CICILIA XHONI 1933-1933


ТОН ФРОК
1891-1954

VIII. KISHAT KATOLIKE NË QYTETIN E SHKUPIT / CATHOLIC CHURCHES IN SKOPJE



Shugurimi i Kishës Katolike „Zemra e Krishtit“ në Shkup në vitin 1913 /

Ingauration of the Church Heart of Christ in Skopje in 1913



Kisha e vjetër katolike „Zemra e Krishtit" në qendër të Shkupit në fillim të shek. XX /

Church "Heart of Christ" in Skopje in the early XX century



Plani urbanstik i Kishës "Zemra e Krishtit" në Shkup, nga arkivi i dom Ndue Bytyqit /

Architectural plan for the church "Zemra e Krishtit" from the personal fund of Ndue Bytyqi



-Kjo pllakë paraqet kujtim nga manifestimi i vitit 1902, kur Katedralja e Shkupit është vendosur nën kujdesin e "Zemrës së Shenjtë të Krishtit". Ky tempull ishte themeluar në vitin e pestë të Argjipeshkvisë të argjipeshkvit Pashkal Troski, dhe i bekuar nga po ai, me 2 dhjetor 1902. Katedralja ndodhje tek vendi që sot njihet si Shtëpia Muze e Nënë Terezës, e cila ishte rrënuar nga tërmeti i vitit 1963. Kjo pllakë përkujtimore është gjetur në afërsi të Kishës "Shën Jozefi" në Bitpazar të Shkupit, në vitin jubilar të mëshirës së Zotit, 2016. Në këtë vend është vendosur në nder të 115 vjetorit të ditës kur Famullia e Shkupit i është dedikuar "Zemrës së Shenjtë të Krishtit", në festën e patronit, në verën e Zotit 2017.

-This is a commemorative plaque of the events that took place in 1902 when the cathedral in Skopje was put under the patronage of the Sacred Heart of Jesus. The building this temple began in the seventh year of the Archbishop's service of the most reverend monsignor Pashkal Troksi and was blessed by the same archbishop on December 2, 1902.The catastrophic earthquake in 1963 destroyed the Cathedral which at the time was located at the place of the current memorial house of Mother Teresa. The plate was found near the church of St. Joseph at Bit Pazar in Skopje in the jubilee year of Mercy, the year of our Lord 2016. It was put on this place in commemoration of the 115 year anniversary since the day when the Parish of Skopje was consecrated the Sacred Heart of Jesus, for the celebration of the patron, in the year of our Lord 2017.



Kisha "Zemra e Krishtit" e ndërtuar pas tërmetit të vitit 1963 në Shkup, gjendet afër Bitpazarit / The Church "Heart of Christ" in Skopje after the 1963 eartquake.



-Si një shenjë e tregtisë së tyre të vjetër të filigranëve, paraardhësit e mjeshtrive të vjetër, në nder të Kanonizimit të Nënë Terezës, punuan dhe e dhanë si donacion një vepër të ndërlikuar të filigranit ose një relike, në kishën katolike ku do të jenë të ruajtura të gjitha reliket në lidhje me Nënë Terezën. Relikën e punuan zejtarët e rinj Josip - Zef Mirdita dhe Leonardo - Mark Ljoni[131].

-As a mark of their filigree trade, the ancestors of the old craftsmen, in the honor of the Canonization of Mother Teresa, handcrafted and donated an intricate filigrann art work or a relic, to the catholic church where all the relics concerning Mother Teresa will be preserved. The relic was made by the young craftsmen Josip – Zef Mirdita and Leonardo –Ljoni Mark.

[131] Shoqata e artarëve dhe argjentarëve shqiptarë katolik në Shkup, 2016/ A goldsmith's communityof Albanian Catholic in Skopje, in 2016.



Leja urbanistike nga komuna e Çairit për ndërtimin e kishës katolike në Shkup /

Cair Municipality`s Urban planning for the building of the Catholic Church in Skopje.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE I SHQIPTARËVE & ACTA NON VERBA, 2018

"Familjet katolike shqiptare në Shkup"
(dokumente, fotografi dhe dëshmi - I)

"Catholic Albanian families in Skopje"
(documents, pictures and testimonies - I)

Autorë / Authors:
Skender Asani, Albert Ramaj, Natasha Didenko

Redaktor përgjegjës / Editor in chief:
Sevdail Demiri

Përkthimet / Translations:
Elmedina Asani, Maja Susha, Viki Sarkasijan

Redaktor teknik / Technical editor
Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH−së nr. 0201-382/2, të datës 29.12.2017, Shkup.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1(=18:497.711):272(093)
930.85(18:497.711):272(093)
316.362(18:497.711):272(093)

ASANI, Skender
Familjet katolike shqiptare në Shkup : (dokumente, fotografi dhe dëshmi) = Catholic albanian families in Skopje : (documents, pictures and testimonies) / Skender Asani, Albert Ramaj, Natasha Didenko. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2018. - 482 стр. : илустр. ; 25 см. - (Biblioteka Histori)

Текст на алб. и англ. јазик. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-73-8
1. Насп. ств. насл. 2. Ramaj, Albert [автор] 3. Didenko, Natasha [автор]
а) Албанци - Католичка црква - Скопје - Сведоштва б) Албанци од католичка вероисповед - Културна историја - Скопје - Сведоштва в) Албански семејства, католички - Скопје - Сведоштва
COBISS.MK-ID 107540746